

DR. JUSUF EL-KARDAVI



ISLAMI DHE POLITIKA

KAÇANIK 2002

DR. JUSUF EL-KARDAVI

ISLAMI DHE POLITIKA

**Përktheu dhe përshtati:
Dr. Musli Vërbani**

KAÇANIK 2002

Me ndihmën e Allahut mbrohem i prej dëmit të djallit të mallkuar!

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

“Thuaj: ‘Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mirë që Allahu i krijoi për robin e vet? Thuaj: ‘Ato janë që në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e Kijametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqarojmë argumentet një populli që kupton.’ Thuaj: Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, qofshin ato të hapëta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t’i mvishni Allahut shokë pa pasur për këtë kurrfarë argumenti dhe ndaloi të thoni për Allahun atë që nuk e dini se është e vërtetë.”

NGA KUSHTETUTA HYJËNORE

DY FJALË NË VEND TË HYRJES

Autori i veprës “*Islami dhe politika*” - dr. Jusuf el Kardavi është njohës i shkëlqyeshëm i Islamit në botën arabe dhe më gjerë. Ai ka botuar një varg të tërë librash ku trajtohen tema nga më të ndryshmet, veçanërisht ato që kanë lidhje me Islamin dhe historinë e zhvillimit të tij. Veprat e tij kanë zgjuar interesim të madh jo vetëm në botën arabe, por në të gjitha shtetet ku ka myslimanë në kontinentet e botës duke përfshirë kështu Lindjen dhe Perëndimin.

Në veprën e përmendur të dr. Kardavit trajtohen një varg çështjesh të rëndësishme dhe me interes të gjerë nga sfera politike ku me argumente të mbështetura shkencore ndriçohen një varg problemesh aktuale që janë të lidhura për jetën në shoqërinë arabe dhe më gjerë. Gama e problemeve që trajtohen në këtë libër është e gjerë dhe e shumëllojshme, por këto i përshkon një fill i përbashkët që është aktualiteti i theksuar për kohën bashkëkohore. Aty bëhet fjalë për udhëheqjen shtetërore dhe rajonale në shoqërinë bashkëkohore arabe, e cila në rend të parë duhet të ketë drejtësi të plotë të mbështetur në urdhrat e Allahut dhe në porositë e të Dërguarit të tij, Muhamedit a.s. si dhe në shembujt e shumtë të sundimit në botën islame nga kohët më të lashta e gjer në ditët tona.

Në vetë kapitullin e parë të veprës së tij “*Islami dhe politika*” Kardavi thekson se gjatë kohëve të shkuara kundërshtarët e Islamit, midis të cilëve ka pasur edhe ndonjë dijetar arab të painformuar mirë, janë munduar që ta ndajnë Islamin nga politika duke e quajtur me terma të ndryshëm si Islami arab, islami afrikan, islami turk, Islami malajzijas etj., edhe pse thotë ky, Islami është një dhe i pandashëm. Veç kësaj, këta dijetarë janë munduar që t’i bindin arabët dhe myslimanët në përgjithësi kinse Islami nuk paska kurrfarë lidhjesh me politikën dhe se ai u dashka që të jetë vetëm dogmë fetare pa u përzier në çështjet politike aktuale të vendeve të ndryshme myslimane. Ndërkaq të njëjtit propagandues në vendet e tyre lejojnë që feja dhe politika të trajtohen bashkërisht, sepse kështu i arrijnë qëllimet e tyre kundër interesave të popujve të tjerë dhe vendeve të tjera. Kardavi konstaton me saktësi se Islami nuk është doktrinë fetare e izoluar nga jeta e përditshme, por është një me politikën dhe me të gjitha marrëdhëniet shoqërore, ekonomike e kulturore të një populli edhe në kohën aktuale. Këtë ai e argumenton me shembujt e shumtë të Kur’anit dhe të ligjeve të tjera që dalin prej tij si dhe me përvojën e pejgamberëve e të sundimtarëve të tjerë që janë shquar për të mirë në historinë e Islamit, rrugë të cilën duhet ta ndjekin edhe gjeneratat e tanishme. Ai përmend edhe shembuj të freskët nga jeta e tij kur ai dhe dijetarët e tjerë përparimtarë arabë mundoheshin që në qeverisjen e shteteve të ndryshme arabe, të cilat kishin marrë rrugën e despotizmit, ta kthenin sundimin me burim nga Islami. Por për këto qëllime të tyre ishin dënuar me burgim të përjetshëm e

me likuidime fizike duke ua ngarkuar fajin kinse paskan dashur të çrregullojnë marrëdhëniet e brendshme të shtetit dhe paskan qenë kundër sheriatit e Islamit.

Një çështje e rëndësishme që trajtohet në këtë vepër të Kardavit është problemi i shtetit demokratik ose më mire: i elementeve të demokracisë në Islam. Një temë e këtillë është shtruar që të trajtohet pas konkludimeve të gabuara të disa dijetarëve të huaj, por edhe arabë, se Islami si i vjetër, nuk paskësh farë lidhjesh me demokracinë, pasi që demokracia qenka një risi që po dalka në shtetet më të përparuara të Evropës Perëndimore dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dhe si e këtillë demokracia paskësh hyrë relativisht vonë në ndonjë shoqëri arabe ose nuk paskësh depërtuar fare, sepse shtetet arabe kanë pasur dhe kanë sisteme të sundimit totalitar ku nuk ka asnjë element të demokracisë bashkëkohore. Dijetari i shquar Jusuf el Kardavi e trajton këtë problem duke u nisur historikisht nga kohët më të moçme e duke ardhur në kohët më të vona. Ai me argumente bindëse duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit, në jetën dhe përvojën e të Dërguarit të Allahut dhe sidomos të sundimit të tij sa kishte jetuar në këtë botë si dhe me shembuj të tjerë nga sundimi i pejgamberëve e të besimtarëve të shquar, arrin të argumentojë bindshëm se elementet e demokracisë nuk janë të kohës sonë, por ato kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në Islam që nga kohët më të hershme. Ai argumenton se ligji themelor dhe më i rëndësishëm është ligji i cili ka zbritur nga Allahu i Madhëruar dhe në bazë të tij kanë lindur ligjet e tjera që kanë rregulluar marrëdhëniet politike e shoqërore në Islam, prandaj në të nuk kanë se si të mos dalin elementet e plota të demokracisë, të cilat më vonë janë kopjuar edhe nga shoqëritë e tjera të shteteve që u përkasin etnive dhe feve të tjera.

Një problem tjetër që shtrohet dhe trajtohet në këtë vepër është sistemi i parlamentarizmit në jetën e përditshme të shteteve arabe. A duhet të zbatohet parlamentarizmi në jetën politike dhe në qeverisje të shtetit apo jo, kur dihet mirëfilli se disa nga urdhrat që kanë zbritur nga qielli janë të padiskutueshëm dhe se rreth tyre nuk mund të bëhen debate, por ato duhet të realizohen e të zbatohen me përpikëri nga çdo besimtar mysliman. Duke u nisur nga ky fakt disa dijetarë kanë ardhur në përfundim se në shtetin Islam, i cili vepron sipas sheriatit, nuk ka vend për parlamentarizëm, që do të thotë se në këto shtete duhet të vendoset sistemi i sundimit monist absolut. Kardavi edhe për këtë ka shpjegimet e veta dhe thotë shumë qartë se Ligjet që kanë zbritur nga qielli nuk mund të keqtrajtohen dhe të keqpërdoren për qëllime të tjera në rend të parë për qëllime hegjemoniste të sundimtarëve aktualë. Nga këto ligje duhet të veçohen ato që janë urdhra të drejtpërdrejta të Islamit dhe të cilat myslimanët duhet t'i respektojnë e t'i zbatojnë me përlujë. Por ka edhe gjera të tjera të cilat nuk përfshihen në ligjet themelore madje edhe shumë probleme që nuk përfshihen fare në urdhrat e Zotit të Madhëruar, por që dalin në jetën e përditshme dhe rreth këtyre duhet të zhvillohen debate të ndryshme në mënyrë që vendimet, të cilat aprovohen dhe duhet t'i zbatojnë besimtarët myslimanë dhe jomyslimanë që ndodhen në atë

shtet apo në atë bashkësi, të jenë sa më të drejta dhe të afrohen plotësisht me porosinë e Kur'anit që dalin nga urdhrat e Zotit të Madhëruar e të Dërguarit të tij. Nga kjo del qartë se të gjitha punët shtetërore nuk duhet të lihen në duar të një njeriu, sepse nuk ka njeri të pagabueshëm. Por kur në përpilimin e vendimeve të caktuar marrin pjesë më shumë njerëz dhe problemet shohet nga të gjitha anët edhe përfundimet janë më të drejta, prandaj janë edhe më të pranueshme për besimtarët myslimanë dhe jomysliman. Kjo do të thotë se në shtet veç kryetarit të shtetit dhe të parlamentit duhet të ketë qeveri me ministra e organe të tjera përcjellëse ku do të merr pjesë një numër sa më i madh njerëzish që janë të kualifikuar plotësisht për të gjitha problemet që trajtojnë e vendimet që marrin. Prandaj mendimi i qeverisë aprovohet në parlament dhe parlamenti është trup më i gjerë me kompetenca më të mëdha. Edhe vetë kryetari i shtetit duhet të konsultohet vazhdimisht me këshilltarët e tij, por duhet të respektojë edhe mendimet e vendimet e qeverisë dhe të Parlamentit, sepse po që se merr vendime pa konsultime ka mundësi reale që ato vendime të jenë të gabueshme. Për çështjet kardinale të cilat janë të rëzuar qartë edhe në Ligjin themelor të Islamit, të cilat nuk diskutohen fare, por realizohen, kryetari ka të drejtë të marrë vendim me veto edhe nëse në anën tjetër janë shumica, madje edhe shumica absolute. Në rastet e kështilla mendimet individuale qofshin edhe shumicë nuk merren parasysh. Këtë Kardavi e argumenton edhe me faktin se kur Muhamedi a.s. ishte në luftë e sipër në Medinë mendonte se nuk kishte nevojë të bëjë kurrfarë fortifikimi para luftës vendimtare me kundërshtarët e tij. Mirëpo meqë shumica e bashkëluftëtarëve të tij mendonin se më mirë ishte të bëjë fortifikimi, ai hoqi dorë nga mendimi i vet dhe u pajtua me mendimin e shumicës. Ky është një shembull tipik që tregon se kur ka nevojë, mendimi i shumicës duhet të respektohet.

Një problem tjetër interesant që trajtohet është ky se a duhet myslimanët të marrin modele gjatë jetës së përditshme për zgjidhjen e ndonjë problemi të rëndësishëm nga të tjerët veçanërisht nga jomyslimanët? Ka pasur dijetarë që e kanë kundërshtuar një gjë të kështillë duke theksuar se ne jemi popull i veçantë me fe të veçantë, prandaj edhe veprimet tona duhet të jenë të veçanta e nuk duhet të jenë si të tjerëve. Këtë mendim dijetari ynë Kardavi e hedh poshtë, sepse edhe mësimet nga Islami burimor tregojnë se myslimani ka nevojë të madhe për dije dhe atë duhet ta marrë kudo që ta gjejë, pa marrë parasysh faktin se a e ka konsumuar kush më parë atë dije, apo myslimanët janë të parët që e shfrytëzojnë. Këtë Kardavi e ilustron me shembullin e Muhamedit a. s. kur ai merr modelin e fortifikimit të qytetit, të cilin shumë kohë para tij e kishin zbatuar persianët në luftërat e tyre kundër armiqve. Muhamedi a. s. nuk nguron aspak që ta zbatojë këtë të mirë në truallin e vet, edhe pse ai nuk e kishte shpikur për herë të parë.

Edhe pjesëmarrja e femrës në jetën politike të shoqërisë arabe shtrihet për t'u trajtuar gjerësisht. Ka pasur mendime se femra është e dedikuar që të

interesohehet për punët e shtëpisë dhe nuk duhet të merret me punët e burrit, madje nuk duhet të dalë fare nga shtëpia. Një mendim i këtillë nuk është aspak progresiv, sepse lë shoqërinë shumë prapa. Në shoqërinë ku nuk ka kushte për edukimin e femrës aty nuk ka as kushte për progres të përgjithshëm shoqëror. Kardavi e rrëzon këtë teori të gabuar, duke theksuar se në shumë vende të botës, madje edhe në shtetet e rëndësishme të myslimanëve gruaja është arsimuar dhe është treguar me aftësi të njëjta si mashkulli në punë të kryerjes së obligimeve. Ajo mund të jetë edukatore dhe mësimdhënëse në të gjitha shkallët e shkollimit, të jetë mjekë, ekonomiste, inxhinierë e dalluar etj., prandaj nuk ka asnjë pengesë që femra të jetë e përfshirë edhe në jetën e përditshme politike. Disa pengesa që mund t'i ketë ajo: si rritja dhe edukimi i fëmijëve të vegjël, kryerja e punëve të ndryshme të shtëpisë, shkak i sëmundjeve që lidhen me menstruacionet etj. nuk e pengojnë atë që të merret edhe me punë të tjera. Për më tepër femra që është pak më e shtyrë në moshë dhe i ka kaluar të gjitha këto pengesa të mundshme mund të kryejë me sukses edhe punët shtetërore, në disa raste madje me përkushtim më të madh sesa vetë meshkujt. Ajo (femra) vërtet duhet të sillet në bazë të normave e rregullave të caktuara: të jetë e moralshme, të vishet mirë si i ka hije femrës dhe si është e caktuar me norma morale, të ruaj moralin dhe të jetë besnike ndaj bashkëshortit, të kujdeset edhe për punët e tjera të shtëpisë, të respektojë burrin etj. dhe krahas këtyre mund të merret edhe me punë drejtuese politike. Këto argumente të Kardavit dalin plotësisht të përligjura: sot edhe në vendet myslimane ka raste kur gratë drejtojnë edhe qeveritë e tyre madje me sukses të plotë si Tansu Çiler në Turqi ose Banazir Buto kryetarja e dikurshme e qeverisë së Pakistanit.

Fakti se ka shumë myslimanë që ka rastisur të jetojnë në vende të ndryshme jomyslimane ku qeverisjen e kanë banorët vendës që nuk janë myslimanë, ka shtruar edhe problemin e pjesëmarrjes së myslimanëve në këto qeveri ose bojkotimin e plotë të tyre. Këtë problem e trajton edhe Kardavi në veprën e vet. Ai nuk sheh kurrfarë kufizimi të mundësisë së marrjes pjesë të myslimanëve në qeveritë e shteteve që nuk i përkasin Islamit. Veçse përcakton në mënyrë të saktë se puna e tyre në këto forume shtetërore qendrore ose rajonale duhet të jetë në funksion të plotë të së mirës së banorëve myslimanë të atyre vendeve. Pozita nuk duhet të merret për qëllime thjesht karrieriste ose për të mira individuale, por qeverisja duhet të jetë në funksion të së mirës së përgjithshme dhe e bazuar në drejtësi të plotë, sepse vetëm atëherë është e përligjshme. Kjo argumentohet edhe me shembuj konkretë: Jusufi ka qenë në qeverinë jomyslimane të Egjiptit si ministër i financave, por ai ka vepruar në rend të parë me drejtësi të plotë dhe ka respektuar saktësisht interesat, të drejtat dhe të mirat materiale të myslimanëve, prandaj një punë si kjo ka qenë e pëlqyer edhe nga pejgamberët dhe nga udhëheqësit më të shquar të Islamit.

Në veprën e Jusuf el Kardavit trajtohen edhe shumë çështje të tjera me interes, të cilat lexuesi mund t'i lexojë dhe të njihet më mirë me disa çështje të shtruar në mbështetje të doktrinës islame ashtu siç e paraqet njëri ndër njohësit e shquar të saj, autori i kësaj vepre. Kështu bie fjala në doktrinat e feve të ndryshme, madje edhe të kohës sonë, të cilat janë të radhitura në qëndrime kundërshtare në raport me fenë tonë thuhet gabimisht, por me bindje të qëllimshme se në islam nuk ka barazi, madje se islami lufton çdo gjë e cila nuk i përket asaj feje, për këtë edhe paraqitet në formë të fundamentalizmit islamik. Këto të pavërteta dhe shpifje ndaj Islamit humbin si shkumë sapuni dhe mund të vërehen shumë qartë në kapitullin ku Kardavi duke shpjeguar Islamin burimor konstaton se ai është shumë tolerant ndaj pjesëtarëve të feve të tjera dhe të gjithë atyre që nuk janë myslimanë. Me anë të shembujve të ndryshëm argumentohet se Islami nuk lejon shkeljen e të drejtave të të tjerëve, por kërkon respektimin e plotë të tyre në të gjitha porët e jetës me një kusht të vetëm që jomyslimani ose jomyslimanët të mos luftojnë kundër myslimanëve dhe të mos i ndjekin ata nga shtëpitë dhe trojet e tyre. Me shembuj konkretë gjithashtu shpjegohet se Muhamedi a.s. shpeshherë ka dërguar ndihma edhe në Medinë edhe pse qytetarët e këtij vendi janë sjellë keq ndaj tij. Ai madje është ngritur në këmbë kur në afërsi të tij ka kaluar një funeral dhe pasi që i kanë thënë se ai ishte një jahudi, pejgamberi është përgjigjur, pse a nuk është edhe ai njeri.

Vetë Muhamedi a.s. ka lënë porosi të veçanta për pasardhësit e tij që të kenë kujdes të jashtëzakonshëm ndaj koptëve të Egjiptit dhe të gjithë të tjerëve që jetojnë në bashkësi me myslimanët, të cilët nuk i përkasin fesë myslimane dhe atyre t'u sigurohen të gjitha të drejtat e mundshme në shtetin arab ku dominon ligji i sheriatit. Shembulli i tolerancës burimore të pashoqe ka treguar madje i Deleguari i Zotit të Madhërueshëm edhe me rastin kur këtë e ka vizituar një delegacion jomysliman dhe në kohën e pas ikindisë ata kanë hyrë në xhami, janë kthyer nga lindja dhe i kanë bërë ritet e tyre fetare. Disa myslimanë që kanë qenë prezentë kanë dashur ta ndalojnë këtë, por Muhamedi a.s. u ka thënë, leni që t'i bëjnë lutjet e tyre, sepse ata i drejtohen Zotit. Kjo tregon se edhe jomyslimanëve mund t'u lejohet t'i bëjnë lutjet e tyre në xhami, veçse kjo nuk është e lejueshme që të bëhet praktikë e përhershme.

Vetë fakti se Islami lejon edhe martesat me pjesëtarët e feve të tjera tregon se tolerante është feja e myslimanëve. Prandaj të gjitha komentimet qëllimkëqija që i bëhen bien poshtë nga vetë argumentet që sillen në këtë vepër të Kardavit për tolerancën e pashoqe që lejon islami.

Një pyetje tjetër që i është shtruar Kardavit ka qenë edhe kjo se a mund të lejohet që xhamia të bëhet arenë ku zhvillohen edhe debate politike. Shpjegimi i autorit mbështetet në të dhënat e pasura historike se xhamia është vend i dedikuar për ibadet, por ajo mund të shërbejë siç ka shërbyer gjatë historisë edhe si vend debatesh të ndryshme politike që kanë të bëjnë me Islamin dhe me sheriatin. Në xhami edhe Muhamedi a.s. edhe pasardhësit e tij kanë zhvilluar edhe debate të ndryshme politike që kanë qenë në shërbim të përhapjes së Islamit dhe

komentimit sa më të drejtë të tij. Xhamia ka qenë dhe është vend i mësimit dhe edukimit si dhe i debateve të ndryshme që bëhen për prosperitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Islamit.

Ata që e lexojnë këtë vepër të Kardavit, sipas mendimit tonë, mjaft interesante, do të kërkojnë edhe veprat e tjera të këtij autori, siç është vepra “Hallalli dhe harami në Islam” si dhe mbi 50 vepra të tjera të tij të botuara dhe të ribotuara nga disa herë në shumicën dërmuese të shteteve arabe, për ta njohur në thelb doktrinën e Islamit dhe për t’i zgjeruar njohuritë fetare dhe filozofike rreth shumë problemeve që dalin edhe në jetën tonë të përditshme.

Po të merret vepra të trajtohet në anën tjetër, në përkthimin e saj, do të mund të thuhej se autori i përkthimit, edhe ky njohës i mirë i Islamit, ka arritur të bëjë një përkthim adekuat në gjuhën shqipe duke respektuar në rend të parë kuptimin e plotë të saj në gjuhën arabe dhe përshtatjen në gjuhën shqipe në mbështetje të normave aktuale të saj . Kështu vepra del mjaft e rrjedhshme dhe e lehtë për t’u kuptuar, ashtu siç del në origjinal. Kjo do të thotë se fryma origjinale e veprës është ruajtur e paprekur në tërësinë e saj. Me këtë vepër autori i përkthimit ka pasur nderin që ta popullarizojë ndër lexuesit shqiptarë të Kosovës njërin ndër filozofët më të shquar të Islamit: Jusuf el Kardavin, të cilin autori i përkthimit e njeh personalisht dhe ka pasur dhe ka marrëdhënie miqësie me të.

F. RAKA

Kaçanik, prill 2002

ISLAMI DHE POLITIKA

Pyetje:

Gjatë viteve të fundit është bërë shprehi në popull dhe në literaturë të sekularistëve, të djathtëve e të majtëve, anarkistëve lindorë dhe liberalistëve perëndimorë që të përdoren terma të llojllojshme për islamin.

Nga këta terma të terminologjisë bën pjesë edhe termi “Islami politik”, i cili tregon islamin që ka të bëjë me çështjet e umetit islam dhe marrëdhëniet në punët e brendshme dhe të jashtme dhe veprimtarinë që pikësynon çlirimin nga çdo sundimtar i jashtëm, i cili projekton çështjet materiale dhe morale siç dëshiron vetë. Pastaj veprimtarinë për çlirimin nga rrënjët kolonialiste perëndimore si nga aspekti kulturor, shoqëror ashtu edhe ligjor që t’i kthehemi përsëri ligjit të Allahut të Lartëmadhëruar në të gjitha çështjet e jetës.

Këtë shprehje: “Islami politik” e kanë për qëllim dhe e përdorin për t’u larguar nga tematika e saj. Ç’është e vërteta edhe disa dijetarë të vërtetë flasin për islamin në përgjithësi duke e konsideruar burim dhe ligj të jetës, dunja dhe ahiret.

Nga aspekti i sheriatit ky term - “Islami politik”- a është i pranuar, dhe ndërhyrja e politikës në islam a është risi e dijetarëve bashkëkohorë apo kjo shprehje është çështje e bazuar dhe e dokumentuar në Kur’an dhe sunet?

Shpresojmë se do të na sqaroni këtë çështje në dritën e argumenteve të forta të sheriatit që të neutralizohet shkatërrimtari me argumente dhe të zhvillohet dhe të përparojë i gjalli, i dituri po ashtu me argumente. Zoti qoftë i pajtuar me ju dhe të kemi dobi nga sqarimi i juaj.

Muslimani i Devotshëm

Përgjigja:

E falënderoj Allahun, përshëndes të Dërguarin e Allahut, familjen e tij, shokët e tij dhe ata që pasojnë rrugën e tij.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje, vëlla mysliman i dashur, rreth asaj se jemi bërë rob të idesë perëndimore në kohët e fundit dhe rreth termit “Islami politik” e elaborojmë si vijon:

E para, ky term për Islamin është i papranueshëm.

Pse kjo është grackë të cilin e kanë vendosur armiqtë e Islamit që kanë për qëllim ndarjen e Islamit me metoda dhe mënyra të lloj-llojshme dhe nuk është Islam siç e ka zbritur Allahu dhe si besojmë ne myslimanët, por ka “islamizma” të lloj-llojshëm dhe të shumënumërt siç iu ka ëndja atyre.

Ata ndonjëherë e ndajnë Islamin në bazë të vendeve gjeografike p.sh. Islami aziatik, Islami afrikan etj.etj.

Ndonjëherë në bazë të epokave si Islami i kohës së Muhamedit a.s. [Nebevij], Islami i rashidinëve, Islami i umevijinjëve, Islami i abasinjëve, Islami i osmanlinjve dhe Islami modern.

Nganjëherë në bazë të popujve si p.sh. Islami arab, Islami hindus, Islami turqelinj, Islami malejzias etj.etj.

Nganjëherë në bazë të medhhebeve: Islami sunij, Islami shit. Pastaj Islamin sunij e ndajnë në lloje të ndryshme, po ashtu, Islamin shiit në lloje të ndryshme.

Kanë shtruar edhe ndarje të tjera të reja si Islami revolucionar, Islami i prapambetur ose Islami radikal e Islami liberal ose Islami i djathtistë ose Islami i mbyllur dhe Islami i hapur.

Dhe në fund Islami politik, Islami shpirtëror, Islami bashkëkohor dhe Islami idealist [Lahutij].

Por ende nuk e dimë se çfarë ndarjesh dhe çfarë definicionesh do të shpikin të nesërmen në iluzionet e tyre.

E vërteta është se të gjitha këto ndarje janë të papranueshme kategorikisht në aspektin islam, sepse nuk ka tjetër pos Islamit të vetëm. Një, duke mos i bërë shok atij [për të mos i bashkangjitur asgjë] dhe nuk pranohet asgjë tjetër përpos siç ka qenë Islami në fillim: Islam i Kur'anit dhe sunetit; Islam siç e ka kuptuar gjenerata më e lavdishme e umetit dhe më e mira e të gjitha epokave e sahabëve dhe kush e ka pasuar rrugën e tyre me drejtësi dhe sinqeritet siç i ka veçuar Allahu xh.sh. dhe i Dërguari i tij.

Ky ka qenë Islami i vërtetë para se të njollosej: pa asnjë njollë të njollave të çfarëdo sektit apo ekstremiteti, të çfarëdo filozofie të çfarëdo grupi dhe të çfarëdo epshi të konfrontuesit, shkatërruesit ose të ndonjë ideje të pabazë, ose të ndonjë injoranti.

E dyta, Islami është e pamundur që të jetë vetëm politik. Islami i vërtetë është absolut, ashtu siç e ka projektuar [ligjësuar] Allahu dhe kurrësi nuk mundet të jetë vetëm politik. Mirëpo nëse Islamin e zhveshim nga politika ne e kemi bërë fe jo islame dhe mundet të jetë ose budiste, krishtere apo diçka tjetër, ndërsa si Islam jo kurrësi.

Këtë e themi për dy arsye kryesore.

Islami ka qëndrim të qartë, ligj të qartë në shumë çështje të cilat janë thelb i politikës.

Islami nuk është fe idealiste apo vetëm adhurim [ibadet]; e kam për qëllim: nuk ka të bëjë vetëm në marrëdhëniet relacion njeri-Krijues dhe mos për të mos pasur lidhje në rregullimin e jetës ose organizimin e shoqërisë dhe të shtetit.

Jo kurrësi jo. Islami është besim, adhurim, jetë dhe ligj, projekt i jetës në tërësi, me fjalë të tjera: është plan-program i tërësishëm i jetës, sepse i ka vendosur parimet dhe rregullat, i ka themeluar rrugët e jurisprudencës që kanë të bëjnë me jetën e njeriut si individ, me jetën e njeriut në familje, pozitën dhe rolin e shoqërisë, bazat e shtetit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kush e lexon Kur'anin, sunetet dhe librat e fikhut në të gjitha medhhebet këtë e sheh qartë.

Edhe veprimtaria e “Ibadatëve” në fikhun islam nuk është larg politikës, sepse myslimanët janë të një mendimi sa i përket lënies së namazit, mosdhënies dhe pengimit të zekatit, ngrënies haptazi gjatë ditës së ramazanit dhe moskryerjes së haxhit për të cilat parashihet dënim dhe kërcënim, ndonjëherë parashihet edhe masë më rigoroze: sulmin për ata që haptazi i luftojnë dhe i pengojnë këto shtylla të Islamit, siç ka vepruar Ebu Bekri Sidik me penguesit e zekatit.

Po ashtu kanë thënë, nëse banorët e një vendi nuk i realizojnë disa prej suneteve që janë simbole Islame si p.sh. ezani, sunetimi i fëmijëve ose namazi i bajrameve, duhet të thirren për këtë dhe t’u afrohen argumente.

Nëse refuzojnë duhet të detyrohen deri sa t’i bashkohen unitetit islam.

Islami ka rregullat, ligjet dhe principet në politikën arsimore, kulturore, juridike, legjislativë, në politikën e pasurisë, në politikën e paqes, në politikën e luftës dhe për çdo çështje që ka të bëjë me jetën; nuk pranon që të jetë zero në të majtën por as nuk pranon që të jetë shërbëtor i filozofive apo i ideologjive të tjera por ka pikësynim që të jetë udhëheqës, prijës.

Po ashtu nuk pranon që ta ndajë jetën në mes tij dhe ndonjë prijësi tjetër dhe nuk e pranon thënien e cila është thënë për Mesihun a.s. “Jepi mbretit çka i takon mbretit dhe jepi Zotit çka i takon Zotit”.

Por filozofi e Islamit është çka është e mbretit por edhe mbreti është i Zotit. Një të vetmit, të cilit i takon çka ka në qiej dhe në tokë dhe çka ka në qiej dhe në tokë janë pronë e Krijuesit.

“Njësimi”[teuhidi] në Islam bazohet në atë se myslimani nuk ka Zot tjetër përpos Allahut dhe nuk merr përpos Allahut mbështetës dhe nuk kërkon ligj përpos ligjit të Allahut siç është shpjeguar në suren e “Njësimit” “Suretul-Enam”.

Besimi i Njësimit në esencë është produkt i realizimit të lirisë, barazisë dhe vëllazërimit njerëzor dhe që të mos marrin pronar [Zot] tjetër përpos Allahut dhe e demanton çdo adhurim të njeriut ndaj njeriut; për këtë arsye i Dërguari fisnik e përfundonte mesazhin kur ua dërgonte mbretërve të pasuesve të librit me këtë ajet fisnik:

“O pasues të librit ejani të [unifikoheni] në një fjalë të përbashkët që në mes nesh dhe në mes jush të ekzistojë vetëm adhurimi ndaj Allahut, të mos i bëjmë shok [rival] atij dhe mos të marrim Zotëra të tjerë as prej neve as prej juve, përpos Allahut. Dhe, nëse refuzojnë [nuk pranojnë] menjëherë thuajuni: dëshmoni pra se ne jemi myslimanë”.

Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore se idhujtarët e Mekës që në ditët e para të islamit janë ngritur kundër thirrjes islame menjëherë pas fjalës “La ilahe ilallah” [Nuk ka Zot përpos Allahut] pse e kanë kuptuar çka fshihet pas saj dhe çka përmban në esencë ndryshimi i jetës shoqërore dhe politike me ndryshimin fetar të asaj kohe.

Shkaku i dytë: personaliteti i myslimanit, siç e ka konstruktuar Islami dhe e ka projektuar besimi i tij, sheriatit [ligji] i tij, ibadeti i tij, morali i tij nuk janë asgjë tjetër përpos politike, përpos asaj çka e ka keqkuptuar në Islam ose e ka keqpërdorur ose nuk e ka praktikuar atë.

Islami te secili mysliman ka vendosur obligacionin e quajtur “*Për të urdhëruar në çdo të mire dhe për të ndaluar nga çdo e keqe*” e cila është shprehje e adresuar në adresën “Këshillë e umetit të muslimanëve dhe çdo gjë çka u takon atyre” dhe kjo është e vërtetuar edhe në hadithin ku kjo konsiderohet e tërë feja dhe synon porosi: të dominojë drejtësia, realiteti, porosit për durim. Që të dyja këto çështje janë kushtet themelore për të mos dështuar, por për të ngadhënjyer në këtë botë dhe për të shpëtuar në botën tjetër, siç e përshkruan “suretul asr”.

Muhamedi a.s. nxit për të mos lejuar çrregullti në çështje të brendshme, sepse është metoda më e mirë për t’u mbrojtur nga jashtë. Kur e kanë pyetur çka është xhihadi më i vlefshëm, ka thënë “Xhihadi më i mire është për t’ia thënë fjalën reale dhe të drejtë sundimtarit të padrejtë, pse çrregullia dhe shkatërrimi i brendshëm është strofull për të depërtuar armiku nga jashtë.

Kjo dëshmi [rënia dëshmor] konsiderohet prej dëshmime më të larta në rrugën e Allahut. Zotëri [më i miri] i dëshmorëve Hamza, pastaj njeriu i cili e thotë të drejtën para udhëheqësit të padrejtë dhe udhëheqësi urdhëron për t’u ekzekutuar”.

Në zemrën e myslimanit vazhdimisht mbillet refuzimi dhe kundërshtimi i padrejtësive edhe për t’i larguar të padrejtë, deri sa edhe duan e kunutit e përfundojmë me thënien “*Të falënderojmë Allah, nuk të mohojmë dhe largohemi dhe e izolojmë atë, i cili e tepron me padrejtësi*”.

Lufta lejohet për t’u shpëtuar të dëbuarit, të dobëtit, të cilët dëshirojnë të jetojnë në trojet e tyre edhe pse ata kanë mundësi për të migruar dhe për të ikur nga aty. Zoti i Madhëruar thotë:

“Po pse nuk do të luftoni ju në rrugë të Allahut kur të shtypurit prej burrave, grave dhe fëmijët të cilët luten e thonë “Zoti ynë, nxirrna neve nga ky vend dhe na shpëto nga banorët e këtij vendi të cilët janë kriminelë dhe mizorë dhe Ti na cakto mbrojtës dhe na jep ndihmë”.

SURETU NISA 75

Ndërsa meritojnë të shpëtohen dhe i kaplon hidhërimi nëse ata nënshtrohen dhe pajtohen me padrejtësinë e kriminelëve dhe qëndrojnë aty, kurse ata kanë mundësi për të migruar dhe për të ikur në ndonjë vend tjetër.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Kur engjëjt do t’ua marrin shpirtin atyre që kanë gabuar ndaj vetvetes do t’u thonë: “Ç’u bë me ju [ata përgjigjen] Kemi qenë të shtypur në tokë”; Do t’u thuhet atyre: “Vallë a nuk është toka e Allahut e gjerë që të emigroni të qarkulloni nëpër të”.

Prandaj vendi i atyre do të jetë në xhehenem; ah sa vendbanim i keq është ai [bëjnë përjashtim] përpos burrat e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët nuk

kanë pasur mundësi dhe nuk e kanë ditur rrugën [dhe nuk kanë gjetur mënyrë për të emigruar]. Allahu do t'ua falë, sepse Allahu është Ai që fshin dhe fal mëkatet.

SURETU NISA 97.98,99

Derisa edhe për të dobëtit, të paralizuarit, të paaftit Kur'ani thotë “Ndoshta Allahu do t'ua falë atyre”, pra e ka kushtëzuar, me fjalë të tjera e ka përdorur termin “ndoshta”; pra, kanë shpresë që t'ua falet gabimi prej Allahut. Këtë për arsye se janë pajtuar me nënçmim, padrejtësi e cila iu ka bërë atyre si myslimanë e që ka qenë dashur të refuzohet.

Kur'ani shpesh i ka përmendur se si janë shkatërruar kriminelët e fytyrës së tokës si p.sh. firauni, Hamani, Karuni dhe bashkëpunëtorët e ushtritë e tyre.

Allahu i ka përmendur për ta bindur myslimanin se ata janë shkatërruar dhe për këtë arsye nuk duhet shkuar hapave të tyre, por duhet urrejtur për veprimtaritë e këqija të tyre dhe duhet ta dijë myslimani se ata janë shkatërruar prej Allahut për shkak të padrejtësisë ndaj të dobëtëve.

Kur'ani dhe suneti tregojnë se heshtja ndaj të keqes dhe qëndrimi pasiv ndaj atyre që bëjnë keq, pa marrë parasysh a është sundimtar apo i sunduar, e dridh dhe e zgjon çdo njeri që ka iman sa grimca e atomit

Janë të mallkuar ata që kanë mohuar prej beni israilëve në kohën e Davudit dhe deri te Isa, i biri i Merjemes. Kjo për arsye se kanë gabuar dhe kanë treguar armiqësi [pse] për arsye se nuk janë larguar nga e keqja kur është bërë te ta, por sa keq kanë vepruar.

SURETU MAIDE

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kush e sheh prej juve ndonjë të keqe le ta largojë me duart e tij, nëse nuk mundet[me gjuhë] me zemrën e tij [ta kundërshtojë dhe kurrë mos të pajtohet me atë të keqe] por në këtë rast imani është më i dobët”.

Gabim katastrofik është të mendohet se e keqja ka të bëjë vetëm në prostitucionin, pirjen e alkoolit dhe të ngjashme.

Poshtërimi, nënçmimi i nderit kombëtar është e keqja e të gjitha të këqijave; falsifikimi i zgjedhjeve është e keqe e të gjitha të këqijave, pse ajo është fshehje e dëshmisë; emërimi në post atë i cili nuk e meriton është e keqe e të gjitha të këqijave, pse kjo konsiderohet fshehje e dëshmisë, pra për t'ia dorëzuar detyrën atij që nuk e meriton është e keqja e të gjitha të këqijave. E keqe e të këqijave është edhe vjedhja ose keqpërdorimi i pasurisë shoqërore.

Monopolizimi i artikujve për të cilët ka nevojë populli është shumë e keqe. Burgosja e njerëzve të pafajshëm prej prokurorisë publike është e keqe e të gjitha të këqijave. Maltretimi i të burgosurve nëpër burgje është e keqe e të gjitha të këqijave. Mito [ryshfeti] [si pranim dhënia apo ndërmjetësim] është e keqe e të gjitha të këqijave. Keqpërdorimi i mjeteve të qeveritarëve dhe mbulesat me falsifikime është e keqe e të gjitha të këqijave. Fqinjësia me armiq të Allahut e me armiq të umetit në vend të fqinjësisë me besimtarët është e keqe e të gjitha të këqijave.

Kështu ne shohim të këqijat zgjerohen dhe zgjerohen aq shumë sa që njerëzit i konsiderojnë bazë të politikës.

Pra a është e mundur që myslimani i vërtetë, dashamir i fesë që synon të jetë i kënaqur Allahu me të, të heshtë apo të tërhiqet nga fusha e betejës duke ikur para këtyre të këqijave dhe të këqijave të tjera, vetëm e vetëm që ai të shpëtojë.

Nëse ky opinion përhapet në umeti, ka përfunduar puna e tij dhe është caktuar për dështim pse ai ka kaluar në umet tjetër e jo siç e ka përshkruar Kur'ani:

“Ju jeni umeti më i miri i zgjedhur prej njerëzve pse urdhëroni në të mira dhe largoni nga të këqijat dhe besoni në Allahun”.

SURETUL ALI IMRAN 110

Nga kjo që thamë më lart nuk mund të na habit fakti kur Muhamedi a.s. i ka tërhequr vërejtjen umetit duke i thënë: **“Nëse e sheh umetin tim që frikohet t’ i thotë të padrejtit: “o i padrejtë”, ai ka humbur vlerën [qëllimin], e ekzistimit të tij.** Në disa transmetime të tjera thuhet: “Më mire të jesh myslimani i varrosur në tokë se i gjallë mbi tokë”.

“Imani” e obligon myslimanin që të mos qëndrojë indiferent ndaj të keqes pa marrë parasysh ajo e keqe a i takon politikës, ekonomisë, është e keqe shoqërore apo kulturore, përkundrazi ai duhet të qëndrojë i fortë, të ballafaqohet dhe të angazhohet që të keqen ta largojë me dorë; nëse nuk mundet atëherë me gojë duke i sqaruar çështjet; nëse është i paaftë t’ i largojë gjërat me gojë, atëherë kalon në fazën më të ulët-ndryshimin e së keqes me zemër, të cilin hadithi e shpjegon se në at rast imani është më i dobët.

I dërguari [a.s.] e ka quajtur “largim me zemër”, sepse ajo e mundon zemrën dhe nuk lejon për t’ u pajtuar me të keqen. Ky qëndrim nuk konsiderohet çështje negative siç mendojnë disa edhe pse hadithi e ka quajtur “ndryshim”.

Kjo gjendje vazhdon t’i ngacmojë shpirtat vazhdimisht, i ngjall ndjenjat, i përforcon zemrat, të cilat një ditë bëhen revolucionare dhe sjellin rezultate pozitive dhe një ditë ngrihen në revolucion, sepse çdo shtypje patjetër rezulton shpërthim; ky është ligj i Zotit të krijesat e tij.

Edhe pse ky hadith e përshkruan këtë si “ndryshim me zemër”, një hadith tjetër e cilëson si “revolucion i zemrës”; kjo është shkalla e fundit e revolucionit pasi që është edhe shkalla e fundit e imanit dhe më e dobëta.

Transmeton Muslimi nga Ibn Mes’udi [Hadith Merfuë] se Muhamedi a.s. ka thënë se çdo pejgamber, të cilin e ka dërguar Allahu para tij ka pas shokë përkrahës dhe faqebardhë të cilët kanë shkuar pas rrugës së tij, dhe i kanë kryer urdhrat e tij, por pastaj gjeneratat pas tyre kanë thënë diçka tjetër e kanë vepruar diçka tjetër: kanë urdhëruar, e vetë nuk kanë vepruar. Kush i lufton ata me dorë është besimtar, kush i lufton me gjuhë është besimtar, kush i lufton me zemër është besimtar; pas të gjitha këtyre nuk ka iman as sa kokrra e bizeles”.

Ndoshta individi është i paaftë për t’u ballafaquar me të keqen, posaçërisht kur përhapen të këqijat dhe janë të fuqishme ose e keqja vjen prej sundimtarëve dhe ata janë të parët, të cilët i likuidojnë ata të cilët e luftojnë të keqen dhe veprojnë si të donë.

Kjo i ngjason thënies popullore “Rojtari haram [vjedhësi] apo siç thotë poeti bariu i deleve është ujku, por çka ndodh nëse janë barinj të gjithë ujkit.

Në këto raste bashkëpunimi i largimit të keqes është obligim [farz] pa kurrfarë dyshimi, pse është bashkëpunim, bashkëveprim dhe koordinim në të mire dhe në devotshmëri dhe ky bashkëveprim dhe aktivitet shoqëror në mes të shoqatave duhet të jetë i organizuar në forma e mënyra të tjera të përshtatshme. Ky aktivitet është farz, të cilin e ka obliguar feja, por në të njëjtën kohë është domosdoshmëri e kohës.

S’ka dyshim se në terminologjinë bashkëkohore përdoret shprehja “e drejtë” e njeriut ndërsa në islam ky është farz i shenjtë, kush i shkel të drejtat e njeriut ka bërë mëkat të madh dhe do të dënohet me dënimin më të ashpër prej Allahut.

Ka dallim të madh në mes të së drejtës e cila është “e lejuar” [mubah] dhe të të së drejtës e cila është “obligative” [farz], të cilën njeriu nuk guxon ta shkelë, as nuk guxon të qëndrojë indiferent në ligjin islam.

Ajo çka e bën myslimanin që gjithmonë të jetë “politik” është se që në moment kur të besojë në Allahun, të mos jetojë i vetmuar, i izoluar nga shoqëria të mos jetë indiferent ndaj brengave dhe problemeve të besimtarëve pse “Vërtet besimtarët janë vëllezër”.

Në hadith qëndron teksti “Kush nuk brengoset, kush nuk kujdeset për çështjet e myslimanëve, nuk është prej tyre dhe çdo njeri që flenë i ngopur, ndërsa e di se fqinji i tij është i uritur, nuk do të jetë në përkujdesjen e Allahut dhe të Dërguarit të tij”.

Islami e obligon myslimanin për t’i ushqyer të varfrit dhe nuk mund të jetë si në kohën e injorancës kur i ka mallkuar Kur’ani në ajetin

“Jo kurrresi jo, por ju jeni ata të cilët nuk i keni nderuar, nuk i keni respektuar jetimët dhe nuk jeni angazhuar, nuk keni insistuar për t’i ushqyer të varfrit”.

SURETUL FEXHR 17,18

Për ata të cilët nuk i nderojnë jetimët dhe nuk angazhohen për t’i ushqyer të varfrit Kur’ani thotë se janë “paprane” dhe kundërshtarë të ditës së gjykimit”:

“A di ti kush nuk e beson ditën e gjykimit? Është ai i cili sillet ashpër me jetimët dhe nuk angazhohet për t’i ushqyer të varfrit.

Vërtet ai nuk beson Allahun e Madh. Dhe nuk insiston dhe nuk angazhohet për t’i ushqyer të varfrit”.

SURETUL MAUN 1,3

Kjo çështje ka të bëjë për shoqëritë kapitaliste dhe për vendet ku i shkelin të drejtat humanitare të të varfërve, të të dobëtëve. Në këto raste islami insiston për t’u ngritur kundër të pasurve, për t’i realizuar të drejtat e tyre të varfrit.

Si kërkohet prej myslimanit të ngritë zërin kundër padrejtësisë shoqërore, ashtu duhet të ngrihet zëri kundër padrejtësisë politike dhe kundër çdo të padrejte pa marrë parasysh nga vjen ajo. Heshtja ndaj të padrejtës meriton dënim të madh: jo vetëm i padrejti, por edhe ai i cili hesht. Zoti i Madhëruar thotë: **“Ruajuni**

sprovimit i cili mund t' ju kaplojë posaçërisht juve nga të padrejtët dhe kriminelët”.

SURETUL ENFAL 25

I ka mallkuar Kur'ani popujt të cilët iu kanë nënshtruar dhe i kanë dëgjuar kriminelët, dhunuesit dhe kanë qenë bashkëpunues dhe bashkëveprues të tyre, siç është rasti me popullin e Nuhit a.s.

“Dhe kanë pasuar atë i cili nuk i ka shtuar as pasurinë e tij [e ka shkatërruar] dhe as pasardhësit [fëmijët e tij], por vetëm i ka shpie në humbje dhe shkatërrim [vërshimën ndërkombëtare]”.

SURETU NUH 21

Ndërsa për popullin e Hudit thotë:

“Dhe kanë pasuar urdhrat e çdo dhunuesi kokëfortë”.

SURETUL HUD 113

Për popullin e firaunit thotë:

Dhe ai [firauni] e frikësoi popullin e vet dhe iu përulën. Ai [popull] me të vërtetë u bë popull mëkatar.

SURETUL ZUHRUF 54

Po ashtu Kur'ani ka paraparë dënim të Allahut vetëm e vetëm nëse përkrahen, nëse anohet dhe nëse pëlqehen të padrejtët dhe kriminelët.

“Mos anoni dhe mos u mbështetni në ata të cilët bëjnë padrejtësi se ju kaplon zjarri e pastaj nuk do të gjeni dashamirë dhe as ndihmëtarë përpos Allahut”

SURETUL HUD 113

Islami e ngarkon çdo mysliman me përgjegjësi politike për të jetuar në shtet islam, ku punohet dhe gjykon ligji Islam, për të votuar për prijësin islam, se përndryshe i takon injorantëve. Në Hadithin Sahihë Muhamedi a.s. thotë:

“Kush vdes dhe në zemrën e tij nuk dëshiron dhe nuk e përkrahë [voton] prijësin islam, ka vdekur si injorant”.

Transmeton Muslimi në Sahihë

Përpos kësaj, kur myslimani të ndodhet në mes të namazit deri sa ai lexon Kur'anin [i cili është farz] ai ka hyrë në detin e politikës pse i lexon ajetet të cilat janë bazë “politikës”, siç i konsiderojnë njerëzit.

Kush e lexon “Suretul Maide”, ku ka ajete, ku urdhërohet për të gjykuar me ligjet e Allahut dhe sqaron se kush nuk gjykon me ligjin e Allahut ai është, gabimtarë i madh, i padrejtë dhe pabesimtarë:

“Dhe kush nuk gjykon me atë çka ka zbritur Allahu [me ligjin e Allahut], ata janë pabesimtarë”.

SURETUL MAIDE 44

“Dhe kush nuk gjykon me atë çka ka zbritur Allahu [me ligjin e Allahut] ata janë të padrejtë”.

SURETUL MAIDE 45

“Dhe kush nuk gjykon me atë çka ka zbritur Allahu [me ligjin e Allahut] ata janë gabimtarë të mëdhenj”.

SURETUL MAIDE 47

E shihni se këto ajete janë bazë në politikë; ndoshta prej të tjerëve konsiderohet ekstremist pse ai ka lexuar ajete të cilat e akuzojnë sistemin, qeverinë apo prijësin pse ai i ka përshkruar si pabesimtarë, të padrejtë dhe gabimtarë dhe ka insistuar për të gjykuar me ligjin e Allahut.

Shembull kemi edhe leximin e ajeteve të cilat kanë të bëjnë me miqësinë dhe pabesimtarët:

“O ju të cilët keni besuar, mos miqësoheni me mosbesimtarë në vend se me besimtarë. A do t’i tregoni Allahut argument flagrant kundër vetvetes?”

SURETU NISA 144

“Besimtarët le të mos marrin për miq mosbesimtarët kur kanë besimtarë, sepse kush vepron kështu nuk ka asgjë nga ndihma e Allahut, përveç nëse seriozisht frikësoheni prej Tij; Allahu ju ofron kujdesin e vet dhe tek Allahu është përfundimi”.

SURETUL ALI IMRAN 28

O ju të cilët keni besuar, mos e merrni për mik armikun tim dhe tuajin duke u shprehur atyre simpati e dashuri e ata mohojnë të vërtetën që ju ka ardhur juve.

SURETUL MUMTEHINE 1

O ju të cilët keni besuar, për miq të singertë mos merrni të tjerët jashtë mesit tuaj, të cilët u dëshirojnë shkatërrimin dhe mezi presin që të hidheni në mundime. Ata me fjalët e tyre shprehin urrejtje ndërsa ajo çka fshehin në zemrat dhe kraharorët e tyre është shumë më e madhe.

SURETUL ALI IMRAN 118

Kush e këndon duan e kunutit e cila në fikhun islam është duaja e cila këndohet në rekatin e fundit të vitër namazit pas namazeve farze dhe posaçërisht kur këndohet me zë që është e ligjësuar vetëm me rastet kur myslimanët janë të nënçmuar dhe të poshtëruar ose në rastet e luftëtarëve, ose në rastet e tërmeteve, ose në rastet e vërshimeve, ose në raste të varfërisë së madhe etj.etj.

Ende e mbaj mend kur Imami dëshmor Hasan Beanna, kur ishte Egjipti nën kolonializmin anglez, e pat shkruar në revistën “*Vëllezërit mysliman*” duan edhe pse nuk e ka pasë bërë obligative, por e ka propozuar që në namaz gjatë duasë së kunutit të bëhet edhe duaja në këtë formë si vijon:

“O Zot i të gjithë botëve, siguries i të frikuarve, poshtërues i kryelartëve, dhe ngadhënjimtarë i kriminelëve; O Zot Ti e di se këta janë kolonizatorë, uzurpues të tokës sonë dhe shkelës të drejtave tona, shkatërrimtarë të vendit tonë dhe kriminelë në vendin tonë. O Zoti ynë mos na le të bimë në grackat e tyre, poshtëroje sundimin e tyre, largoji nga vendi ynë dhe mos lejo që ata të nënshtrorjnë asnjë prej robërve tu besimtarë. O Zoti ynë dënojnë ashpër ata, ndihmëtarët e tyre , përkrahësit e tyre dhe simpatizuesit e tyre”.

Kështu ne kemi hyrë në fushën e politikës, kemi shprehur dhe ndjenjat tona deri sa qëndrojmë mihrab, në namaz të nënshtruar vetëm ndaj Allahut kjo është natyrshmëri dhe realitet i Islamit. Nuk mundet kurrë që feja të ndahet prej

dynjasë dhe nuk mundet kurrë që dynjaja të shkëputet nga feja. As Kur'ani as suneti dhe as historia nuk njeh fe pa shtet dhe as shtet pa fe.

Ata të cilët kanë thënë se feja nuk ka lidhje me politikë, ata kanë imagjinuar, kanë shpifur shpifjen me thënien “Feja nuk ka politikë” dhe “Nuk ka politikë në fe” ata kanë thënë rrena të kulluara.

Dhe deri sa ata e marrin fenë në shërbim të politikës së tyre dhe derisa i kanë mashtruar disa të paditur, dhe të dobët të cilët nuk kanë pasur njohuri në fe, kanë përdorur pastaj fetvatë e tyre kundër kundërshtarëve të politikës së tyre; kështu ata e kanë pasivizuar edhe dynjanë edhe fenë.

Ende e mbaj mend kur është aprovuar urdhri për t’u dënuar me burg të përjetshëm ose kryqëzim, ose të na priteshin këmbët e duart deri sa ishim në burgun Tur gjatë viteve 1948,1949 për ne dijetarët, pse dëshironim që të praktikohet ligji islam dhe të qeverisë “Islami”; imagjinonin shpifje se ne luftojmë Allahun dhe të Dërguarin e tij dhe angazhohemi për çrregullime në tokë.

Kjo është përsëritur edhe herëve të tjera; drama është përsëritur vetëm se janë ndryshuar aktorët.

Ende e mbaj mend, po ashtu edhe të tjerëve u kujtohet, kur është kërkuar prej dijetarëve për të dhënë fetva se është e lejuar dhe e ligjshme islame për t’u pajtuar me Izraelin, për ta përkrahur politikën dëbuese të Izraelit pasi që vetëm dijetarët kishin dhënë fetva për ndalimin e pajtimit me politikën izraelite për dëbimin masovik të palestinezëve nga trojet e tyre. Për të vepruar siç kërkonin politikanët prej dijetarëve ishte tradhti ndaj Allahut, ndaj të Dërguarit dhe ndaj myslimanëve.

Edhe sot qeveritarët kërkojnë mbështetje te dijetarët fetarë islamë për të dhënë fetva sipas epsheve të tyre politike, më e fundit është fetvaja për lejimin e kamatës. Ata të cilët janë dijetarë të plogësht, të ligisht në fe dhe kanë dituri të mangët, i janë përgjigjur kërkesave të tyre, ndërsa të thelluarit në dituri dhe dijetarët e vërtetë i kanë refuzuar kategorikisht.

“Ata të cilët përcjellin vendimet [traktatet] e Allahut dhe i frikohen vetëm Atij, nuk i frikohen askujt përpos Allahut”.

SURETUL AHZAB 39

A është politika çështje e urrejtur?

Politika në aspekt studimor shkencor është shkencë e cila ka pozitë të lartë dhe rendësi të posaçme; pra nga aspekti shkencor, është profesion i dobishëm dhe me vlerë, sepse ajo merret me projektimin e planit të krijesave sa më mirë.

Imami i njohur Ibn Kajim transmeton nga Ebi Vefaë bin Akili Hambeli se: *“Politika është veprimtari me të cilën njerëzit mund që të afrohen dhe të pajtohen mes vete dhe të mos lejojnë çrregullti në tokë, deri sa nuk veprojnë në kundërshtim me ligjin natyror-ligjin e Allahut”.*

Ibn Kajmi shpjegon se politika e drejtë nuk mund të jetë në kundërshtim me atë çka është ligji i Allahut, por përkundrazi harmonizohet dhe përputhet me të, gjithashtu është pjesë e saj; ne e quajmë në bazë të terminologjisë: “Drejtësia e Allahut dhe e të Dërguarit të tij”.

Për këtë çështje kanë folur edhe dijetarët e hershëm duke e ngritur vlerën e politikës dhe rëndësinë e saj. Prej tyre dijetari i njohur Gazali ka thënë:

“Vërtet dunjaja është bashqë e ahiretit, dhe nuk mund të kompletohet kjo fe pa dunjanë. Qeverisja dhe feja janë bineq. Feja është bazë, qeveritarët ruajtës; çdo gjë që nuk ka bazë është e caktuar për shkatërrim. Çdo gjë që nuk ka ruajtës është e caktuar të humbë”.

Dijetarët çështjen e “Imamit” ose të Hilafetit e kanë definuar si zëvendës i të Dërguarit të Allahut në ruajtjen e fesë dhe të politikës së dynjasë; me fjalë të tjera zëvendës për të gjitha çështjet të cilat i ka projektuar Ligjdhënësi, pra Hilafeti është politikë mbrojtëse dhe siguroese.

Muhamedi a.s. nga ky aspekti ka qenë komunikues d.m.th. ka sjellë komunikatë, ka qenë dijetar dhe prokuror. Pas tij Halifet e drejtë kanë qenë politikanë, sepse e kanë vazhduar rrugën e tij dhe plan-programin e tij, kanë qeverisur umetin me drejtësi dhe barazi, kanë udhëhequr me dituri dhe iman [besim] të plotë. Mirëpo njerëzit e kohës sonë dhe vendet tona nga shkaku se kanë vuajtur shumë prej politikës dhe politikanëve dhe, sidomos duke filluar prej politikës kolonialiste, politikës së qeveritarëve tradhtarë e deri te politikanët mizorë dhe të padrejtë, për këtë arsye e urrejnë politikën dhe çdo gjë që ka të bëjë me të, deri sa ka lindur edhe ideja filozofike se udhëheqja me politikë është e ndaluar. Thuhet se Shejh Muhamed Abduhu pasi që është torturuar dhe ka përjetuar tradhti politike ka thënë:

“Kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga politika
E edhe prej atij i cili merret me politikë
Edhe prej çështjes së politizuar
Kërkojmë mbrojtje prej udhëheqësit politik
Dhe prej të udhëhequrit politik”

Këtë thënie armiqtë e Islamit e kanë përdorur për qëllimet e tyre: e kanë penguar aktivitetin islam, i kanë mbyllur sytë e myslimanëve nga politika, i kanë izoluar ata dhe i kanë larguar myslimanët nga Islami gjithëpërfshirës dhe komplet duke përdorur termin “Islami politik” dhe duke propaganduar se Islami nuk duhet të merret me politikë kështu që pastaj “myslimanin politikan” e kanë urrejtur, e kanë nënçmuar, e kanë larguar dhe e kanë izoluar. Kështu që sot është bërë zakon për të bërë dallim ndërmjet “myslimanit të devotshëm” dhe “myslimanit politikan”. Disa vajza nga Maroku nuk kanë mundur të regjistrohen në fakultet, vetëm pse kanë qenë të veshura me mbulojë islame dhe kanë pasur ndjenja “politike”. Më vonë ato i kanë kushtëzuar se nëse nuk e veshin mbulojën islame do të jenë të pranuar. Ato janë kushtëzuar me zbulim të kokës, me veshje gjysmëlakuriqe e cila është haram në Islam: ndalesë të cilën e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i tij. Edhe më mahnitës është fakti kur dekani i fakultetit u ka thënë atyre se mbuloja është veshje politike. Një tjetër mbulojën islame e ka quajtur veshje e një vendi apo traditë e ndonjë vendi.

Një laik namazin e bajrameve e ka konsideruar si namaz politik e nuk e ka konsideruar si namaz sunet.”Itikafi” në dhjetë ditët e fundit qëndrimi në xhami,

konsiderohet prej disave qëndrim politik. Nuk do të shkojë larg kur do të thonë se namazi i xhumasë nuk është asgjë tjetër përpos namaz politik, ndërsa leximi i pjesëve të Kur'anit, të cilat kanë të bëjnë me tematika nga luftërat dhe biografia e Muhamedit a.s. të konsiderohen “lexime politike”. Në fund do të thonë se vetë leximi i Kur'anit është lexim politik. Mos të harrojmë t'u themi atyre se mësimi përmendësh i suretul ENFALË është sure e luftës.

ISLAMI DHE DEMOKRACIA

Pyetja:

Nuk mund të fsheh atë që më ka befasuar kur kam dëgjuar nga disa që janë fetarë (disa prej të cilëve janë edhe në Shoqatën Islame) duke deklaruar se demokracia është në kundërshtim me Islamin. Njëri prej tyre shkoi aq larg sa që e perseritte fjalën e disa dijetarëve se “Demokracia është kufr – pabesim”. Ata argumentonin se demokracia insiston qeverisjen e popullit me popull, ndërsa në Islam populli nuk është gjykues dhe qeveritar, sepse qeveritar është vetëm Allahu, duke cituar ajetin Kur'anor - “Vërtet gjykimi dhe qeverisja i takojnë vetëm Allahut”.

SURETUL ENAM 57

Kjo i përngjan mendimit të havarixhëve në të kaluarën, të cilëve Aliu r.a. iu është kundërpërgjigjur: “Fjali e saktë, por me të kanë për qëllim të keqën”.

Ndërsa në mjediset e liberalëve dhe të tjerëve është përhapur mendimi se myslimanët janë armiq të demokracisë dhe përkrahës të diktaturës dhe të autokracisë.

A është e vërtetë se Islami është armik i demokracisë dhe a është demokracia pjesë e pabesimit dhe sistem i keq, siç pretendojnë ata ? Apo ndoshta Islami është i pastër nga këto deklarime, siç thonë ata.

Çështja ka nevojë të sqarohet nga fukahatë mesatarë të cilët nuk kalojnë kufijtë dhe nuk devijojnë deri sa të vendosin çështjen në vendin e merituar dhe nuk e ngarkojnë Islamin me komentime jo të vërteta, edhe pse ato komentime i bëjnë dijetarët, të cilët janë njerëz e ata mund t'ia qëllojnë, por edhe mund të gabojnë.

E lusim Allahun që t'u ndihmojë për ta qitur të vërtetën në shesh, dhe të japin shpjegimin e vërtetë, duke larguar dyshimin me argumente të forta e të jenë falënderues dhe të shpërblyer prej Allahut.

Përgjigja:

Më habit fakti kur njerëzit i ngatërrojnë çështjet dhe të drejtën e konsiderojnë të keqe dhe kjo posaçërisht kur ndodh te besimtarët e drejtë dhe te disa filozofë islamë “mutekeliminë” dhe ndodh që pyetësi, vëlla mysliman, më bën që të sqaroj këtë çështje dhe për këtë e falënderoj Allahun. Aq shumë është polemizuar kjo çështje sa që i quajnë pabesimtarë ose gabimtarë të mëdhenj personat e tillë dhe ata veten të pastër, thuaja se nuk konsiderohet shpifje dhe gabim të quhen ashtu. Frikohem se kjo shpie në tradhti ndaj fesë, siç ka ardhur e argumentuar në hadithin sahihë.

Kjo pyetje e parashtruar, vëlla fisnik, nuk më befason, sepse është parashtruar shumë herë në Algjeri dhe pikërisht në formën “A konsiderohet demokracia pabesim?”

Interesant, disa njerëz demokracinë e gjykojnë si çështje të urrejtur ose pabesim, sepse nuk e njohin realitetin, nuk e kuptojnë esencën e demokracisë dhe nuk hyjnë në brendi të saj, pa marrë parasysh çfarë forme dhe çfarë adrese ka ajo.

Është rregull e fikhut, të cilën e kanë definuar dijetarët e mëhershëm se: *“Gjykimi për një çështje është dega e paragjykit dhe kush gjykon për një çështje pa e ditur mirë, ai ka gjykuar gabim edhe nëse ia ka qëlluar”*. Sepse ai gjykim konsiderohet shënjestër pa gjuajtur në cak. Për këtë arsye është vërtetuar në hadithe se: *“Gjykatësi, i cili gjykon pa dije, shkon në xhehenem, sikurse ai i cili e di të vërtetën, por nuk gjykon drejt”*.

A është demokracia për të cilën thërrasin popujt e botës, për të cilën kanë shpenzuar shumica e popujve si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, për të cilën ka pasur konfrontime në mes të shumë popujve të botës me kriminelë dhe për të cilën është derdhur gjak dhe me mijëra e miliona janë sakrifikuar si në Evropën Lindore po ashtu edhe në vende të tjera, të cilën edhe shumë dijetarë islamë e konsiderojnë si sistem të pranuar për rrëzimin e sistemeve moniste dhe burokratike? Për të janë maltretuar popuj të tërë myslimanë. A kjo demokraci është e urrejtur dhe pa besim, siç pretendojnë disa dijetarë sipërfaqësorë dhe të ngutshëm?

Esenca e demokracisë, duke mos i llogaritur definicionet dhe determinimet akademike, është që njerëzit të zgjedhin qeverinë, e cila e udhëheq politikën dhe çështjet e tyre dhe të mos imponohet ndonjë udhëheqës, të cilin e urrejnë apo të mos imponohet ndonjë sistem, të cilin e urrejnë. Vetë populli ka të drejtë të kërkojë llogari nga qeveritari nëse gabon. Vetë populli ka të drejtë ta largojë nga detyra qeveritarin, nëse devijon. Dhe që popullit mos t'i imponohet ndonjë program si ekonomik, si kulturor, si shoqëror, si politik, të cilin ai nuk e njeh dhe nuk e dëshiron. Dhe nëse disa e kundërshtojnë, atëherë për ta të mos fillojë dënimi, internimi, burgimi ose edhe dënimi me vdekje (ekzekutimi).

Nga kjo esencë e demokracisë së vërtetë njerëzit kanë gjetur metoda praktike si p.sh. zgjedhje të lira, referendum, emërimi me shumicë votash, formimi i shumë partive politike, të drejtat e minoriteteve, opozita, e drejta e të shprehurit të lirë, sistemi juridik i pavarur etj.

A do të thotë se kjo demokraci, të cilën e përmendëm më sipër, është në kundërshtim me Islamin? Prej nga vjen ky kundërshtim? Prej çfarë argumenti të qartë nga Kur'ani apo nga suneti vjen ky mendim dhe ky akuzim?

E vërteta është se ai i cili e analizon esencën e demokracisë, e kupton se ajo është prej brumit islam.

Islami e konsideron çështje të urrejtur “mekruh” që imam i namazit të jetë ai, të cilin e urren xhemati dhe nuk e dëshiron. Në hadithe Muhamedi a.s. thotë: **“Tre personave nuk u pranohet - nuk u ngrihet as një pëllëmbë mbi kokë – namazi-** e prej tyre e ka përmendur të parin: **-njeriu i cili bëhet imam, udhëheqës i një populli dhe atë e urrejnë apo nuk e dëshirojnë”**.

Nëse kjo ka të bëjë me namazin, po si qëndron puna me çështjet e jetës dhe të politikës. Në hadithe Sahih qëndron teksti: “ **Duani prijësit tuaj, qeveritarët tuaj, pse ata i doni dhe ju duan shkakun se ju kërkoni “çka ju nevojitet prej tyre” dhe ata i realizojnë “çka kërkoni prej tyre”**. Ndërsa udhëheqësit më të këqij janë ata të cilët i urreni dhe ju urrejnë, i qortoni dhe ju qortojnë, i mallkoni dhe ju mallkojnë”.

Kur’ani ka kritikuar shumë ashpër qeveritarët kryelartë dhe çrregullues në fytyrën e tokës, të cilët robërit e Allahut i konsiderojnë robër të tyre si p.sh. rasti i Nemrudit; Kurani e përshkruan qëndrimin e Nemrudit ndaj Ibrahimit dhe të dytit ndaj të parit.

“A nuk e ke parë atë, i cili është kundërshtuar me Ibrahimin për Zotin e tij, atëherë kur Allahu i dha pushtet”?

Kur Ibrahim i tha:-”Zoti im është ai, i cili ngjall dhe vdes”“ ai iu përgjigj -”Unë ngjall –krijoj jetë-dhe vdesë”. Ibrahim i tha:”Allahu njëmend bën që dielli të lindë në Lindje, hajde bëje ti t’ia shkrepë nga Perëndimi. Dhe mosbesimtari u step. Allahu pra, nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin mizor”.

SURETUL BEKARE 258

Ky kriminel ka pretenduar se i ngjall dhe i bën që të vdesin krijesat, sikurse Zoti i Ibrahimit –Krijues i gjithësisë- i cili bën që të ngjallin dhe të vdesin “krijesat” dhe duhet që atij t’i nënshtrohen si i nënshtrohen Zotit të Ibrahimit.

Është thënë në lidhje me këtë se gjatë bisedës apo në konfrontimin midis Ibrahimit dhe Nemrudit si udhëheqës kanë kaluar dy qytetarë dhe ai, Nemrudi, pa hamendje dhe pa kurrfarë faji e gjykon njërin me ekzekutim dhe e mbyt, ndërsa tjetrin e fal; me fjalë të tjera nuk e gjykon dhe e liron, dhe thotë: “Ja unë ngjalli. A nuk është kjo vdekje-ngjallje?”.

Në të njëjtën mënyrë ka vepruar firauni (faraoni), i cili e ka thirr popullin e tij e i ka thënë: “Unë jam Zoti i juaj më i madhi”. Dhe me kryelartësi ka vazhduar-”O ju popull nuk di se për juve ka ndonjë Zot përpos meje”.

Kur’ani na ka zbuluar tri forma të sundimit të keq:

E para: qeveritari kokëfortë, kryelartë, i cili në tokën e Allahut i bën robër “i sundon” robërit e Allahut – ai përfaqëson firaunin.

E dyta: politikani shërbëtor i sundimtarit, i cili e shfrytëzon mençurinë, përvojën dhe eksperiencën e tij në shërbim të kriminelit vetëm për ta përforcuar pozitën e tij dhe që populli t’i nënshtrohet atij, e ai përfaqëson Hamanin.

E treta: politikani kapitalist-egoist, i cili e shfrytëzon sundimin e kriminelit duke investuar pasuri për të fituar kapitale të shumta, thith djersën dhe gjakun e popullit, ai përfaqëson Karunin.

Kur’ani i përshkruan këta tre udhëheqës politikanë, të cilët kanë udhëhequr me mizori dhe armiqësi dhe në ballë kundër tyre ka qëndruar Musa a.s. me

mesazh të qartë deri sa Allahu i ka dënuar me një dënim meritor. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Ne Musanë e kemi dërguar me mrekullitë tona dhe me argumente të qarta te firauni, Hamani dhe Karuni, por ata thanë-”është magjistar dhe rrenacak”.

SURETUL MUEMIN 23-24

Edhe Karunit, firaunit dhe Hamanit, Musa u solli argumente të qarta, por ata treguan mendjemadhësi në tokë, mirëpo nuk shpëtuan “nuk u kursyen” prej dënimit.

SURETUL ANKEBUT 39

Habit fakti se Karuni ka qenë prej popullit të Musasë e jo prej popullit të firaunit, por ai e tradhtoi popullin e tij dhe iu bashkëngjiti armikut, firaunit. Firauni e ka pranuar, sepse ka qenë çështja për interesin e përbashkët ekonomik “material” edhe pse kanë qenë jo të një gjaku, jo të një fisi, jo të një populli.

Prej mrekullive të Kur’anit është se bën ndërlidhje në mes të kriminelëve dhe çrregullimit në tokë, që është shkaktar i dëmtimit dhe i shkatërrimit të popujve. Thotë Zoti i Madhëruar:

“ A nuk e di se ç’bëri Zoti yt me Ad-in”.

“ Po ashtu populli irem me “pallate” të larta e shtylla të forta”

“Çka s’ke mund për t’i përngjarë askund në botë”

“Edhe populli themud, i cili i strukturonte shkrepat në lugina”

“Edhe firauni, i cili kishte tenda “vila”

“Por të “gjithë” të cilët bënë krime, mizori e shkatërime në tokë”

“Shkatërrimet “çrregullitë”e tyre ishin të tepruara.

“Për atë arsye Zoti yt i goditi me goditje të ashpër dënimi

“S’ka dyshim Zoti yt dënon në momentin e merituar”

SURETUL FEXHER 6,7,8,9,10,11,12

Kur’ani e përdor tejkalimin e kufijve me shprehjen “kryelartësi” kjo d.m.th. mendjemadhësi, dhe sundimi i krijesave të Allahut me nënçmimin dhe poshtërimin, siç është rasti me firaunin , ku thotë Zoti i Madhëruar:

“Vërtet ai “firauni” ka qenë kryelartë dhe prej atyre që i kanë tejkualuar kufijtë”.

SURETUL DUHAN 31

“Vërtet firauni u bë aq kryelartë në tokë sa që banorët e “vendit të tij” i bëri në klasa “sunduese”. Njëerën klasë të shoqërisë e uli aq poshtë sa që fëmijët meshkuj dhe burrat e tyre i likuidonte “me ekzekutim, me heqje të kokës, ndërsa fëmijët femra i lejonte që të mbijetonin. Vërtet pa kurrfarë dyshimi ai ka qenë prej atyre të cilët kanë bërë shkatërime në tokë”.

SURETUL KASAS 4

Kështu ne e shohim se “kryelartësia” dhe çrregullimi e shkatërrimi në tokë janë të pandara dhe të njëjta kategorie.

Kur’ani nuk përqendrohet në përshkrimin vetëm të kriminelëve dhe të mizorëve, por u bashkëngjiti atyre paritë dhe popujt, të cilët kanë vepruar me

urdhrat e tyre dhe i kanë përkrahur, i kanë dëgjuar. Për këtë arsye edhe ata e mbajnë të njëjtën përgjegjësi.

Zoti i Madhëruar për popullin e Nuhut thotë:

“Tha Nuhu o Zoti im- vërtet ata më kundërshtuan mua, ndërsa pasuan, ndihmuan dhe përkrahën atë, i cili pasurisë dhe fëmijës së tyre nuk u shton kurrfarë fitimi, por vetëm humbje”.

SURETUL NUH 21

Thotë Zoti i Madhëruar për Adin popull i Hudit:

“Dhe “njësoj” veproji ADN, të cilët mohuan argumentet e Zotit të tyre dhe e kundërshtuan të dërguarin e tyre dhe pasuan çdo kriminel, kryeneç dhe kokëfortë”.

SURETUL HUD 59

Thotë Zoti i Madhëruar për popullin e firaunit:

“Dhe ai e frikësoi popullin e vet dhe iu nënshtrua dhe e dëgjuan. Vërtet ata ishin popull mëkatar.

SURETUL ZUHRUF 54

Por ata pasuan urdhrat e firaunit, ndërsa urdhri i firaunit nuk të udhëzon drejt. “Firauni” pastaj do t’i prijë në ditën e kijametit popullit të vet dhe do t’i shpie në zjarr, po vend i keq është aty ku do të shpihen.

SURETUL HUD 97-98

Vërtet popujt mbajnë përgjegjësi apo një pjesë të përgjegjësisë, sepse ata kanë ushqyer, kanë prodhuar firaunë dhe kriminelë. Kjo është ajo çka kanë thënë popujt e mëhershëm, para se të vinte firauni në pushtet. Çka të ka shtyrë të hyjsh në një binar, në shërbim të firaunit? Janë përgjigjur: “Nuk di”. Kështu asnjëri nuk ka ditur të japë përgjigje.

Më së shumti që kanë përgjegjësi ndër mizorët janë organet shtetërore, të cilat Kur’ani i quan-”ushtri” që kanë për qëllim forcat e armatosura, të cilat janë dhëmbët dhe kthetrat e politikës; ata janë shkopi i cili e frikon publikun “popullin” nëse ata “shfrenohen” ose kanë ide “shfrenimi”. Për këtë Kur’ani thotë:

“Vërtet, firauni, Hamani dhe ushtritë e tyre kanë qenë mëkatarë të mëdhenj”.

SURETUL KASAS 8

“E kemi dënuar atë “firaunin” dhe ushtrinë e tij e kemi hedhur “përplasë” në det. Shiko pra si është përfundimi i mizorëve”.

SURETUL KASAS 40

Po ashtu suneti iu le përgjegjësi dhe i kërcënon udhëheqësit mizorë dhe kriminelë, të cilët shpien popujt në gabime të mëdha. Nëse e thonë ndonjë fjalë, ide a mendim, askush nuk guxon t’ua prishë atyre. Ata dridhen në zjarr sikurse dridhet flutura.

Po ashtu iu lë përgjegjësi atyre të cilët vazhdojnë rrugën e tyre, punojnë për ta, dhe janë përkrahës të tyre.

Suneti ka tërhequr vërejtjen që në popull mund të përhapet frika sa që asnjëri nuk mund t' i thotë të padrejtë- o i padrejtë.

Nga Ebi Musa transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në xhehenem është një kodër e në atë kodër është një gropë e cila quhet “hebheb” në të cilën Zoti do t’i dënojë dhe do t’i hedhë të gjithë kriminelët dhe kryefortët”.

Transmetohet nga Muaviju se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Pas meje do të ketë njerëz të cilët do të thonë çka të donë, ndërsa askush nuk ua prish atyre fjalën, ata do të digjen në zjarr sikurse digjet hekuri”.

Transmetohet nga Xhabiri se Muhamedi a.s. i ka thënë Keab bin Uxhresë-”**Të mbroftë Allahu nga udhëheqësit shkapërderdhës o Keab”.**

I tha Keabi-”Kush janë udhëheqësit shkapërderdhës”.

I tha i Dërguari a.s.: **“Janë udhëheqësit të cilët vijnë pas meje. Të cilët nuk udhëzojnë sipas udhëzimeve e mia, nuk veprojnë sipas veprave të mia. Kush u beson rrenave të tyre, dhe u ndihmon në padrejtësinë e tyre unë nuk jam prej tyre dhe ata nuk janë prej meje dhe nuk do të jenë në xhenet me mua. Kush nuk u beson rrenave të tyre dhe nuk u ndihmon në padrejtësitë e tyre Unë jam prej tyre dhe ata janë prej meje dhe ata do të jenë në xhenet me Mua”.**

Po ashtu është përfituar nga thënia e Muaviut se Muhamedi a.s. ka thënë -”**Mos respekto popullin i cili nuk gjykon me drejtësi dhe nuk ia kthen të dobët të drejtën të cilën ia ka marrë i forti me padrejtësi”.**

Po ashtu edhe Abdullah bin Umeri transmeton “Nëse e sheh popullin tim se frikohet për t’i thënë të padrejtë o i padrejtë, ka mbaruar puna e tij”.

Islami si rregull prej rregullave të jetës ka vendosur edhe sistemin konsultativ dhe parlamentar. Po ashtu qeveritarit ia ka bërë obligim që të konsultohet “me ekspertët e të gjithë lëmenjve”. Ia ka bërë obligim edhe umetit që të këshillohet sa që këshillimi e ka bërë çështje themelore të fesë e ajo rezulton nga teksti i hadithit-”Këshillimi i umetit mysliman” që d.m.th. këshillimi i prijësve të tyre dhe qeveritarëve të tyre.

Urdhrin në punë të mira “progresivitet” Islami e ka bërë farz-obligim, sa që e ka ngritur në shkallën më të lartë. Xhihadi më i vlefshëm është t’i thuhet fjala e vërtetë mbretit mizor. Kjo d.m.th. ballafaqim me çrregullinë, mizorinë e brendshme. Kjo ka prioritet dhe është më e vlefshme se të luftosh armikun e jashtëm. Sepse konflikti i brendshëm i ndihmon, shkakton të jashtëm.

Në teorinë islame qeveritari konsiderohet kujdestar i umetit dhe shërbëtor i tij edhe pse dihet se ai është njeri dhe mund të gabojë e mund t’ia qëllojë, mund të veprojë drejt e mund të devijojë. Për këtë arsye myslimanët kanë të drejtë ta drejtojnë kur të gabojë dhe ta udhëzojnë kur të devijojë.

Këtë e kanë deklaruar udhëheqësit më eminentë të myslimanëve pas vdekjes së të dërguarit Muhamedit a.s.

Halifja i parë Ebu Bekri në fjalimin e parë publik para popullit ka thënë:

“O ju njerëz. Unë jam zgjedhur të jem udhëheqës i juaj edhe pse nuk jam më i miri, por nëse më shihni se gaboj më përmirësoni, nëse e shihni se veproj drejt më informoni. Më dëgjoni në çështjet të cilat janë në pëlqimin e Allahut. Por nëse gaboj dhe nuk veproj me pëlqimin e Allahut mos më dëgjoni.

Halifja i dytë Omer ul Faruk ka thënë- *“Zoti e mëshiroftë personin i cili më ndihmon për t’i përmirësuar të metat e mia”*. Në një rast tjetër ka thënë: *“O ju njerëz kush prej jush sheh në mua ndonjë devijim le të më ndalojë për të devijuar”*.

Njëri prej publikut i thotë: *“Për Allahun o Ibn Hatab nëse ndonjëri prej nesh sheh se ti devijon do të të ndalim edhe me shpatë”*.

Në një rast tjetër derisa ai ishte në foltore “minber”e kritikon një grua ndërsa Omeri pa kurrfarë kryelartësie, por me modesti thotë: *“Gruaja me të vërtetë ka të drejtë, ndërsa unë Omeri paskam gabuar”*.

Alia r.a. Zoti e fisnikëroftë atë, deri sa një njeri polemizonte dhe i shpjegonte një çështje, e i thotë: Këtu e ke qëlluar ndërsa këtu ke gabuar, thotë: *“ Mbi çdo të ditur ka më të ditur”*.

SURETUL JUSUF 76

Islami para demokracisë i ka vendosur rregullat dhe ligjet me të cilat bazohet por disa çështje i ka lënë në kompetencën dhe angazhimin e myslimanëve. Ka vendosur parimet e fesë së tyre, rregullat për të mirën e jetës së tyre dhe që ata të zhvillohen varësisht prej vendit, kohës dhe nevojave të tyre.

Karakteristikë kryesore në demokraci është ajo se në fushën e saj ka hapësirë për t’i izoluar dhe për t’i zbritur prej postit udhëheqësit mizorë dhe të padrejtë. Demokracia ka formën dhe mënyrën më të mirë për t’i mbrojtur dhe për t’i siguruar popujt nga sundimi fashizoid dhe mizor.

Nuk prish punë nëse njerëzit, intelektualët dhe prijësit mendojnë për forma dhe metoda të tjera të qeverisjes, nëse ato mund të jenë më të përshtatshme dhe më të dobishme për derisa të plotësohen kushtet dhe të jenë rrethanat më të volitshme dhe reale. Ne e shohim se është e nevojshme dhe e domosdoshme t’i përmbahemi sistemit demokratik, i cili siguron realizimin e drejtësisë, konsultimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe t’i kundërshtojë e t’i rrëzojë qeveritarët dhe udhëheqësit kriminelë dhe mizorë.

Është rregull e sheriatit: -”Çdo çështje e cila është e domosdoshme për t’u realizuar duhet domosdo që të realizohet”. Prej pikësynimeve të sheriatit është edhe parimi: - Nëse një mjet është i vetmi për të arritur te pikësynimi, ai mjet është domosdoshmëri e atij pikësynimi.

Në sheriatin islam nuk ka kurrfarë pengese për ta marrë një teori apo veprimtari prej jomyslimanëve. Kështu Muhamedi a.s. në luftën e Uhudit për hapjen e istikameve “kanali i gjatë rreth e përqark Medinës” ka vepruar me ide dhe teori luftarake të persianëve.

Po ashtu në Bedër ka shfrytëzuar edhe diturinë e robërve të luftës, të cilët ishin idhujtarë; nga ata janë mësuar fëmijët e myslimanëve për të shkruar dhe për të lexuar.

Dituria është send i humbur i myslimanit; kudo që të jetë besimtari i pari duhet ta marrë dhe ta praktikojë.

Në disa libra të mia kam shprehur haptazi mendimin se është e drejtë jona t'i marrim prej të tjerëve idetë, metodat, sistemet të cilat janë të dobishme për ne, derisa të mos jenë në kundërshtim me ndonjë argument të qartë dhe të drejtpërsëdrejti në Islam ose me ndonjë parimi esencial islam. Ne duhet ta pranojmë, ta përsosim, ta pastrojmë me shpirtin tonë të singertë, të bëhet pjesë jona dhe të humbë e mëparshmja.

Le t'i bëjmë një vështrim p.sh. sistemit të zgjedhjeve dhe të votimit të lirë; në teorinë islame quhet “dëshmi” për kandidat i cili është i mirë. Pra kandidati i propozuar për votim duhet t'i plotësojë kushtet e dëshmitarit e prej atyre kushteve për të qenë i drejtë siç e përmend Zoti i Madhëruar:

“Le të dëshmojnë të drejtët në mesin e juaj”

SURETUL TALAK 2

“Të jenë prej atyre dëshmitarëve që ju i pranoi dhe i pëlqeni si dëshmitarë të drejtë”.

SURETUL BEKARE 282

Ndërsa kush “voton” dëshmon për jo të mirin se është i mirë, ai ka bërë mëkat të madh dhe shpifje. E këtë Zoti i Madhëruar e ka barazuar me idhujtarinë ku thotë:

“Largohuni ndyrësisë së idhujve dhe largohuni shpifjes” dëshmisë së rrejshme”

SURETUL HAXH 30

Kush “voton” dëshmon për të mirë vetëm pse është farefis i tij apo i vendit të tij ose për interes personal, ai e ka kundërshtuar urdhrin e Allahut. Pse Zoti i Madhëruar ka thënë:

“Dëshmoni bindshëm dhe vetëm drejtësi për Allahun”

SURETUL TALAK 2

Kush nuk voton kur e ka të drejtën e votimit e pastaj nuk fiton i merituari dhe i drejti, por me shumicë votash fiton ai i cili nuk e meriton d.m.th. ai i cili nuk e ka cilësinë “më i miri” “jo votuesi” e ka fshehë dëshminë. Ndërsa Zoti i Madhëruar thotë- **“Mos të refuzojnë dëshmitarët për të dëshmuar, nëse ata emërohen, iu jepet e drejta për të dëshmuar dhe ftohen për të dëshmuar.”**

SURETUL BEKARE 282

Në një ajet tjetër Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos e fshihni dëshminë, pse kush e fsheh atë ai sigurisht ka bërë gabim të madh”.

SURETUL BEKARE 283

E njëjta çështje është edhe për atë i cili ka të drejtë votimi pasi që i ka plotësuar kushtet dhe e ka cilësinë e votuesit, por për të tillin është edhe më e rëndësishme.

Ne me këto rregulla dhe metodat e sistemit zgjedhor përfundimisht kemi realizuar sistem islam, edhe pse në esencë e kemi marrë prej të tjerëve e nuk ka buruar prej nesh.

Ajo për të cilën dëshiroj të përqendroj vëmendjen është se që në start baza (thelbi) e demokracisë absolutisht pajtohet me bazën “thelbin” e Islamit. Pra e kam fjalën nëse shikojmë burimet kryesore, dhe bazohemi në burimin e pastër të Kur’anit, sunetit dhe veprimtarisë së halifëve të drejtë e jo duke u bazuar në histori të udhëheqësve jo të drejtë islamë - udhëheqësit egoistë, dhe duke mos u bazuar në fetvatë e dijetarëve, të cilat kanë qenë dorë e zgjatur e udhëheqësve dhe as të dijetarëve që kanë qenë të singertë por nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme, por vetëm njohuri sipërfaqësore.

Ndërsa deklarimi se “Demokracia d.m.th. me qeverisë populli me popull i takon vetëm Zotit” për ne është i papranueshëm.

Këto deklarime të cilat mbështeten në atë se demokracia nuk e pranon qeverisjen e ligjit të Zotit në popull, janë deklarata të shumicës së dijetarëve, të cilët nuk e kanë kuptuar demokracinë në esencë, por kanë për qëllim refuzimin e sistemit diktatorial, kanë për qëllim refuzimin e sundimtarëve të këqij dhe mizorë të cilët manipulojnë dhe u imponojnë të tjerëve për t’u zgjedhur me dhunë.

E vërtetë është se këta aludojnë në demokraci ku populli ka të drejtë të zgjedhë prijësin e vet: atë të cilin e dëshiron ai, dhe në të njëjtën kohë për të dhënë llogari për punët e tij, dhe për të mos dëgjuar urdhrat, të cilat janë në kundërshtim me kushtetutën e popullit apo me fjalë të tjera të kushtetutës islame nëse urdhërojnë për mëkate;

Që populli të ketë të drejtë për t’i shkarkuar, nëse nuk punojnë me drejtësi dhe devijojnë dhe nuk i kryejnë detyrat dhe kërkesat e tyre.

Dëshiroj të potencoj se parimi “Qeverisja e Allahut” është parim kryesor islam të cilën e kanë vërtetuar të gjithë dijetarët e Usulit në hulumtimet e tyre për “Qeverisjen” “Kushtetutën” dhe “Qeveritarin”. Dhe që të gjithë janë pajtuar se “Qeveritar absolut” është Allahu i Madhëruar, ndërsa transmetuesi i misionit të tij Muhamedi a.s. Allahu i Madhëruar është ai i cili urdhëron dhe ndalon, lejon dhe pengon, qeveris dhe ligjëson.

Thënia e “havarixhëve” se “Nuk ka ligj përpos ligjit të Allahut” është thënie e vërtetë në esencë dhe është e pakontestueshme. Por ajo për çka nuk pajtohem dhe e kontestoj është se thënia është vendosur jo në vendin e duhur, dhe nuk pajtohem me atë se e refuzojnë gjykimin e njerëzve në konfrontimet midis tyre. Kjo është në kundërshtim me tekstin Kur’anor ku është lejuar dhe është ligjësua gjykimi i njerëzve në mes tyre për raste të shumta, por më i njohuri prej këtyre rasteve është gjykimi midis bashkëshortëve, nëse ndodh pakënaqësi dhe papajtueshmëri midis tyre.

Për këtë arsye Aliu r.a. si Emire i besimtarëve e konteston thënien e “havarixhëve” duke u shprehur - Fjalë e vërtetë e tyre duke pasur për qëllim të pavërtetën. Pra ai e ka përshkruar thënien e tyre si “ fjalë e vërtetë” por i ka kritikuar apo i ka fajësuar se kanë pasur qëllim jo real dhe jo të vërtetë.

Si mos të jetë fjalë e vërtetë kur bazën e ka nga teksti i qartë i Kur’anit “ **Vërtet ligji i takon vetëm Allahut**”.

Ligji i Allahut te krijesat paraqitet në dy forma:

1. Qeverisja e ligjeve natyrore prej Allahut-që d.m.th. Allahu qeveris me ligjet natyrore, me gjithësinë. Ai ka caktuar lëvizjet e trupave qiellorë dhe natyrshmërinë e cila është ekzakte dhe nuk ndryshon për të cilat dimë e për të cilat edhe nuk dimë. Për këtë tregon fjala e Allahut:” **A nuk po e shohin ata se si ne tokën “e zgjerojmë”por edhe i ngushtojmë anët e saj “polet”. Allahu qeveris, askush nuk mund t’i përzihet në Qeverisjen e tij. Ai është llogaritar shumë i shpejtë”.**

Këtu qeverisja e Allahut ka të bëjë me gjithësinë e jo me ligjet e Sheriatit.

2. Qeverisja nga aspekti legjislativ obligativ:

Kjo ka të bëjë me qeverisjen dhe ligjësimin nga aspekti obligativ njerëzor. Si urdhëresat, ndalesat, domosdoshmëria, liria e veprimit dhe zgjedhja e veprimit. Këto çështje janë paraqitur nëpërmjet të të dërguarve, dhe nëpërmjet librave të shpallura me të cilët ka vendosur ligjet, ka paraparë obligimet, ka lejuar të lejuarat dhe ka ndaluar të ndaluarat.

Këto çështje myslimani nuk i refuzon, por pajtohet që Allahu është Krijues i tyre, Islami fe e tij, dhe Muhamedi a.s. i dërguar.

Myslimani, i cili thërret për demokraci ai ka për qëllim si formë dhe mënyrë të ligjit të bazuar në parimet e politikës islame për ta zgjedhur prijësin dhe qeverinë, për t’u konsultuar, për t’u këshilluar, për të vepruar mirë dhe drejt dhe për të ndaluar të keqen; për të mos lejuar padrejtësi dhe mizori, për të mos lejuar mëkat, posaçërisht nëse është fjala për pabesimin dhe mosdëgjimin e Allahut.

Këtë e vërtetojmë me atë se kushtetuta e shpreh vendosmërisht se praktikimi i demokracisë bazohet në atë se feja shtetërore është Islami dhe se sheriatu islam është bazë e nxjerrjes së ligjeve, kjo e përforcon e realizon dhe e jetëson qeverisjen e Allahut që d.m.th. për të praktikuar sheriatin dhe se ai e ka fjalën kryesore.

Mund të vendosim nenin në kushtetutë, i cili haptazi e thekson se-”Çdo ligj apo sistem i cili kundërshton ligjet e sheriatit është i pavlefshëm”. Ky nen nuk konsiderohet ligj i vendosur prej njeriut por nen i cili e përforcon ligjin e Allahut.

Për këtë arsye nuk mund të themi se demokracia si sistem qeverisjeje e popullit është zëvendësim i qeverisjes së Allahut, sepse midis tyre nuk ka asgjë kontradiktore.

Nëse kjo çka arsyetohet se qeverisja e popullit është zëvendësim i qeverisjes së Allahut është prej domosdoshmërisë së demokracisë, fjala më e drejtë te dijetarët islamë është se në Islam demokracia nuk është domosdoshmëri e zëvendësimit të qeverisjes së Allahut me qeverisjen e popullit. Për këtë arsye nuk lejohet për t’i konsideruar pabesimtarë apo fasika “gabimtarë të mëdhenj” ata të cilët e konsiderojnë të domosdoshëm drejtimin e tyre, pse ndoshta edhe nuk e venë në praktikë atë domosdoshmëri e ndoshta edhe nuk e mendojnë fare për ta vendosur në praktikë qeverisjen e Allahut në qeverisjen e popullit.

Prej argumenteve të kësaj pjese të dijetarëve islamë është se demokracia është parim i importuar prej jomyslimanëve dhe nuk ka lidhje me Islamin; ajo bazohet në qeverisje kush e fiton shumicën e votave ka të drejtë për t' u emëruar qeveritar për shkak të lehtësimit të çështjeve dhe për t'i dhënë përparësi shumicës së votave për çështje për të cilat nuk pajtohen. Votimi në demokraci është qeveria që ka prioritet për shkak të shumicës së votave. Dhe çdo mendim apo ide e cila fiton për shkak të shumicës absolute apo vetëm për shkak të shumicës kalon dhe bëhet e plotfuqishme e ai mendim apo ajo ide mund të jetë e gabuar dhe e padrejtë.

Kjo për arsye se Islami nuk e pranon këtë metodë apo këtë mjet dhe nuk e pranon mendimin e tjetrit për atë se pajtohen por shikon në vetë çështjen a është e drejtë apo gabim. Nëse është e drejtë fuqizohet edhe nëse e fiton vetëm një votë apo edhe pa e fituar asnjë votë. Nëse është gabim refuzohet edhe nëse për atë votojnë 99 përqind prej 100 përqind të votuesve.

Përpos kësaj ajetet e Kur'anit tregojnë se shumica janë gabim dhe në krahun e kriminelëve dhe të shejtanit.

Si p.sh. **“Dhe nëse i dëgjon shumicën e atyre që janë në tokë do të të humbin nga rruga e Allahut”.**

SURETUL ENAM 116

“Dhe shumica e njerëzve “ nuk besojnë “ edhe pse ti dëshiron të jesh besimtar”.

SURETUL JUSUF 103

“Dhe shumica e njerëzve nuk dinë “.

SURETUL EARAF 187

“Por shumica e tyre nuk logjikojnë”.

SURETUL ANKEBUT 63

“Dhe shumica e njerëzve nuk besojnë”.

SURETUL HUD 17

“Mirëpo shumica e njerëzve nuk falënderojnë”.

SURETUL BEKARE 243

Sikurse tregon “Kur’ani” të mirët dhe të drejtë janë të paktë. Si p.sh. -**“Dhe një pakicë prej robërve të mi falënderojnë pa reshtur”.**

SURETUL SEBEE 13

“Përpos atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe një pakicë çka janë prej tyre”

SURETUL SAD 64

Kjo për të cilën thotë dikush apo argumenton, ai gabon dhe nuk e ka kuptuar esencën dhe mund t' i përgjigjemi.

Ne supozojmë kur kemi të bëjmë për demokracinë në shoqërinë islame ku shumica dinë, logjikojnë, besojnë dhe falënderojnë dhe nuk jemi duke biseduar për shoqërinë e cila e mohon Zotin apo e cila ka devijuar dhe ka humbur nga rruga e Allahut.

Pastaj, ka çështje të cilat nuk hyjnë në sistemin e votimit dhe për të cilat nuk votohet pse ato çështje janë thelbësore dhe nuk ndryshohen nëse ndryshon shoqëria dhe kjo nëse ndryshohet është e papranueshme.

Nuk ka hapësirë për të votuar për çështjet e prera në sheriatin islam, në bazat themelore të fesë, dhe në çështjet të cilat janë të domosdoshme. Por sistemi i votimit vjen në konsiderim në çështjet e zgjedhjes së problematikave “ixhtihadit” të cilat kanë shumë mënyra të zgjidhjes së problemit, dhe është normale që të ndryshojnë idetë dhe mendimet si p.sh. zgjedhja e një kandidati për një post edhe nëse është fjala për postin e kryetarit të shtetit. Apo siç është shembulli i nxjerrjes së rregulloreve dhe ligjeve për përcaktimin e qarkullimit të njerëzve dhe automjeteve, apo organizimi dhe ndërtimi i qendrave tregtare, qendrave prodhuese apo qendrave spitalore etj.etj. të cilat bëjnë pjesë në të ashtuquajturën “interes i përgjithshëm shoqëror, siç është vendimi për mobilizim për luftë ose për paqë apo vendosja e tatimeve, vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme, afatizimi i kohës së kryetarit të shtetit, rizgjedhja e kryetarit të shtetit apo jo dhe për sa afate etj.etj.

Nëse për këto çështje paraqiten mendime të ndryshme ose të kundërta, për t’i lënë të pazgjidhura apo për t’i zgjidhur [për të caktuar, për të vendosur] pa zgjedhje të prioritetit, apo me zgjedhje të prioritetit.

Intelekti i logjikës dhe i ligjit [shariatit] në të vërtetë thotë se patjetër duhet me zgjedhje prioritare, ndërsa me prioritet në rastet e kundërshtimeve edhe mendimi i shumicës. Nuk ka dyshim se mendimi i dyve është më i afërt, më i saktë se i njërit.

Në hadith Muhamedi a.s. thotë – **“Shejtani është me [mendimin] njërin ndërsa kur të bëhen dy bashkë, ai largohet dhe është më larg”.**

Është e vërtetë se Muhamedi a.s. i ka thënë Ebu Bekrit dhe Omerit - **“Nëse ju dy bashkoheni në një ide të përbashkët nuk do të ju kisha kundërshtuar”.** E kjo d.m.th. se dy vota kanë përparësi ndaj një vote edhe nëse është fjala për votën e Muhamedit a.s., por jo në fushën legislative të shariatit dhe ajo çka i zbritet prej Allahut të Madhëruar.

Ne e dimë se Muhamedi a.s. në betejën e Uhudit e ka pëlqyer dhe e ka pranuar mendimin e shumicës për t’u pozicionuar në periferi të Medines, ndërsa mendimi i tij dhe i sahabëve më eminentë ka qenë të qëndrojnë dhe të pozicionohen në brendi të Medines nëpër rrugët dhe rrugicat e Medines.

Më i qartë se ky është rasti i Omerit me gjashtë sahabet të cilët ishin si deputetë të parlamentit kur i kandidoi dhe i propozoi dhe u tha që në shumicë votash ta zgjedhin njërin prej tyre, ndërsa të tjerët pastaj për t’u pajtuar dhe për ta dëgjuar. Por nëse votat mbesin tre me tre le ta kandidojnë një jashtë tyre e ai të jetë Abdullah bin Umeri po nëse ai nuk pranohet atëherë në treshin prej tyre le të jetë Abdurrahman bin Aufi.

Është vërtetuar në hadithin “Udhëheqësit eminentë [më të mëdhenj] se ata duhet për t’i dëgjuar dhe për t’i respektuar. Ndërsa me udhëheqës eminentë në hadith nënkuptojmë pjesën më të madhe të popullit dhe prej pjesës më të madhe të popullit më të dalluarit.[ky hadith është transmetuar nga shumë rrugë e disa prej tyre të forta].

Këtë e bën më të fuqishme të bazuarit e dijetarëve me mendimin e shumicës në çështjet kontradiktore duke e konsideruar si më prioritar nëse ka mendim apo argument më të fortë, që e zbret nga prioriteti.

Imami Ebu Hamid Gazali në disa libra të tij e ka shprehur mendimin se duhet dhënë prioritet shumicës nëse për një mendim janë argumentet dhe kundër argumentet e barabarta.

Ndërsa sa i përket mendimit se një çështje mund të jetë e vërtetë dhe e saktë nëse për atë çështje vetëm njeri e pranon ndërsa të tjerët e refuzojnë. Apo në të kundërtën një çështje mund të jetë gabim nëse atë e pranojnë 99 përqind. Kjo ka të bëjë me çështjet të cilat i ka caktuar Zoti me argument të qartë ku nuk ka për çka të diskutohet, dhe të bisedohet. Për këto çështje thuhet “Shumicë konsiderohet ajo çka është e drejtë dhe nëse je vetëm”.

Ndërsa sa i përket çështjeve të “Ixhtihadit” ku nuk ka tekst të qartë apo ka tekst por ka mënyra të shumta të interpretimit dhe të komentimit ose përballë një argumenti qëndron një argument më i fortë se ai, nuk prish punë mbështetja në atë çka është më prioritare; votimi është mjet i cili i tejkalon pengesat e konfrontimeve pse kështu e njeh populli.

Për ta pëlqyer të mençurit e prej tyre janë myslimanët ndërsa me sheriat për këtë nuk ka kurrfarë pengese, ndërsa në më lart i sollëm argumentet të cilat e vërtetojnë atë.

Fatkeqësia e parë e cila ka ndodhur në umetin islam gjatë historisë është tejkalimi apo mos praktikimi i sistemit konsultativ dhe parlamentar dhe kalimi prej udhëheqjes së drejtë [Hilafete Rashide] në sundimtarë autokratikë [totalitarë] që disa sehabë e kanë quajtur mbretëror që d.m.th. sistemi imperial. Ky sistem ka kaluar te myslimanët nëpërmjet memalikëve dhe pastaj e kanë përcjellë brez pas brezi. Ka qenë dashur që prej tyre të mos merrej ai sistem, por të largohej prej mëkateve, të këqijave, sepse ato kanë qenë shkak i asgjësimit të shtetit të tyre.

Ajo çka e ka dëmtuar më së shumti Islamin, umetin islam, dhe thirrjen islame në kohën bashkëkohore është sistemi autokratik dhe mbretëror duke i nënshtruar njerëzit me ekzekutim, duke i nënçmuar dhe duke i likuiduar. Dhe vetëm nën hijen dhe qeverisjen autokratike është paralizuar ligji i sheriatit, është vendosur sekularizmi dhe janë dëbuar njerëzit me dhunë prej vendeve të tyre e janë internuar. Janë dënuar njerëzit në format më mizore duke ua hequr kokat dhe duke i djegur në zjarr. Është sulmuar thirrja islame dhe aktiviteti islam, janë maltretuar thirrësit islamë, janë ndjekur penalisht dhe i kanë dëbuar nga çdo vend. Ndërsa në disa raste nën vallon e demokracisë false, fshehtëzi e sulmojnë Islamin e ndonjëherë çdo forcë islame progresive e sulmojnë edhe haptazi.

Dhe kështu Islami nuk ka mundur të zotëronte, nuk ka mundur të realizohej thirrja e tij dhe nuk ka mundur që të zhvillohet e të ngrihet në vendin e merituar, por vetëm i është lejuar një fushëveprim i kufizuar ku edhe atë fushëveprim të kufizuar e kanë shfrytëzuar për t’iu përgjigjur njerëzve në natyrshmërinë e tyre, për t’u dëgjuar zëri i tij tek ata të cilët janë të etshëm për të dhe për t’i kënaqur mendjet të cilat kanë nevojë për të.

Arena dhe beteja e parë e thirrjes islame, prosperitetit islam dhe aktivitetit islam në kohën bashkëkohore është arena dhe beteja e lirisë njerëzore. Duhet që të gjithë dashamirët e islamit të rreshtohen së bashku në demokraci, ta mbrojnë, sepse nuk ka metodë dhe formë më të volitshme se ajo.

Dëshiroj të theksoj se unë nuk jam i flaktë t'i përdor fjalët e huaja si "demokraci" apo ndonjë shprehje tjetër në vend të asaj islame. Mirëpo nëse një term bëhet "hit" i kohës dhe njerëzit e donë dhe e praktikojnë atë, ne nuk duhet të bëhemi të shurdhër, dhe t'i mbyllim veshët, por duhet që ta kuptojmë në esencë çka d.m.th. ai term kur të përdoret, e jo për ta kuptuar ndryshe nga ajo çka thotë folësi. Në këtë rast ne duhet të gjykojmë drejt dhe me maturi. Nuk prish punë nëse ajo fjalë nuk e ka burimin prej nesh, sepse gjykimi nuk bëhet në emra dhe adresa por në personat e emrave dhe kryerësit e veprave.

Shumë shkrimtarë dhe thirrës islamë e kanë përdorur atë. Ka shkruar Abas Akadi [Zoti e mëshiroftë] librin me titull "Demokracia Islame", ndërsa profesori Halid Muhamed Halid demokraci e quan vetë Islamin si tërësi.

Kësaj çështjeje i kam bërë koment në librin tim "Zhvillimi islam dhe brengat e vendeve arabe dhe islame". Kush dëshiron të informohet më gjerësisht le ta lexojë atë.

Shumë prej dijetarëve islamë e dëshirojnë dhe e kërkojnë demokracinë si sistem të qeverisjes, garant të lirisë njerëzore dhe siguri prej shfrenimit të qeveritarit me kusht që të jetë demokraci e vërtetë, e cila shpreh dëshirën e umetit e jo dëshirën e autokratit dhe një pjese të shoqërisë, të cilët e shikojnë vetëm interesin individual. Nuk mjafton të ngrihet simboli demokratik, derisa shpirti i tij fundoset.

Jo demokraci të mbushen burgjet plot e përplot pa kurrfarë faji. Jo demokraci me shkop mbi kokë. Jo demokraci e cila u sjell fatkeqësi atyre të cilët e shprehin mendimin e lirë, duke e pyetur qeveritarin pse,- e ai vetëm të përgjigjet: jo dhe pikë. Unë jam prej atyre të cilët e kërkojnë demokracinë si mjet lehtësues dhe më të përshtatshëm për t'i realizuar qëllimet tona në jetën tonë fisnike që të kemi mundësi për të thirrur në rrugën e Allahut dhe në Islam, siç dëshirojmë dhe besojmë, pa na futur në errësirat e burgjeve apo pa na i vendosur prangat në fytyrë.

Ka mbetur edhe një çështje që duhet përkujtuar se disa dijetarë thonë edhe sot se konsultimi [Parlamenti] është vetëm si mësim ndërsa nuk është domosdoshmëri, dhe se qeveritari ka të drejtë të konsultohet, ndërsa nuk e ka obligative për të vepruar sipas mendimit të parlamentit [të deputetëve në parlament].

Jam përgjigjur për këtë dhe herëve të tjera se parlamenti është pa domethënie dhe i pakuptimtë, nëse qeveritari konsultohet me deputetët në parlament e pastaj thotë unë veproj si dua vetë, sepse atëherë deputetët nuk kanë kurrfarë vlere në parlament dhe nuk mund të quhen të deleguar kur mendimi i tyre nuk vjen në shprehje dhe nuk pranohet, pra nëse nuk vihet në praktikë.

Ibni Kethiri në tefsirin e tij e përshkruan transmetimin nga Ibn Merdevij e ai nga Alia r.a. se është pyetur për "mendimin" në ajetin Kur'anor:

"Dhe konsultoj me ta për çështjet, dhe kur të "vendosësh" menjëherë mbështetu Allahut". SURETUL ALI IMRAN 159

Është përgjigjur: “Për t’u konsultuar me intelektualët pastaj, për t’i pasuar dhe për të vepruar siç mendojmë ‘’.

Për këtë çështje [demokracinë] i kemi dy mendime

Lirisht mund të them se çka e ka dëmtuar dhe e ka pasivizuar e edhe sot vazhdimisht është duke e dëmtuar është sistemi jodemokratik dhe autokrat e kjo na bën që ta përkrahim mendimin, që të shndërrohet dhe të bëhet e domosdoshme demokracia. Çfarëdo kundërshtimi që të ekzistojë, nëse umeti ose shumica e umetit e parashih që domosdo të praktikohet sistemi parlamentar, atëherë të tjerët nuk kanë çka të kundërshtojnë, por bëhet obligative për atë çka janë pajtuar vaxhib me ligjin e shariatit islam. Pse myslimanët duhet t’i përmbahen kushteve kur t’i parashohin. Kur kryetari apo udhëheqësi zgjidhet në baza [parlamentare] dhe në këto kushte nuk lejohet tjerët pastaj që të mos pranohet ai vendim, sepse dihet se myslimanët kur t’i parashohin kushtet dhe t’i aprovojnë vendimet, pastaj farz i kanë për t’iu përmbajtur.

Kur Aliut r.a. i kanë kërkuar për të punuar me Kur’an dhe sunet dhe me mendimin dhe veprimtarinë e Ebu Bekrit dhe Omerit, ai dy të parat i pranoi, ndërsa për t’iu përmbajtur veprimtarisë së Ebu Bekrit dhe Omerit refuzoi, sepse po të kishte pranuar edhe për këta dy të fundit e kishte pasur obligim për t’i përkrahur.

Kështu konsultimi islam përputhet me shpirtin e demokracisë apo me fjalë të tjera mund të thuhet se esenca e demokracisë përputhet me shpirtin konsultativ islam.

SISTEMI SHUMËPARTIAK NË SHTETIN ISLAM

Pyetje ;

Nëpër asamble dhe nëpër vendtubime ndërmjet myslimanëve dhe ndërmjet tyre e të tjerëve zhvillohen dialogje dhe polemika të shumta. Në mes të myslimanëve është bërë e njohur që Islami patjetër duhet të mbetet unik dhe nuk lejon ndarje dhe konfrontime, ndërsa sistemi shumëpartiak nuk sjell asgjë tjetër përpos kundërshtimit të mendimit dhe të fjalimit dhe ndarjen e umetit [popullit].

Dëshmorë Imam Hasan Benna ka deklaruar se në Islam nuk ka parti për këtë arsye shumica e ka përkrahur mendimin e tij dhe e ka refuzuar idenë e pluralizmit; ata i kanë edhe argumentet dhe e vënë në dyshim idenë e pluralizmit.

Çfarë mendimi keni ju për këtë çështje, e cila i ka përfshirë sot shumë vende araba dhe islame, posaçërisht në ato vise ku sistemi shumëpartiak u jep shans dhe hapësirë për mendimin e lirë demokratik dhe fetva për demokracinë?

Ata deklarojnë: forca e Islamit e kërkon lirinë, demokracinë dhe pluralizmin, sepse vetëm në atë mënyrë mund të vendoset në pushtet.

Kjo forcë [mendim i dijetarëve] është deklaruar për demokraci, ndërsa i ka konsideruar të pabaza mendimet e të tjerëve. E konsideron vetëm se ka të drejtë dhe se assesi nuk ka gabuar, ndërsa të tjerët e konsiderojnë gabim dhe kurrësi nuk kanë të drejtë.

Na kanë sjellë edhe argumente të sheriatit për këtë çështje dhe na kanë shpjeguar. Zoti i shpërbleftë me të mira dhe i ndihmoftë.

Përgjigje:

Mendimin tim të cilin e kam shprehur me vite të tëra nëpër ligjërata dhe nëpër takime posaçërisht ka qenë: se nuk ka pengesë në sheriatin islam që të ketë më shumë se një parti politike në shtetin islam. Sepse pengesë në sheriatin islam duhet të ekzistojë teksti, ndërsa ne nuk kemi tekst në sheriatin islam, i cili e ndalon.

Përkundrazi pluralizmi mundet të jetë domosdoshmëri në këtë kohë, sepse siguron për të mos pasur sistem autokratik ose monist në pushtet. Ndërsa robërimi i të gjithë njerëzve dhe qeverisja në shpinë të të tjerëve dhe eliminimi i të gjitha forcave [politike] mund të thotë vetëm jo dhe pike, siç na ka mësuar historia në të kaluarën dhe realiteti në të sotmen.

Për të ekzistuar këto parti në sheriatin islam nevojiten të plotësohen dy kushte themelore:

1.- Për ta njohur Islamin si besim dhe ligj të sheriatit, për të mos e sulmuar e urrejtur dhe që ixhtihadi të jetë në të kuptuarit e tij dhe në dritën e principeve themelore.

2.- Që veprimtaria të mos jetë në kundërshtim ose sulmim ndaj Islamit dhe umetit, cilado parti të jetë apo në çfarëdo vendi që të jetë.

Nuk lejohet të formohet parti e cila thërret në pabesim ose thërret për t'i kritikuar apo për t'i sulmuar fetë qiellore në përgjithësi dhe Islamin në veçanti apo për t'i nënçmuar çështjet shenjtërore në Islam si në aspektin e besimit apo të sheriatit ose Kur'anin, ose Muhamedin a.s.

Për këtë arsye edhe është e drejtë e njerëzve por edhe obligim për ta këshilluar prijësin, udhëheqësin dhe për ta drejtuar kur të devijojë, për ta urdhëruar në punë të mira dhe për ta larguar nga punët e këqija, sepse edhe ai është një prej myslimanëve, nuk është i largët [i shenjtë] i cili nuk mund të këshillohet apo të urdhërohet dhe ata njerëz nuk janë më të ulët [por të barabartë] për të mos e këshilluar apo për të mos e urdhëruar .

Nëse umeti e humb të drejtën për të urdhëruar në punë të mira dhe për ta larguar nga punët të këqija, e ka humbur specifikën e vet dhe origjinalitetin e vet; në anën tjetër e fiton mallkimin prej Zotit, siç e kanë fituar popujt e mëhershëm. Kur'ani e përshkruan kështu “ **Kanë qenë prej atyre të cilët nuk kanë ndaluar nga e keqja kur është vepruar, mjerë për ata sa keq që kanë vepruar**”.

SURETUL MAIDE 79

Muhamedi a.s. në hadith thotë: “**Nëse e sheh umetin tim duke i thënë të padrejt: o i drejtë. Ka mbaruar puna e tyre**”.

Kur Ebu Bekri e ka marrë postin e hilafetit, në ligjëratën e parë të cilën e ka mbajtur para masës ka thënë:

“O ju njerëz nëse punoj mirë më tregoni dhe më informoni, por edhe nëse veproj keq më drejtoni. Më dëgjoni kur unë e dëgjoj Allahun dhe veproj me ligjet e Tij. Por nëse i kundërshtoj ligjet e Allahut mos më dëgjoni”.

Gjersa Omeri mbante fjalim para njerëzve dhe thoshte: “O ju njerëz kush prej jush sheh ndonjë devijim tek unë, le të më drejtojë”.

Një njeri i tha; “Për Zotin, nëse shohim diçka që devijon do të të drejtojmë nëse është nevoja edhe të shpatës”.

Omeri iu përgjigj. “E falënderoj Allahun që prej mjedisit të myslimanëve ka bërë që ta drejtojnë të shtrembën e Omerit edhe me të shpatës”.

Na ka mësuar historia, përvoja e popujve dhe e sotmja[realiteti] e myslimanëve se për ta drejtuar udhëheqësin kur devijon nuk është punë e lehtë, dhe jo me këshilla të lehta dhe të buta dhe njerëzit nuk kanë në dorë “shpatat” për t’i drejtuar të shtrembrat dhe devijimet, sepse të gjitha “shpatat” i ka në dorë dhe i posedon udhëheqësi.

Prandaj është obligim organizimi i mënyrave të tjera që devijimet e qeveritarëve për t’i përmirësuar dhe për t’i drejtuar me sisteme të tjera e jo me të shpatës.

Njeriu ka arritur në kohën bashkëkohore, pas konfrontimeve të shumta, forma të urdhërimit në punë të mira dhe largimit nga punët e këqija, si dhe drejtimin e devijimit të udhëheqësit pa gjakderdhje; dhe kjo formë është “forca politike” të cilën udhëheqësi nuk mund ta eliminojë me lehtësi, dhe kjo formë është siç quhet “sistemi shumëpartiak” [opozita] apo pluralizmi.

Vërtet pushteti mundet që me mashtrime dhe me dhunë të triumfojë dhe të dominojë të ndonjë individ apo të një numër i kufizuar personash, por është e pamundur nënshtrimi i shoqërive [partive] të mëdha të organizuara, sepse ato i kanë mjetet për të qenë afër popullit: i kanë foltoret, shtypin, dhe mjetet e tjera të informimit për të ndikuar në popull.

Nëse themi se farz është për të urdhëruar në punë të mira dhe për të ndaluar nga të këqijat, domethënia e saj, fuqia e saj dhe ndikimi i saj nuk mjaftojnë për të qenë farz i individit, i cili ka ndikim të kufizuar në kohën e sotme. Pa tjetër duhet të zhvillohet forma e saj ashtu që ai të jetë në gjendje dhe të ketë fuqi për të urdhëruar në punë të mirë dhe për të ndaluar nga puna e keqe: të tërheq vëmendjen, të kritikojë dhe nëse pushteti i pozitës gabon dhe bën mëkat, të thotë: jo, nuk dëgjojmë dhe nuk veprojmë siç urdhëron dhe si opozitë, si forcë politike ta rrëzojë pushtetin pa dhunë dhe pa gjakderdhje.

Formimi i partive politike është bërë mjet i domosdoshëm për t’iu kundërvënë padrejtësisë së pushtetit në pozitë dhe për të kërkuar llogari prej tij, me qëllim të kthimit në rrugë të drejtë, ose për ta larguar partinë e pozitës nga pushteti e në vend të saj ta marrë pushtetin partia tjetër opozitare në të cilën mund të llogarisim dhe e cila kryen obligimin[vaxhibin] që të urdhërojë në punë të mira dhe largimin nga veprat e këqija, ngase çdo mjet me të cilin nuk mund të realizohet obligimi [vaxhibi] ai mjet është obligim[vaxhib].

Disa të sinqertë ndoshta mendojnë për shtetin në të cilin veprohet me ligjin e Allahut dhe çdo gjë kthehet tek ai ligj dhe nuk ka nevojë për asgjë, sepse ai shtet i përmbahet Islamit dhe nuk kalon kufijtë e ligjit të Allahut.

Duhet, pra, për t'u angazhuar dhe për të vepruar deri sa të vendoset ai shtet i shumëdëshiruar dhe kur të vendoset ai shtet të cilin e ka përshkruar Allahu:

“ Ata të cilët kur t'i vendosim në tokë falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për vepra të mira dhe ndalojnë nga veprat e këqija ”.

SURETUL HAXU 41

Atëherë duhet t'i nënshtrohemi atij shteti me nënshttrim të sinqertë dhe plotësisht, dhe duhet t'i japim përkrahje të plotë, ndihmë të plotë dhe posedim të plotë.

Dëshiroj t'u them atyre se “Shteti islam” nuk është “shtet fetar”, por është shtet qytetar ku veprohet me ligj të sheriatit.

Kryetari i saj nuk është “Imam – kryetar i mbrojtur prej gabimeve dhe deputetët e atij shteti nuk janë “murgj të shenjtë”, por ata janë njerëz që ia qëllojnë, por edhe gabojnë, veprojnë mire, por mund të veprojnë edhe keq, prandaj njerëzit duhet t'i përkrahin kur veprojnë mirë dhe t'u kundërvihen kur veprojnë keq; dhe t'i refuzojnë kur urdhërojnë për mëkate, sikurse ka thënë Ebu Bekri Sidiki në fjalimin e parë para masës apo për të thënë, siç ka thënë Muhamedi a.s.;

Të dëgjojnë dhe të veprojnë është obligim i çdo myslimani, pa marrë parasysh i pëlqen apo jo, derisa nuk të urdhërohet për në mëkate; ndërsa kur të urdhërohet për mëkate, nuk ka nevojë as të dëgjohet as të veprohet siç urdhërohet”.

Pasi që është e vërtetë se të gjithë njerëzit nuk janë të shenjtë, dhe nuk janë të mbrojtur prej gabimeve, nuk ka garancion se ata nuk mund t'i mashtrojnë dynjaja apo t'i mashtrojnë diçka tjetër ndaj Allahut. Mund të jetë egoist dhe autokratik dhe të bëjë padrejtësi, ndërsa autokracia më e rrezikshme është ajo që thirret në emër të fesë nëse nuk vendosen parimet dhe rregullat për gjetjen e rrugëve që të mos ndodhë fatkeqësia dhe e padëshiruara, por edhe nëse ndodh, si të tejkalohet dëmi i cili e ka kapluar umetin dhe i ka rënë e keqja fesë gjithashtu.

Për këtë arsye nevojitet të gjendet forcë e organizuar për të sjellë dritën e ditës dhe të ketë mundësi për ta kandiduar të mirin dhe të mos kandidohet i keqi; kjo çështje është çështje të cilën e favorizon dhe e përkrah sheriat, pse pas kësaj vijnë të mirat, dobët dhe rregull, ndërsa largohet apo pengohet e keqja dhe çrregullia.

Gabimi me i madhi është të mendohet se e drejta gjithmonë është e shtetit dhe realiteti gjithmonë është në anën e tij dhe se kush e kundërshton është gabim por edhe më keq.

Ne e kemi parë se si muëtezilët kur janë pavarësuar si pushtet ne vete dhe janë ndarë nga pushteti qendror në kohën e halifes Meemun bin Erreshide, po ashtu është në kohën e sundimit të Vaxhikut Muetesimit e të tjerëve kanë dëshiruar për t'ua imponuar vetëm mendimin e tyre të tjerëve, ndërsa të gjitha mendimet e të tjerëve i kanë konsideruar të pavlefshme nga fusha e ideve.

Me shkop e me shpatë mendimet e të tjerëve i kanë kundërshtuar, ndërsa mendimi i tyre nuk është dëgjuar, siç është rasti me pyetjen “është krijuar Kur’ani” dhe pësimi rreth mendimeve për të.

Ka qenë veprimi i egër dhe i rreptë dhe metoda të dhunshme kanë përdorur, kanë pësuar dhe njerëz të mëdhenj, dhe imamët më eminentë në krye me imamin Ahmed bin Hanbelin.

Historia ka regjistruar për intelektualët dhe për mendimtarët me të drejtë lirie të ideve se si kanë pësuar, se çka kanë përjetuar duke u nisur nga dëbimi se kanë pasur ide të kundërta nga pushteti, e deri te rrahja, mundimi, dhe burgimi edhe nëse ka qenë fjala për dijetarët më eminentë.

SISTEMI SHUMËPARTIAK SI SISTEMI I MEDHHEBEVE

Nëse e lejojmë pluralizmin brenda shtetit islam kjo nuk do të thotë se lejojmë formimin e partive, apo grupimeve në bazë të personave të caktuar, në bazë të apetiteve personale apo të interesave personale p.sh. të thuhet kjo parti e filanit, kjo e alanit e ajo parti bejan bin bejanit, të cilët i kanë tubuar [grumbulluar] njerëzit rreth vetvetes dhe rreth interesave të tyre.

Njësoj pluralizmi i formuar në baza të vendit, në baza klasore ose në baza të tjera ekstremiste prej të cilave Islami është i pastër.

Ndërsa pluralizmi i lejuar dhe ligjor është pluralizmi i mendimeve, plan-programeve dhe politikave të cilat i paraqesin secila parti të mbështetura në baza dhe argumente, e pastaj i ndihmon kush ka besim në atë parti dhe nuk sheh përmirësim të gjendjes vetëm nëpërmjet të saj.

Sistemi shumëpartiak në fushën e politikës i ngjason medhhebeve në fushën e fikhut.

Vërtet medhhebi në fikh është shkollë ideore, e cila i ka parimet e veçanta në të kuptuarit e sheriatit, dhe nxjerrjen e ligjeve të elaboruara në dritë, ndërsa pasuesit e medhhebit janë nxënës në atë shkollë të cilët besojnë se janë me afër së vërtetës se të tjerët, dhe në rrugën më të drejtë. Ata i përngjajnë partisë ideore me të cilën janë pajtuar anëtarët e saj me ato parime, dhe anëtarët e saj i ndihmojnë se janë të bindur se ato mendime dhe plan-programe janë më të mirat dhe më të përshtatshmet dhe më të favorizuarat, edhe pse kjo nuk do të thotë se plan-programet e tjera janë të pavlefshme.

Pra njësoj, partia është medhheb në politikë e cila ka filozofinë e saj, parimet e saja, plan-programin e saj të bazuar në themele të Islamit, anëtarët e saj i përngjajnë pasuesit medhhebi; në fikh secili e përkrah çka e sheh se ka përparësi dhe është më e përshtatshme dhe e favorizon atë.

Një pjesë e njerëzve e parashohin se konsultimi dhe sistemi parlamentar është i domosdoshëm. Halifja apo kryetari i shtetit duhet të zgjidhet me zgjedhje presidenciale. Posti i kryetarit duhet të jetë i afatizuar, e pastaj të rizgjidhet, ndërsa deputetët janë ata të cilët janë zgjedhur dhe kanë përkrahjen e popullit.

Femra ka të drejtë në zgjedhje dhe ka të drejtë të kandidohet për Kuvend. Shteti ka të drejtë në ngrirjen e çmimeve të mallrave ose qirazimin e tokës, inventarit, rrogat e punëtorëve, profitin e tregtarëve. Toka duhet të shfrytëzohet dhe të përfitojë kush e punon e jo në formë qiraje; në pasuri ka obligime të tjera përpos zekatit. Esenciale në politikën e jashtme duhet të jetë paqja, ndërsa jomyslimanët në shtetin islam nuk duhet të paguajnë xhizjen nëse e kryejnë shërbimin ushtarak, kjo [xhizja] i ngjason zekatit e cila merret prej myslimanit etj.

Një pjesë tjetër e ndiejnë veten “ruajtës të origjinalitetit”: i kundërshtojnë “reformistët” apo kërkesat për reforma. Sipas tyre dhe e parashohin se sistemi parlamentar është fakultativ jo obligativ; kryetarin e shtetit e zgjedhin deputetët [ehlul hal vel akd] por ai kandidohet dhe zgjidhet për tërë jetën; sistemi zgjedhor nuk është mjet i ligjit islamik apo sheriatit. Femra nuk ka të drejtë për t’u kandiduar [për kryetare] dhe as të zgjidhet. Ekonomia e tregut duhet të ketë liri absolute, pronësia e individit të jetë absolute dhe e pakufishme, esenciale në politikën e jashtme është lufta. Halifja apo kryetari i shtetit ka të drejtë për të urdhëruar për mobilizimin për luftë apo për marrëveshje për paqe e shumë e shumë ide dhe mendime të tjera të cilat kanë të bëjnë me jetën shoqërore, ekonomike, politike, ushtarake, kulturore etj.etj.

Të tjerët nuk janë as me këta, as me ata, por në disa çështje pajtohen me këta në disa të tjera pajtohen me ata.

Nëse njëri prej këtyre tri grupeve fiton apo triumfon edhe pushteti qendror bie në dorën e tyre a duhet të asgjësohen grupet e tjera dhe mos të ekzistojnë d.m.th. për t’i mbuluar në tokë vetëm e vetëm se e kanë pushtetin?

A do të thotë se zotërimi i pushtetit i jep të drejtë atyre që mendimet e tyre të jenë të përgjithmonshme, ndërsa mendimet e atyre që nuk kanë fituar të gjykohen në humbje të përgjithmonshme?

Logjika e shëndoshë thotë jo. Çdo mendim e konsideron veten se ka përkrahës, ka ndihmëtarë të cilët edhe më tutje e mbështesin dhe e mbrojnë.

Atë çka nuk e dëshirojnë në fushën politike është ajo çka nuk e dëshirojnë në fushën e fikhut, pasimi verbërisht dhe fanatizmi i verbër dhe paraqitja e disave se janë liderë, janë si pejgamberë, janë të shenjtë.

PLURALIZMI DHE KUNDËRSHTIMET

Prej dyshimeve të cilat kanë lënë mbresa është edhe parimi pluralist apo pluralizmi është në kundërshtim me atë çka unitetin e ka bërë farz Islami, dhe e konsideron garancion të imanit, ndërsa kundërshtimet dhe ndarjet i konsideron vëllezër të injorancës dhe të pabesimit.

Thotë Zoti i Madhëruar; **“Përmbajuni litarit të Allahut të gjithë së bashku dhe mos u ndani”**.

SURETUL ALI IMRAN 103

Thotë Zoti i Madhëruar:

“Mos u bëni sikur ata të cilët janë ndarë dhe janë konfrontuar pasi që iu kanë ardhur atyre argumente të qarta. Ata janë që meritojnë dënim të madh”.

MUTEFIKU ALEJHI

Dëshiroj të theksoj, të tërheq vëmendjen në një çështje me rëndësi se pluralizmi nuk d.m.th. patjetër dhe domosdo ndarje.

Sikurse dhe mendimet e shumta për një çështje nuk janë gabime dhe mëkate. Siç është rasti kundërshtimi në ide është rezultat i kundërshtimit në ixhtihad për këtë arsye kanë kundërshtuar sehabet me shumë çështje sekondare dhe ata nuk u kanë penguar dhe nuk i kanë dëmtuar aspak. Po ashtu janë kundërshtuar edhe në kohën e Muhamedit a.s. sikurse ka ndodhur me rastin e faljes së namazit të ikindisë gjatë rrugës për në fisin bëni Kurejdha, i cili rast është i njohur, ndërsa Muhamedi a.s. nuk e ka qortuar asnjërin prej grupeve apo mendimeve kundërshtuese.

Disa këtë lloj kundërshtimi e konsiderojnë mëshirë prej Allahut për të pasur hapësirë dhe lehtësim për umetin. Për këtë na ka ardhur në ether “Kundërshtimi i umetit tim është mëshirë”, për këtë është shkruar libri “Mëshira e umetit në kundërshtimin e dijetarëve”.

Është thënë se Omer bin Abdul Azizi nuk ka dëshiruar që të dihet se sehabet nuk kanë kundërshtuar pse kundërshtimi i tyre i ka çelur dyert e fushëveprimit, lehtësisë dhe përshtatshmërisë për umetin. Disa e konsiderojnë kundërshtimin mëshirë pse përfaqëson ndryshimin e njerëzve nga aspekti i diturisë së tyre, zhvillimit të tyre, dhe në këtë mënyrë plotësohen dhe kompletohen nevojat e llojllojshme dhe të shumënumërta të shoqërive.

Kur’ani e konsideron ndryshimin e ngjyrave, të gjuhëve ajet [argument] prej argumenteve të Zotit në krijesat e tij që të logjikojnë dhe meditojnë dijetarët.

Thotë Zoti i Madhëruar:

“[Një] prej argumenteve të tij është krijimi i qiejve dhe tokës dhe ndryshimi i gjuhëve të huaja, dhe ngjyrave të huaja”. Vërtet në këtë ka argumente për intelektualët [dijetarët].

Çdo kundërshtim është i keq, por kundërshtimi është dy llojesh: kundërshtimi sekondar [degëzor] dhe kundërshtimi kontrast. I pari është i lavdëruar, ndërsa i dyti i mallkuar.

Çdo herë në librat e mia dhe në fjalimet e mia kam përkujtuar se nuk ka pengesë në formimin e partive, dhe shoqatave në botën islame, derisa uniteti është i arsyetuar në bazë të mendimeve të ndryshme rreth qëllimeve të tyre, dhe ndryshimit të plan-programeve të tyre, ndryshimit të kuptimeve të tyre dhe ndryshimit të kulturës së tyre në ato rrethe ku ata jetojnë. Me kusht që ky ndryshim apo kundërshtim i mendimeve të jetë në çështje sekondare jo kundërshtime parimore apo thelbësore.

Që të gjithë duhet të rreshtohen në një rresht në të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me ekzistimin e Islamit, imanit, shariatit islamik dhe umetit islam.

Sido që të jetë për të qenë mendimi i mirë, me vlera dhe i arsyetuar, të gjitha anët duhet të jenë të rreshtuara në parimet kryesore dhe atëherë nuk ka mëkat, as devijim në besim. Por është këshillim në punë të mira, këshillimi për fenë, duke u bazuar në urtësi dhe këshilla frytdhënëse për të polemizuar për çështjet të cilat sjellin rezultate.

Këto lloje të polemikave apo të pluralizmit, të cilat janë polemika sekondare [degëzore] nuk shpiten në ndarje dhe në armiqësi dhe as në seperatizimin e umetit si dhe në nënçmimin e njeri-tjetrit, por është kundërshtim nën hijen (nën ombrellën) e unitetit të umetit, dhe prej kësaj nuk kemi pse të frikohemi, sepse nuk ka rrezik prej saj, pasi që kjo sjell rezultate të shëndosha.

Ne e themi këtë para se të themelohet shteti islam, por edhe pasi të themelohet shteti islam, sepse ai shtet islam nuk ngushtohet, nuk zvogëlohet për shkak të kundërshtimeve sekondare, dhe nuk ekzekuton me vdekje për çdo ide të cilën e kanë dhënë grupet e njerëzve, sepse idetë nuk vdesin dhe për këtë arsye nuk lejohet ekzekutimi, sepse nuk vdes ideja me paraqitjen e ideve më të mira se ajo.

PLURALIZMI PARIM NGA JASHTË

Prej dyshimeve që na paraqiten këtu, është, po ashtu, edhe thënia: sistemi shumëpartiak është i ardhur nga jashtë pra, prej demokracisë perëndimore dhe nuk është parim thelbësor islam, pra i buruar prej Islamit, por i ardhur për ne, ndërsa ne jemi të urdhëruar që të mos u përngjajmë të tjerëve, sepse e humbim origjinalitetin tonë “kush i përngjan një populli ai është prej tyre”.

E kemi për të qenë të pavarur në politikë dhe në ide dhe të mos i pasojmë të tjerët pëllëmbë pas pëllëmbë e hap pas hapi.

Ne u përgjigjemi : ajo çka është ndaluar për ne, për të cilën kemi kujdes është pasimi i verbër i të tjerëve, e cila bëhet traditë: shkuarja pas në çdo çështjeje, sa që edhe nëse shkojnë në shpellën e ariut, për të shkuar në shpellë të ariut.

Përngjarja e ndaluar është ajo çka i përngjan në simbolet dhe specifikat me të cilat dallohet nga aspekti fetar si p.sh. mbajtja e kryqit të krishterët apo simbolet të zjarrputistat të tjera, dhe nëse veprohet kështu hyhet në grupin që iu përngjan atyre dhe duket sikur të jetë njëri prej tyre. Ndërkaq, në çështjet e tjera, të cilat kanë të bëjnë në çështjet që shpijnë në zhvillimin e jetës, nuk ka pengesë as ndalesë dhe nuk bëhet mëkat nëse veprohet si të tjerët, sepse **“urtësia [mençuria] është çështje e humbur e besimtarit, kudo që të jetë ai i pari duhet ta marrë,** ai është më i merituari, pse ka përparësi në atë çështje.

Muhamedi a.s. e ka çelur hendekun rreth e përçark Medinës, ndërsa ajo veprimtari [strategji luftarake] nuk ka qenë më parë e njohur tek arabët; ajo ka qenë strategji luftarake e persianëve dhe atë mendim [ide] e ka sjellë Selmani r.a. [Faresij].

Muhamedi a.s. i ka firmosur dhe i ka vulosur letrat dhe mesazhet, kur i është thënë se mbretërit nuk i pranojnë letrat dhe mesazhet e pafurmosura dhe të pavulosura.

E ka marrë Omeri r.a. sistemin e haraxhit dhe ka bërë regjistrimin civil.

E ka marrë Muaviju sistemin postar.

Pas këtyre janë marrë edhe organizime të tjera.

Për këtë arsye nuk ka të keqe, as nuk është mëkat që të merret parimi i sistemit shumëpartiak prej demokracisë perëndimore, por me dy kushte:

Kushti i parë: që të ketë dobi absolute për ne; mos të jetë i dëmshëm dhe të jemi të siguruar prej disa çrregullimeve që dalin prej tij(sistemit shumëpartiak). Me rendësi është që dobia të jetë më e madhe se dëmi.

Sepse dihet që sheriatu islam është i ndërtuar në baza të dobisë së përgjithshme apo dobisë, e cila është më e madhe sesa dëmi, dhe në baza të eliminimit të shkatërrimit apo çrregullimit në përgjithësi apo në veçanti. Zoti i Madhëruar me rastin e bixhozit dhe alkoolit thotë: **“Thuaj në të ka të keqe të madhe dhe dobi për njerëzit, por e keqja në të është më e madhe se dobia”**

SURETUL BEKARE 291

Ky ajet është bazë në këtë rregull të fikhut.

Kushti i dytë: Të veprohet drejt dhe të zhvillojmë atë të cilën e marrim deri sa të harmonizohet dhe të pajtohet me vlerat dhe karakteristikat e fesë dhe të moralit, me ligjet e shariatit dhe traditës sonë bazore.

Nuk mund të na detyrojë askush që të marrim sistemin komplet me të gjitha format p.sh. fanatizmi partiak që e drejta të konsiderohet e shtrembër dhe anasjelltas vetëm për shkak të apetiteve partiake dhe për t'i ndihmuar të padrejtë dhe të drejtë, e cila, siç dihet ka qenë në injorancën e arabëve “ndihmoj vëllait të cilit i është bërë e padrejte, dhe të drejtë”. Këtë thënie e ka përmirësuar Muhamedi a.s. duke ua shpjeguar arabëve dhe duke ua komentuar me komentim të drejtë; **“T'i ndihmosh të padrejtë d.m.th. ta kesh në mbikëqyrje, ta pengosh që të mos bëjë padrejtësi, në këtë mënyrë ai e sundon epshin e tij dhe i largon vesveset e shejtanit”**.

Nga dyshimet që kanë lindur në këtë temë është edhe thënia se ekzistimi i partive brenda shtetit islam e ndan pushtetin e individit [kryetarit] të partisë së cilës i takon dhe shtetit i cili e ka zgjedhur dhe i ka premtuar dëgjueshmëri, përkrahje dhe ndihmë.

Kjo mund të jetë e vërtetë nëse individi merr qëndrim të kundërt me atë të shtetit në çdo çështje dhe e përkrah partinë e tij në çdo çështje, por ne nuk themi ashtu.

Vërtet pushteti i myslimanit është pushteti i Allahut, të Dërguarit të tij, dhe i shoqërisë besimtare, siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Vërtet mbrojtësi i juaj është Allahu dhe i Dërguari i tij dhe besimtarët, të cilët me përkulje e përulje falin namazin, dhe japin zekatin, dhe janë të përulur. Kush e merr për mbrojtës Allahun, të Dërguarin e tij edhe

besimtarët, ta dijë se vërtet partia [ata që janë me Allahun] e Allahut janë ngadhënjimtarë”.

SURETUL MAIDE 55-56

Anëtarësimi i myslimanit në familje, fis, krahinë, shoqatë, syndikatë, union apo parti nuk është në kundërshtim me anëtarësimin në shtet apo në organe shtetërore [mbrojtëse].

Pse këto anëtarësime, përkrahje, mbrojtëse të gjitha përqendrohen dhe ndërliohen në një epiqendër, në një bazë e ajo është : **mbrojtja e Allahut, të Dërguarit të tij, dhe të besimtarëve.** E ndaluar, madje e ndaluar rreptësisht është marrja e pabesimtarëve në mbrojtje në vend të besimtarëve:

“A dëshirojnë dhe kërkojnë forcë kur e tërë forca i takon vetëm Allahut në përgjithësi”.

SURETUL NISAE 139

“O ju te cilët keni besuar, mos e merrni për mik, mbrojtës dhe udhëheqës armikun tim dhe tuajin”.

SURETUL MUMTEHINE 1

Nëse partia bën marrëveshje me kryetarin e asaj partie se do ta përkrahin edhe do të pajtohen edhe në ide që me siguri janë gabim dhe do ta kundërshtojnë shtetin [pozitën] edhe nëse ai me siguri ka të drejtë, këtë as nuk e pranojmë, as nuk e lejojmë dhe ne nuk anojmë nga ajo çka nuk pajtohet me karakterin islam, moralin islam dhe ligjin islam.

IMAMI E PRANON EKZISTIMIN E PARTISË HAVARIXHE

Nëse kthehem në të kaluarën tonë në përgjithësi, në traditën e halifeve rashidin në veçanti, të cilat jemi të urdhëruar që t’i pasojmë dhe t’i përmbajmë, shohim se emri i besimtarëve Aliu r.a. dhe Zoti e zbardhtë fytyrën e tij, ka toleruar partinë, e cila ka qenë opozitë në çështje të politikës, në plan-program të tyre, sa që ka përfunduar duke e akuzuar me pabesim, ndërsa ai ishte prej myslimanëve të parë, nuk i ka mjaftuar vetëm mendimi i tyre teorik, i kanë ngritur shpatat, i kanë shpallur luftë, e kanë dënuar me vdekje atë dhe përkrahësit e tij me thënie e padi se ai ka pushtet njerëzor në fenë e Allahut, ndërsa nuk ka qeverisje e gjykim përpos Allahut me tekstin Kur’anor **“ Vërtet gjykimi [qeverisja] i takon vetëm Allahut”.**

SURETUL JUSUF 40

Kur e ka dëgjuar Imam Aliu r.a. këtë fjalë iu ka kundërpërgjigjur me fjalën e cila është shembull dhe për të tregon edhe historia: **Fjalë e vërtetë, por me të kanë qëllimin e keq”.**

Pas të gjitha këtyre që thamë, ai nuk e ka mohuar ekzistimin e tyre dhe nuk ka urdhëruar për t'i dëbuar e për t'i neutralizuar sa që të mos mbetej asnjë shenjë prej tyre, por u ka thënë atyre qartazi dhe hapur: **“ Të mos ndaleni prej xhamive të Allahut, të mos ndaloheni prej pasurisë shtetërore derisa edhe ne edhe ju keni të drejtë, dhe të mos luftoni kundër nesh ”.**

Ndërsa iluzioni [mendimi i keq] i havarixhëve ka qenë se ata simbolizojnë opozitën e armatosur dhe forcën, e cila ka arritur në shkallën e fundit, në armiqësi.

Unë e di se imami dëshmor Hasan Bena nuk i ka pranuar partitë dhe sistemin shumëpartiak në Islam.

Kjo ka qenë çështje e ixhtihadit të tij, kur në kohën e tij e ka ndarë umetin në ballafaqim me armikun ata kanë qenë parti të grumbulluara rreth individëve e jo në parti me qëllime të qarta, dhe me projekte e plan-programe të definuara. Në disa punime të tij ka thënë për liderët e partive dhe udhëheqësit e tyre:

Vërtet kolonializmi ju bashkon e pastaj ju ndan në mes vete, ju nuk keni për qëllim asgjë vetëm ndërtimin e kështjellës së tij, dhe nuk bashkoheni për asgjë tjetër pos për ta bartur barrën e tij.

Nuk prish punë nëse ixhtihadi ynë nuk pajtohet me ixhtihadin e tij, pse ai nuk ka ndaluar që pas tij të bëhet ixhtihad për këtë çështje [sistemin shumëpartiak] posaçërisht kur të ndryshojnë kushtet, rrethanat, të përmirësohet gjendja, zhvillohen idetë dhe mendimet. Ndoshta po të kishte jetuar në kohën tonë do të thoshte mendimin tone, sepse fetvatë ndryshojnë me ndryshimin e kohës, gjendjes dhe vendit, posaçërisht në çështje të politikës e cila ndryshon shpesh.

Ata të cilët e njohin Hasan Benën e dinë se ai nuk ka qenë i ngurtë as i mbyllur, por ka qenë evolutiv, revolucionar dhe dinamik.

Laikët ose sekularistët e paramendojnë shtetin islam shtet totalitar, pse është shtet i cili nuk toleron zërin e tjetrit, as mendimin e opozitës, as të ndonjë shoqërie apo partie.

Ndërsa realiteti tregon se në fushën e forcave të ndryshme apo të shoqërive të shumë numërta Islami bëhet më stabil, sepse ato posedojnë mendime dhe ide të reja, kuptime të ndryshme, projekte dhe plan-programe. Nëse ka mundësi që njëra prej tyre ta fitojë pushtetin në një farë mënyre apo në një tjetër, a u lejon partive apo forcave të tjera që të mbësin dhe të vazhdojnë apo i neutralizon dhe i largon prej skenës politike dhe ajo të mbetet përgjithmonë.

Më e drejta dhe më e fuqishmja është që të mbësin forcat e tjera politike në skenë si opozitë për ta orientuar pozitën, që të urdhërojë në punë të mira, që të largojë nga veprat e keqija, që të këshillojë për Allahun, të Dërguarin e tij dhe për të mirën e të gjithë myslimanëve në përgjithësi.

Edhe pse sistemi shumëpartiak dhe forcat e ndryshme politike janë të ligjshme në shtetin islam duke iu përmbajtur ligjeve islame, atëherë më të nevojshme edhe më të preferueshme janë që partitë dhe shoqëritë e shumta të jenë para themelimit të shtetit islam. Nuk ka kurrfarë pengese që në arenën e fushëveprimit

të jenë shumë parti, të cilat angazhohen për vendosjen e shoqërisë islame dhe të shtetit islam, dhe të angazhohen në rrugën e Allahut me të gjitha mjetet ligjore.

Pa tjetër duhet tërhequr vërejtjen (sepse nuk është e mirë për të qenë pasiv dhe për të heshtur për këtë çështje, siç mendojnë disa individë dhe disa shoqata dhe pastaj ato ide apo ato mendime për t'ia mveshur Islamit) se ka ndodhur që disa kanë dhënë fetva se formimi i partive apo anëtarësimi në to është haram dhe është bidat në fe, sepse atë nuk e ka lejuar Allahu pa marrë parasysh si quhet: shoqëri, shoqatë apo parti, ose, si të duash, dhe në çfarëdo adrese emërtoje.

Për fenë e Allahut kjo është e çuditshme: e akuzon dhe e sulmon sheriatin pa argumente dhe pa fakte, dhe e ndalon atë çka e ka lejuar Allahu; pa dije dhe pa fakte, sepse esenciale është që çështjet dhe aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis njerëzve janë të lejuara. Formimi i grupeve dhe partive janë në shërbim dhe për shërbim të Islamit.

Por më e drejta është që formimi i shoqërive [partive] të jetë në orientim të ligjeve të sheriatit në përgjithësi dhe rregullave parësore. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Ndihmohuni në punë të mira [aktivitete të dobishme] dhe në devotshmëri

SURETUL MAIDE 2

Në një ajet tjetër Zoti i Madhëruar thotë: **“[Përqendrohuni, orientohuni] dhe përmbahuni për litarin [ligjin] e Allahut të gjithë së bashku e mos u ndani”**

SURETUL ALI IMRAN 113

I Dërguari i Allahut thotë:

“Besimtari për besimtarin duhet të jetë sikurse një ndërtesë ku pjesët e saj e mbajnë dhe e ndërlidhin njëra-tjetrën.

“Ndihma e Allahut është në bashkësi, kush veçohet, veçohet në zjarr”.

Rregulla e fikhut thotë; “Çdo vaxhib i cili nuk mund të realizohet pa at mjet, ai mjet është vaxhib”. Është më se e sigurt se në kohën e sodit, shërbimi ndaj Islamit, ruajtja e identitetit të umetit dhe aktiviteti për vendosjen e shtetit Islam nuk mund të arrihen vetëm me individë këtu e atje, por pa tjetër duhet vepruar bashkërisht si institucione ligjore shoqërore, me aktivitetet sistematik të organizuar, të gjithë për t'u rreshtuar në rreshtin organizativ, për të pasur qëllim të drejtë, të qartë, dhe për të pasur të caktuar rrugën e drejtë dhe të vërtetë.

Këtë e vërteton fakti se forcat të cilat janë armiq të Islamit dhe të cilat veprojnë për qëllime të tjera nuk veprojnë ndaras, por në formë të një boshti të fortë dhe në forma të organizatave të mëdha, të cilat posedojnë mjete të mëdha financiare dhe numër të madh në njerëz. Si mundemi ne t'u kundërvihemi veç e veç apo bashkërisht. Beteja e kërkon që të gjithë të rreshtohemi në një rresht siç thotë Zoti i Madhëruar.

“Vërtet Allahu i do ata të cilët luftojnë në rrugën e tij të jenë një rresht sikurse ndërtesa e ndërlidhur njëra me tjetrën “.

SURETUL SAF 4

Vërtet veprimtaria e përbashkët për t'i ndihmuar Islamit dhe lirimit të vendit të tij, bashkimit të umetit, dhe ngritjes së fjalës së tij është farz me

domosdoshmëri. Farz të cilin e obligon feja dhe domosdoshmëri të cilën e tregon realiteti. Ndërsa aktiviteti dhe veprimtaria e përbashkët d.m.th. formimi i shoqërive dhe partive të cilat do ta kryejnë këtë vaxhib.

Kontrast me këtë mendim është mendimi, i cili e sheh se veprimi i përbashkët [xhamaijun] është farz, mirëpo këtë farz e përkufizon në një xhemat [parti] të caktuar dhe se e vetmja ajo e përfaqëson të drejtën absolute dhe çdo parti pos saj është e pavlefshme dhe e papranuar, duke aluduar në ajetin Kur'anor:

“Dhe çka pas të vërtetës përpos humbja [e pavërteta]

SURETUL JONUZ 32

Me fjalë të tjera ky grup e përshkruan vetëm si “Xhematu muslimine” ndërsa nuk është asgjë tjetër përpos “xhematu minel muslimine” [xhematë prej myslimanëve jo xhemat i myslimanëve] dhe për derisa ata janë xhemat i myslimanëve kush do që ndahet prej tyre është nda prej xhematit, dhe kush nuk hyn në atë grup nuk është xhemat i myslimanëve. Dhe çka ka ardhur prej hadithit për “xhematin” për t’iu përmbajtur “xhematit”, për t’u ndarë prej “xhematit” ka dalë prej xhematit të tyre.

Kjo formë e argumentimit dhe vendosja e tekstit jo në vendin e tij dhe jo si citohet në hadith, realisht nuk është asgjë tjetër përpos sherr [fatkeqësi] për umetin, sepse i ka vendosur argumentet jo në vendet dhe jo për vendet e tyre.

Prej këtyre e bëjnë të drejtën në anën e xhematit të tyre ose të partisë së tyre e për të tjerët jo, me arsyetimet të cilat i formulojnë vetëm për partinë e tyre apo vetëm për grupin e tyre. Kjo është vetëm barrë, ngarkesë të cilën nuk e pranon dituria e as logjika e shëndoshë.

Të tjerët e vendosin në peshojë vetëm zhvillimin kohor apo kohën e marrin për bazë, pra kush ka qenë më i pari, vetëm tek ai qëndron e drejta, realiteti, dhe vetëm atyre u takon e drejta. Derisa disa parti në disa vende islame thonë se vetëm ato kanë të drejtë, sepse ajo parti është e para dhe më e hershmja, dhe çdo parti e cila formohet pastaj, duhet të neutralizohet dhe të zhduket dhe nuk ka të drejtë për të ekzistuar. Sepse pasi që shumica e kanë pranuar, ajo konsiderohet zgjedhje për të dhe moszgjedhje për tjetrën siç ekziston në hadith; nëse dy halife votohen, kush fiton lene, tjetrin vriten”.

Këto janë fetva të injorancës [xhahilijetit] dhe e kanë burimin prej njerëzve të cilët me këmbët e tyre nuk kanë kaluar në fushën e shkencës së sheriatit. Ata i sjellin umetit sherr dhe fatkeqësi, dhe përgatitin të këqija shkatërrimtare. Disa fukaha në kohërat të kaluara kur i kanë dëgjuar disa fetva të atyre të cilët kanë thënë se kemi dituri e nuk kanë pasur kanë thënë: disa të cilët japin fetva sot, pra ata e meritojnë burgun si hajnat, sepse hajnat e shkatërrojnë jetën e njerëzve ndërsa ata e shkatërrojnë fenë e njerëzve.

Çka do të thoshin ata fukaha për fetvatë të cilat i dëgjojmë dhe lexojmë në kohën e sodit **-LA HAVLE VELA KUVET IL – LA BILAH.**

TOLERANCA ISLAME DHE DREJTËSIA E SAJ ME JOMYSLIMANËT

Pyetja:

Në përgjithësi dihet mirë se secili fetar, çfarëdo feje që i takon, kërkohet t'i përmbahet fesë së tij në përpikëri, të jetë mbrojtës i saj, ta dojë atë i cili i takon fesë së tij dhe të mos besojë asaj që nuk i takon fesë së tij. Bindja e tij se vetëm feja e tij është e drejtë dhe çdo fe tjetër jo e drejtë. Islami është njëra prej feve për të cilën nuk ka dyshim.

Disa fetarë sa i takon kësaj çështjeje i tejkalojnë kufijtë dhe fanatizmi i tyre kalon në urrejtjen të çdokujt që nuk i përket fesë së tij, e cila shpesh kalon edhe në armiqësi sa që e konsiderojnë të lejuar edhe për ta vrarë, e për t'ia marrë pasurinë pjesëtarit të fesë tjetër, duke mos parë as gabim as mëkat, bile mendojnë se ashtu afrohen te Zoti i Madhëruar.

Nuk ka dyshim se kjo është tepër e rrezikshme nëse fetë e ndryshme i takojnë një populli, një gjaku, një atdheu, pra edhe myslimanët edhe jomyslimanët janë të një populli, dhe kështu fillon përçarja, paraqiten kundërthëniet dhe secili punon dhe vepron me mendje të keqe dhe me frikë. Kjo e keqe e ka edhe të keqen tjetër kur këtë e shfrytëzojnë popujt e tjerë me dinakëri dhe aq shumë thellohet ndarja dhe ndizet zjarri e rritet e zmadhohet sa që i tëri [populli] digjet e popujt e tjerë vetëm vështrojnë e shikojnë.

Për këtë arsye, i nderuari ynë, dëshirojmë të na jepni pak dritë në lidhje me këtë çështje dhe të shpjegoni qëndrimin e Islamit ndaj jo myslimanëve, posaçërisht nëse janë pakicë jo islame, ndërsa shumica islame, me qëllim që të mos keqkuptohet Islami ose mos t'i bëhen padrejtësi nga disa që i përkasin Islamit dhe janë bijtë e tij, të cilët nuk kanë diapazon të gjerë të kuptimit dhe as të veprimtimit në fikh.

Zoti qoftë i kënaqur me përgjigjen tuaj.

Falënderoj Allahun, përshëndes të Dërguarin e Allahut, familjen e tij, shokët e tij dhe kush e pason rrugën e tij. Kjo çështje e cila i përket qëndrimit islam ndaj jomyslimanëve është prej çështjeve më të rëndësishme të cilën duhet sqaruar, për t'i hequr dyshimet dhe për ta kuptuar drejt; është prej çështjeve e cila kërkon dituri të thellë ashtu që myslimanët të mos gabojnë për të vepruar diçka çka Islami vetë e refuzon, ndërsa ata mendojnë se janë duke vepruar drejt.

Kam shkruar një libër i cili është botuar dhe është shpërndarë në shumë vende, është ribotuar shumë herë dhe është përkthyer në shumë gjuhë të botës e ai libër është ;"Jomyslimanët në shoqërinë islame".

FAKTE TE CILAT DUHET PASUR PARASYSH

Pa

ra se të shpjegojmë qëndrimin e Islamit duhet të përqendrohemi në disa fakte si vijon:

E para, nuk duhet marrë parasysh veprimet e disa myslimanëve, të cilët e kanë kuptimin e ngushtë të fikhut, dhe nuk kanë edukatë të mjaftueshme islame. Është e vërtetë se Islami është argument për myslimanët e nuk janë myslimanët argument për Islamin. Sa e sa herë Islami është sprovuar me njerëz të cilët e përfaqësojnë atë, apo llogariten në të, ata me sjelljet e tyre e dëmtojnë Islamin me shumë se sa armiqtë, të cilët përgatisin kurtha fshehtëzi apo e sulmojnë haptazi. Thënie e vjetër është: armiku i mençur është më i mirë se miku ahmak.

Thotë poeti:

“Çdo sëmundje e ka ilaçin me të cilin shërohet, përpos ahmaku që e sëmure atë i cili e shëron.

E dyta, ata injorantë apo ata ahmakë të cilët tregohen tepër fanatikë ndaj atyre që nuk janë në fenë e tyre dhe shkaktojnë probleme me ta pa arsye sa që disa kalojnë edhe kufijtë duke e rrezikuar edhe pasurinë edhe gjakun e tyre dhe prej tyre nuk shpëtojnë as vëllezërit e tyre të fesë islame. Ata i akuzojnë myslimanët për fenë e tyre, për besimin e tyre e në disa raste i konsiderojnë edhe pabesimtarë, i largojnë prej fesë së tyre islame dhe thuaja se vetëm ata janë të afërmit e Allahut dhe u lejuakan atyre çështjet më të shenjta të tyre [jeta dhe pasuria].

Kjo është rezultat i tejkalimit të normave dhe futjes së kokës në humnerë.

Këtë e kemi vërejtur te havarixhet më herët dhe e kemi përjetuar me përkrahësit e tyre në kohën e sodit; shkak i kësaj është mashtrimi i vetvetes. Habit fakti kur vrasësi veten e bën melaqe ndërsa të tjerët janë shejtanë; për të. dashuria në vetvete është një ndër shkaqet e shkatërrimit të vetvetes.

E treta, vërtet për këtë fanatizëm, të cilin e shohim dhe e përjetojmë te disa fetarë në shumicën e rasteve shkak është mosfeja, edhe pse mvishet me pëlhurë të fesë bile në shumë raste sipas disa studimeve dhe analizave është vërtetuar se janë shkaqet shoqërore, ekonomike dhe fetare e jo politike.

Për këtë arsye ne e shohim se ai fanatizëm në disa vende paraqitet e në disa vende jo, sepse kushtet shoqërore janë ato të cilat kanë ndikuar që të trashëgohet ajo sëmundje. Trashëgimia ka ndikuar për t'u rritur ai fryt. Cilitdo që i bëhet padrejtësi, ai e akuzon fenë e tjetrit, kinse ajo paskësh ndikuar në padrejtësi dhe ekstremizëm.

E katërta, fanatizmi te disa myslimanë është shkaktar i fanatizmit të fesë tjetër apo të vëllezërve jomyslimanë të vendit të tij. Dhe nuk është e drejtë që të akuzohet gjithmonë shumica për fanatizëm kundër pakicës. Në shumicën e rasteve e shtyn pakicën apo individët në ndikimin e frikës dhe nëse nuk kanë bazë, duke i hiperbolizuar çështjet apo duke i zmadhuar gjërat me arsye e shpjegime vetëm për ta futur në grackë shumicën. Në këtë atmosferë fillon të lëkundet besimi në mes të elementeve [konfesioneve të ndryshme] në atë vend apo në atë atdhe, ku përhapen dezinformata dhe miza bëhet buall, sa që asnjëri

nuk ka mundësi për t'u ballafaquar me realitetin dhe për ta shëruar atë problem në rrënjë.

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ JOMYSLIMANËVE

Do të kisha dashur të sqaroja në dritën e faktorëve, të cilët patjetër duhet përmendur në pika të shkurtra, qëndrimin e Islamit ndaj të tjerëve apo ndaj jomyslimanëve – pra të feve të tjera.

Dihet se përpos Islamit kemi dy kategori të feve të tjera.

-Kategoria e parë, janë ithtarët e feve idhujtarë apo tokësore idhujtarët e putave, zjarrputistat dhe sabiinët, adhurues të yjeve.

-Kategoria e dytë: fetë qiellore apo fe të shpallura. Pra atyre u ka zbritur libri prej Allahut e ata janë të krishterët dhe hebrenjtë(jahuditë). Kur'an i quan ithtarë të librit pra si shprehje e butë dhe përkëdhelëse.

Këta ithtarë të librit kanë marrëdhënie shembullore në Islam dhe kanë specifika të veçanta. Islami e ka lejuar për ta ngrënë ushqimin e tyre, e ka lejuar edhe miqësinë dhe martesat me ta, siç thotë Zoti i Madhëruar në Kur'an: **“Edhe ushqimi i atyre të cilëve u ka zbritur libri u është lejuar edhe ushqimi i juaj u është lejuar atyre, edhe besimtarët e ndershme i keni të lejuara por edhe ato që janë të ndershme prej atyre që u është dhënë libri përpara jush.**

SURETL MAIDE 5

Miqësia [vjuhëria] është njëra prej lidhjeve kryesore e cila i ndërlidh njerëzit mes vete siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Ai është që prej uji ka krijuar njeri dhe i ka bërë atij fise dhe vjehrrin [miqësi]”.

SURETUL FURKAN 54

Sikurse edhe martesa në aspektin islam shton, përforcon qetësi, dashuri dhe mëshirë. Ajo është shtyllë e jetesës bashkëshortore, siç e përshkruan Kur'ani;

“Një prej argumenteve të tij është se ka krijuar prej jush bashkëshorte për të banuar dhe për të jetuar në qetësi me to, dhe ka bërë mes jush dashuri dhe mëshirë”.

SURETU RRUM 21

Kuptimi i martesës së myslimanit me ithtare të librit përfshin ndërlidhjen me mikun, gjyshin, fëmijët e gjyshit, hallat, tezet, dajët, fëmijët e tyre prej ithtarëve të librit. Këta kanë të drejta të ndërlidhjes farefisnore të cilën e ka bërë farz Islami.

Nuk mundemi të gjejmë në fetë e tjera joislame zemërgjerësi më të madhe, dhe drejtësi më të madhe ashtu siç e ka paraparë sheriatu islamik.

Përpos kësaj kemi formën tjetër me jomyslimanët nga aspekti i gjendjes së tyre në shtetin islam ose umetin Islam. Jomyslimanët mundën të jenë ose në gjendje lufte, ose në marrëveshje paqe.

“Në gjendje lufte” bëjnë pjesë ata të cilët janë armiq të Islamit dhe që e luftojnë Islamin; Për këta ka ligje të cilat i ka vendosur Islami si duhet për t’u sjellë me ta. Janë vendosur rregullat e caktuara si duhet sjellë me ta edhe gjatë luftës; për të mos pasur armiqësi dhe për t’i tejkaluar kufijtë, për të mos e nënçmuar të vrarin[kufomën] për të mos i prerë pemët, për të mos i shkatërruar shtëpitë, për të mos vrarë gratë dhe fëmijët e as plakun, por për t’i vrarë vetëm ata të cilët luftojnë etj.etj., çka është e definuar në librat e “biografisë së Muhamedit a.s.” ose në librat e “xhihadit” në fikhun islam.

“Në gjendje paqe dhe në marrëveshje duhet përmbajtur kushteve të marrëveshjes: t’u jepen të drejtat e tyre, për t’u sjellë mirë, me drejtësi dhe të krijohen marrëdhënie të mira të ndërsjella(reciproke).

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe me drejtësi ndaj atyre që nuk ju luftojnë për shkak të fesë dhe nuk ju përzënë nga shtëpitë tuaja. Me të vërtetë Allahu i do të drejtë.

Vetëm se Allahu ju ndalon t’i merrni për miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe u përzënë nga shtëpitë tuaja dhe përkrahin dhe u ndihmojnë të tjerëve për t’ju përzënë. Kush i merr për miq ata , janë kriminelë.

SURETUL MUMTEHINE 8-9

“Mirësi” quhet drejtësia dhe bamireshia. Këto dy ajete kanë zbritur për idhujtarët siç tregojnë shkaqet e zbritjes së kësaj sure.

Ithtarët e librit kanë përparësi për mirësi dhe drejtësi.

Përpos kësaj banorët me të cilët kemi marrëveshje janë dy kategori:

- 1- Kategoria e parë : ata me të cilët lidhet marrëveshja përkohësisht, me ata duhet vazhduar marrëveshjen deri në skadimin e afatit.
- 2- Kategoria e dytë: ata me të cilët kemi marrëveshje përgjithmonë. Këta Islami i quan **“ehli dhimeh”** pse ata e kanë të drejtën e kujdesjes për ta, pra janë nën mbrojtjen e Allahut, të Dërguarit të tij dhe të besimtarëve. Për këtë kategori Islami e ka definuar ; **“Ata kanë të drejtë çfarë kemi ne dhe kanë përgjegjësi çfarë kemi ne”**. Me fjalë të tjera çka e kërkon natyra e fesë së tyre dhe çka e kërkon natyra e fesë sonë.

“Ehli dhime [pakicat kombëtare]” e kanë shtetësinë islame, me fjalë të tjera janë banorë të barabartë në shtetin islam.

Shprehja **“Ehli dhime** [pakicë kombëtare]” nuk ka domethënie cungim i së drejtës, por ajo shprehje nënkupton obligimin për t’u kujdesur dhe për t’i mbrojtur pakicat kombëtare dhe për të realizuar marrëveshjet e ligjit të Allahut.

Nëse vëllezërit e krishterë e ndiejnë veten të nënçmuar me termin **“Ehli dhime”** ata mund ta ndryshojnë, por mos të thonë se Zoti i Madhëruar me këtë shprehje nuk na ka bërë ibadet. Omeri r.a. nuk e ka përdorur shprehjen e cila është më e rëndësishme se kjo me rastin e fjalës **“xhizje”** edhe pse është përmendur në Kur’an kur shumica e krishterëve arabë kanë kërkuar për të mos e përdorur, por për t’i dhënë vetëkontributet në titullin **“sadaka”** jo **“xhizje”** edhe pse **“sadakate”** [vetëkontributet] ishin më të mëdha. Omeri r.a. e ka pranuar

kërkesën e tyre dhe nuk e ka parë si pengesë por ka thënë ky popull është i marrë: “E ka pranuar domethënien, ndërsa e ka refuzuar fjalën”.

Ky veprim i Omerul Farukut na tërheq vëmendjen për një çështje shumë të rëndësishme: për të shikuar në qëllimin dhe domethënien e fjalive jo në anën formale dhe konstruktin e fjalive. Nuk duhet shikuar formën e emërimit por duhet shikuar në brendi të emërimit. Nga kjo themi nuk është e domosdoshme për ta përdorur fjalën **“xhizje”** vëllezërit tanë të krishterë në Egjipt dhe pakicat e tjera në vendet arabe dhe islame, të cilët jetojnë bashkërisht me myslimanët, janë pjesë përbërëse e një populli. Mjafton për ta paguar tatimin ose edhe fizikisht t’i bashkëngjiten umetit për të mbrojtur atdheun.

E kam sqaruar në librin tim, i cili është botuar më herët për të drejtat e bashkatdhetarëve prej **“Ehli dhime”** [pakicë] joislame në vendin islam dhe obligimin për ta ruajtur gjakun e tyre, pasurinë e tyre, nderin e tyre dhe tempujt e tyre dhe çdo gjë çka u takon atyre; Respektimin e besimit të tyre, simboleve të tyre. Dhe mbrojtjen e tyre nga çdo armik i jashtëm, dhe për të larguar çdo gjë e cila i ngushton gjokset e tyre ose që i nënçmon ata, familjet e tyre dhe pasardhësit e tyre.

Kur’ani e ka treguar edhe edukatën e dialogut me ithtarët e librit në shkallën më të lartë kur thotë:

“Mos i polemizo ithtarët e librit në atë çka është progresive dhe e dobishme, përveç atyre që bëjnë krime prej mesit të tyre dhe thuaj: besojmë në atë çka na ka zbritur neve dhe çka ju ka zbritur juve, sepse Zoti ynë dhe i juaji është një. Ne atij i bëhemi mysliman”.

SURETUL ANKEBUT 46

Nëse ekzistojnë dy forma të dialogut apo të polemikave njëra është e mirë tjetra është më e mirë. Kërkohet që të zgjedhet forma e dialogut më të mirë.

Kur’ani përqendrohet në vendet e pajtueshmërisë në mes të myslimanëve dhe ithtarëve të librit e jo në pikat e veçorive dhe të kundërshtimeve; **“Dhe thuaj besojmë në atë çka na ka zbritur neve dhe çka ju ka zbrit juve. Zoti ynë dhe i juaji është një i vetëm.**

SURETUL ANKEBUT 46

Pakicat joislame [**Ehlul Dhime**] prej ithtarëve të librit kanë status të posaçëm, ndërsa ithtarët e librit arab kanë status edhe më të posaçëm, sepse janë arabë dhe të popullit arab, e kanë gjuhën e Kur’anit, kulturën islame. Sepse edhe ata kanë marrë pjesë në trashëgiminë kulturore, zhvillimin bashkëkohor dhe kulturor; ata janë myslimanë, edhe pse nga aspekti fetar dhe kohor janë të krishterë. Këtë ia kam thënë para shumë vitesh dr.Luis Aved kur i bëri një vizitë Katarit dhe mori pjesë në manifestimin „Nada el xhizr” kulturor ku ka kërkuar nga unë ta komentoj këtë çështje.

Të drejtat të cilat i ka vendosur Islami nuk janë vetëm lajme në letër, por janë të drejta të shenjta, të cilat i ka vendosur sheriatu islam, ligji i Allahut. Nuk ka të drejtë asnjë prej njerëzve për t’i zhvleftësuar. Këto janë të drejta të cilat

përfshijnë dhe sigurojnë garancione të llojllojshme si garancionin e besimit në zemrën e secilit person islam dhe ibadetin e praktikimit të urdhrit të Allahut, dhe largimit të ndalesës së Allahut; Garancionet e karakterit të përgjithshëm islam ku përfaqësohet e tërë shoqëria, posaçërisht dijetarët dhe fukahatë për të mbrojtur sheriatin; Kaditë [gjyqtarët] e drejtë dhe të fortë të cilët prej tyre kanë gjykuar [kanë dënuar] kryetarët[halifet], në llogari apo në dobi të individit të pakicës jo islame të cilit i është bërë padrejtësi.

E dimë fort mirë kur Imami Evzai merr vendim në dobi të shoqërisë joislame [Ehli Dhime] në Liban kundër Emirit Abasit, i cili ka qenë i afërt i kryetarit [halifes].

E dimë fort mirë kur Ibn Tejmije kërkon prej Timor Linkit(Timurlenko) për t' liruar robërit e luftës. Ai pranon për t'i liruar vetëm robërit myslimanë, të cilët kanë qenë tek ai. Por Ibn Tejmije refuzon duke u arsyetuar se kërkon të lirohen të gjithë robërit e luftës edhe nga pakica joislame [Ehli Dhime].

SHKALLA MË E LARTË E TOLERANCËS VETËM TE MYSLIMANËT

Toleranca fetare dhe e ideve ka shkallë dhe kategori .

Shkalla e parë e tolerancës, për ta lënë të lirë tjetrin i cili nuk i takon fesë tëndë në kryerjen e detyrave fetare dhe të besimit, të mos e detyrosh për ta pranuar fenë tëndë ose drejtimin tënd, dhe nëse refuzon të mos e dënosh me vdekje, ose me burgim, ose me dënime të tjera të lloj-llojshme të torturimit, të përndjekjeve, por për t'i lënë të lirë në fenë e tyre. Mirëpo nuk mund t'i praktikosh obligimet të cilat i ka paraparë feja e tij ose për t'i ndaluar nga ndalesat, të cilat i ka ndaluar feja e tij.

Shkalla e dytë [e mesme] e tolerancës: për t'i lënë ta realizojnë të drejtën të cilën e parasheh fetarisht në fenë e tij ose drejtimin e tij; pastaj të mos i vështirësohen atij çështjet për moskryerjen e një detyre [obligimi] fetar apo për ta detyruar që ta bëjë një ndalesë të cilën ai nuk e dëshiron p.sh. nëse jehudia e parasheh se e ndaluar është për të punuar ditën e shtunë, nuk lejohet të ngarkohet dhe të obligohet për të punuar këtë ditë, pse nëse ai e punon këtë ditë është në kundërshtim me fenë e tij. Nëse i krishteri e parasheh se e ka obligim për të shkuar në kishë ditën e diel, nuk lejohet të pengohet për të shkuar në këtë ditë në kishë.

Shkalla e tretë dhe më e larta e tolerancës: të mos ngushtohen apo të mos pengohen të tjerët me diçka çka e parashohin të lejuar në fenë e tyre apo në drejtimin e tyre edhe nëse është e ndaluar në fenë tëndë apo në drejtimin tënd.

Këto janë shkallët e tolerancës së myslimanëve ndaj jomyslimanëve [Ehli Dhime] dhe shkalla e tretë është ajo që i ngrit myslimanët të jenë në tolerancën e plotë.

Myslimanët vetëm e kanë praktikuar respektimin ndaj jomyslimanëve të drejtën çka është e lejuar tek ata dhe nuk i kanë detyruar për t'u ndaluar dhe as nuk i kanë penguar, edhe pse kanë pasur mundësi për t'u ndaluar atyre duke

pasur parasysh se në Islam sheriati është edhe ligj i shtetit por edhe ligj i fesë dhe nuk kanë për çka për të akuzuar për çfarëdo lloj fanatizmi për arsye se një send çka e ka lejuar një fe, nuk është obligim për pjesëtarët e feve të tjera për ta punuar(realizuar). Nëse feja zjarrputiste e lejon martesën me nënat apo me motrat, mundet të martohet me të tjerat pa kurrfarë vështirësie. Nëse feja krishtere e lejon mishin e derrit, pjesëtari i fesë tjetër mund të jetojë pa kurrfarë vështirësie pa ngrënë mish të derrit sepse ka të mjaftueshëm mish qengji, mish lope, mish të shpendëve etj.etj.

Njësoj edhe me alkoolin, edhe pse disa libra të krishtere e kanë lejuar ose e kanë lejuar në sasi të vogël për përmirësimin e midës, në krishterizëm nuk është obligim pirja e alkoolit për të krishterin.

Nëse Islami u thotë pakicave joislame: mos u martoni me gratë e ndaluara në Islam, mos pini alkool, mos e hani mishin e derrit, për të mos i thyer ndjenjat e myslimanëve, nuk do të kishin pasur kurrfarë mëkati në fenë e tyre, dhe nuk do të kishin pasur kurrfarë vështirësie, dhe nuk do ta kishin lënë ndonjë detyrë të shenjtë fetare. Pas të gjitha këtyre Islami nuk ka thënë për t' u ndaluar prej këtyre çështjeve dhe nuk ka dashur për t'u imponuar atyre, jomuslimanëve një çështje çka mendojnë se është e lejuar, t'u ndalohet. Por Islami u thotë myslimanëve: leni të lirë në fenë e tyre.

SHPIRTI I TOLERANCES TE MYSLIMANËT

Ekziston edhe çështja tjetër, e cila nuk bën pjesë në sferën e së drejtës të cilën e rregullojnë ligjet dhe as nuk e bën obligativ ligji, as organet juridike, as organet ekzekutive. Ky është **“shpirti tolerancës”**, që përfshin marrëdhëniet e mira në jetë, ruajtjen e fqinjësisë, bamirësinë, mëshirësinë, butësinë. Të gjitha këto janë çështje për të cilat ka nevojë jeta e përditshme. Këtu nuk ka ligj apo gjyq. Ky **“shpirt”** nuk gjendet në shoqërinë joislame.

SURETUL LUKMAN 15

Kur'ani inicon për mirësi dhe drejtësi për ata të cilët janë jomuslimanë por që nuk kanë luftuar kundër myslimanëve në fe, sikur në ajetin e Suretul Mumtehine.

Kur'ani i cilëson dhe i karakterizon robër të mirë ata të cilët:

Dhe i ushqejnë me dashuri dhe respekt ndaj Allahut, të varfrit, jetimët dhe robërit. SURETUL INSAN 8

Kur ka zbritur ky ajet robër kanë qenë vetëm idhujtarët.

Kur'ani u përgjigjet atyre të cilët shprehin dyshim ndaj disa myslimanëve për lejimin e dhënies sadaka dhe ndihmë fqinjëve idhujtarë duke thënë:

“Ti nuk ke mundësi të udhëzosh, por Allahu udhëzon kë të do dhe çka do që shpenzoni prej të mirave e keni për vete dhe çka do që shpenzoni shpenzoni vetëm për hir të Allahut.

SURETUL BEKARE 272

Nxënësi dhe shoku i Ebu Hanifes Muhamed bin Hasan transmeton dhe është i regjistruar në medhheb se Muhamedi a.s. i ka dërguar banorëve të Mekës pasuri

“ndihma” kur ishte gjendje e vështirë ekonomike, për t’ua shpërndarë fukarenjve, përkundër asaj që banorët e Mekës janë sjellë ashpër ndaj tij dhe shokëve të tij: i kanë mallkuar dhe i kanë nënçmuar.

Transmeton Buhariu, Muslimi dhe Ahmedi se Esmë e bija e Ebu Bekrit ka thënë: “Në kohën e marrëveshjes së armëpushimit me kurejshitet erdhi nëna për të më vizituar e ajo ishte idhujtare, shkova te Muhamedi a.s. dhe i thashë: -O i Dërguar, nëna ka ardhur për të më vizituar, a ta pranoj dhe të sillem mirë me të”. Muhamedi a.s. më tha: **“Po sillu mirë me nënën”**.

Kjo formë e tolerancës është paraqitur edhe te vetë Muhamedin a.s. në marrëdhënie të mira me ithtarët e librit, pa marrë parasysh a kanë qenë jahudi apo të krishterë. I ka vizituar, i ka nderuar, i ka respektuar, u ka bërë mirë, i ka vizituar të sëmurit e tyre, u ka dhënë dhe ka marrë prej tyre.

Ibn Ishaku e përshkruan në historinë e Muhamedit a.s. se një delegacion nga Nexhrani, të cilët ishin të krishterë kur shkuan te Muhamedi a.s. në Medinë, pas namazit të ikindisë hynë në xhami, ishte koha e lutjeve të tyre fetare, ata filluan për t’i krye ritet e tyre fetare; disa prej njerëzve deshën për t’i penguar dhe për t’i ndaluar, ndërsa Muhamedi a.s. u tha: **“ Leni të qetë”** dhe ata u kthyen ka lindja dhe i kryen lutjet e tyre.

Këtë ngjarje e komenton edhe Ibn Kajim në librin “Udhëzimet e pejgamberit” dhe e shpjegon qartë se në fikh lejohet që të hyjnë ithtarët e librit në xhamitë e myslimanëve, vendosja e ithtarëve të librit për lutjet e tyre në prezencë të myslimanëve dhe në xhamitë e tyre kur të paraqitet nevoja, por jo për t’u bërë traditë që të vendosen përgjithmonë.

Ebu Abidi në librin “Pasuria” transmeton nga Seid bin Musejeb se Muhamedi a.s. prej arkës islame u ka dhënë sadaka jahudive dhe ka lejuar për t’u dhënë atyre. Gjithashtu transmeton Buhariu se kur ka ndërruar jetë Muhamedi a.s. e ka lënë peng këmishën mbrojtëse të luftës te një jahudi për të shpenzuar për familjen e tij. Muhamedi a.s. ka pasur mundësi për t’u dhënë borxh sahabëve dhe do t’ia kishin ruajtur pa kurrfarë kompensimi, por ka dashur për ta mësuar umetin e tij.

Muhamedi a.s. i ka pranuar dhuratat prej jomyslimanëve dhe ka pranuar ndihmë dhe përkrahje prej jomyslimanëve edhe në luftë edhe në paqë, d.m.th. i ka pranuar garancionet dhe marrëveshjet e tyre dhe nuk është frikuar nga e keqja dhe tradhtia e tyre.

Kjo tolerancë me jomyslimanët ka vazhduar edhe te sehabet edhe tabiinet.

Omeri ka urdhëruar për t’i dhënë ndihmë sociale përgjithmonë jahudiut dhe familjes së tij prej arkës [fondit të buxhetit] të myslimanëve dhe ka thënë : “Zekati [sadakaja] u takon të varfërve dhe të gjorëve”.

SURETU TEUBE 60

Ky është prej të varfërve të ithtarëve të librit.

Ka marrë plagë Omeri r.a. nga e rënia e jomyslimanëve [Ehli Dhine] Ebu LueLui Mexhusi [zjarrputist]

Ndërsa si kryetar [Halife] deri sa ka qenë në shtrat të vdekjes ka thënë dhe ka lënë porosi; E porositi kryetarin [halifen] pas që të sillet mirë me pakicat jo myslimane dhe të vazhdojë marrëveshjet për të jetuar në paqë përpos atyre që luftojnë, dhe për të mos i ngarkuar, vetëm sa kanë mundësi.

Abdullahu Ibn Amri porositi djalën e tij për t'i dhënë mish të kurbanit fqinjit të tij jahudi, e pastaj ka thënë se Muhamedi a.s. ka thënë: **“Xhibrili vazhdimisht me porositi për fqinjin sa që kam menduar që një ditë do të bëhet trashëgimtar në pasurinë time”**.

Umu Harith bin Ebi Rebia ka vdekur si e krishterë, ndërsa sehabet e kanë varrosur dhe kanë ngushëlluar për të.

Disa tabiinë të njohur u kanë dhënë pjesë nga sadekatul fitri murgjve të krishterë dhe për këtë nuk kanë pasur kurrfarë pengese, ndërsa disa prej tyre si p.sh. Ukremet, bin Syrini dhe Zuhra e kanë lejuar për t'u dhënë atyre edhe zekatin. Transmetohet nga Ebu Shejbe nga Xhabir bin Zejdi se është pyetur: Kujt i takon sadekaja? U është përgjigjur u takon myslimanëve dhe atyre prej pakicave joislame.

Gjykatësi Ajad në librin “Tertibul Medarik” shkruan [tregon hadithi Darkutnit] se kadiut Ismail bin Is-hak i kanë dalë në gjyq para tij ministri Abdun Said Nasrani dhe ministri i halifes Muetedi Bilahi Abasij. Gjyqtari çohet në këmbë dhe u shpreh mirëseardhje, ndërsa e pa se dëshmitarët nuk e pëlqyen këtë gjest. Kur dolën nga salla e gjykatës, gjykatësi Ismail u tha: E di se ju keni qenë të zhgënjyer por Zoti i Madhëruar ka thënë: **“Allahu nuk ju ndalon për t' u bërë mirë dhe për të vepruar me drejtësi ndaj atyre që nuk ju kanë luftuar juve dhe fenë tuaj dhe nuk ju kanë dëbuar nga shtëpitë tuaja”**.

SURETUL MUMTEHINE 8

Ky njeri ka gjykuar për nevoja të myslimanëve dhe në të njëjtën kohë ka qenë i deleguar në mesin tonë dhe në rastin e Muetedis. Kjo është prej mirësisë dhe drejtësisë.

Kjo tolerancë vazhdon edhe te shumë dijetarë dhe shumë fukaha në mbrojtje të pakicave joislame duke i konsideruar pasuritë e tyre dhe nderin e tyre si pasuri dhe nderë të myslimanëve. E përmendëm më parë rastin e Imamit Evzai dhe Imamit Ibn Tejmije.

Mjafton të përmendim fjalët e dijetarit të fikhut dhe të Usuli fikhut Shihabudinë Karafi kur e shpjegon kuptimin e fjalës “mirësi” kur e ka urdhëruar Allahu për këtë çështje. Në mes të tjerash thotë: Për t'u sjellë but me ta me të dobëtit e tyre, për të penguar dëmtimin e të varfrit të tyre, për të ushqyer të uriturin e tyre, për të veshur të zdashurin e tyre, për t'u folur me fjalë të buta, me mënyra të buta, dhe me mëshirësi jo për t'i frikësuar e nënçmuar, si butësi e jona ndaj tyre e jo prej frikës dhe lakmisë. Për të bërë dua për ta që t'u sjellin dhurata, për t'i bërë të lumtur, për t'i këshilluar për të gjitha çështjet në fenë e tyre dhe në jetën e tyre; për ta ruajtur pronën dhe nderin e tyre në mungesën e tyre nëse dikush i nënçmon; për t'u siguruar pasuritë e tyre, familjet e tyre, inventarin e tyre dhe të gjitha të drejtat dhe liritë e tyre. Për t'i ndihmuar dhe për

t'i përkrahur kur u bëhet padrejtësi atyre; për t'i realizuar të gjitha të drejtat e tyre etj.etj.

BAZA E IDEVE TE TOLERANCËS SË MYSLIMANËVE

Çështja thelbësore në tolerancën e myslimanëve në raport me pjesëtarët e feve të tjera kthehet në mendimet dhe faktet, të cilat i ka mbjellë Islami në mendjet e tyre dhe në zemrat e tyre, por më e rëndësishmja është:

1. Bindja e myslimanit se njeriu është i fisnikëruar, pa marrë parasysh fenë e tij, gjininë e tij, apo ngjyrën e tij.

Thotë Zoti i Madhëruar: **“Ne e kemi fisnikëruar birin e Ademit”**

SURETUL ISRA 70

Këtë “nderim dhe fisnikëri” çdo njeri duhet ta pranojë, ta respektojë dhe ta ruajë.

Prej shembujve praktikë të cilët i përmendëm më herët është edhe ai të cilin e transmeton Buhariu nga Xhabir bin Abdullahu se : Një kufomë kaloi pranë Muhamedit a.s. e ai u ngrit në këmbë. I thanë: O i Dërguari i Allahut kjo ka qenë kufomë e një jahudie. Muhamedi a.s. u përgjigj: **“A nuk ka qenë njeri?”** Pra çdo njeri në Islam ka vend të posaçëm dhe respekt. A nuk ka gjë më të mrekullueshme se kjo, a nuk ka koment më të mirë se ky?

2. Bindja e myslimanëve se ndryshimi i njerëzve në fe ka ndodhur me dëshirën e Allahut, i cili krijesës njeri i ka dhënë të drejtë të zgjedhë çka të dojë dhe për të lënë çka të dojë: **“Kush do le të besoj dhe kush do le të mohojë”**

SURETUL KEHF 29

Po të kishte dëshiruar Allahu do t'i bënte njerëzit një popull dhe nuk do të ishin të ndryshëm.

SURETUL HUD 118

Myslimani është i bindur se dëshira e Allahut nuk kthehet prapë dhe Allahu nuk dëshiron veçse çka është e mirë dhe që ka urtësi e mësim, e ditën njerëzit apo nuk e ditën. Për këtë arsye myslimani asnjëherë nuk mendon për t'i detyruar njerëzit që të gjithë të bëhen myslimanë. Si është e mundur kur Allahu i Madhëruar i ka thënë të Dërguarit fisnik:

“Po të kishte dashur Allahu do të besonin të gjithë së bashku çka ka në tokë. E ti po i detyron njerëzit deri sa të bëhen besimtarë”.

SURETUL JUNUZ 99

3. Myslimani nuk është i obliguar për të kërkuar llogari prej pabesimtarëve për pabesimin e tyre ose për t'i dënuar të humburit për humbjen e tyre; Kjo nuk është çështje e tij, dhe nuk është për këtë dunja të dënohen , sepse ata do të japin llogari para Allahut në ditën e llogarisë, dënimi i tyre është lënë për në ditën e gjykimit. Ka thënë Zoti i Madhëruar:

“Dhe nëse të kundërshtojnë ti thuaj Allahu e di çka punoni, Allahu do të gjykojë në mesin tuaj ditën e gjykimit për atë çka keni kundërshtuar”.

Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet të Dërguarit të tij për çështjen e ithtarëve të librit:

“Për këtë thirr dhe përmbaju asaj çka je urdhëruar dhe mos paso epshet e tyre dhe thuaju: unë besoj çka ka zbritur prej Allahut prej librave dhe jam i urdhëruar të mbaj drejtësi midis jush. Allahu është Zot i yni dhe Zot i juaji. Ne kemi punët tona dhe ju keni punët tuaja. Nuk ka polemikë mes nesh dhe jush, Allahu do të na bashkojë neve dhe te Ai do të kthehemi”.

SURETU SHURA 15

Me këtë qetësohet zemra e myslimanit. Dhe nuk i mbetet asnjë brengë për konfrontim me bindjen e tij për pabesimin e pabesimtarit dhe kërkesat e tij për mirësi dhe drejtësi dhe vendimi i tij për fenë apo për besimin si e parashihet.

4. Besimi i myslimanit është se Allahu urdhëron për drejtësi dhe barazi dhe kërkon për moral dhe respekt edhe pse janë idhujtarë dhe e urren mizorinë e i dënon mizorët edhe nëse është mizoria e myslimanit ndaj pabesimtarit. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Kurrësi urrejtja që keni ndaj disa njerëzve nuk duhet t’ju shtyje të bëheni të padrejtë”.

SURETUL MAIDE 8

Muhamedi a.s. thotë: **“Duaja ndaj atij të cilit i është bërë padrejtësi edhe nëse është pabesimtarë, nuk ka mes tij perde-pengesë”.**

Toleranca e Islamit me jomyslimanët është tolerancë çka nuk njihet historia për të mirë, posaçërisht nëse është fjala për ithtarët e librit e sidomos nëse janë atdhetarë në shtetin islam dhe kur janë arabë dhe e flasin gjuhën arabe.

POROSITË E PEJGAMBERIT POSAQËRISHT PËR KOPT’ËT E EGJPTIT

Sa u përket koptëve egjiptas ata kanë status të posaçëm dhe vend të posaçëm. Muhamedi a.s. i ka porositur me porosi të veçantë që zgjon mendjen e çdo myslimani.

Selmete, Um Muëmininë r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut në prag të vdekjes se tij ka porositur. **“Vallah, Vallah, sa u përket Koptëve egjiptas, ju do të takoheni, dhe do të bashkoheni me ta, dhe ata do të jenë forcë dhe përgatitja e juaj, ndihmë dhe përkrahja në rrugën e Allahut”.**

Në një hadith tjetër transmeton Abdurrahman HABELIJU, Abdullah bin Jezidi, dhe Amr bin Harithi se Muhamedi a.s. ka thënë :

“Ju porositni dhe tregonu se prej tyre ka të mira, ato do të jenë forcë për ju mbështetje për ju dhe frikë për armikun tuaj me emrin e Allahut”; e ka pasur fjalën për koptët e Egjiptit.

E vërteton historia pastaj atë çka ka lajmëruar Muhamedi a.s. Koptët egjiptas i kanë mirëpritur çlirimtarët, i kanë hapur zemrat e tyre për kundër asaj se romakët kanë qenë të fesë së krishterë, si ata të cilët ishin sundimtarë. Koptët e kanë pranuar fenë islame me të madhe grupe-grupe, sa që disa prijës të Beni Umejes kanë paraparë xhizje për ata të cilët e kanë pranuar Islamin, për shkak të numrit të madh të tyre, të cilët e pranonin Islamin dhe kështu Egjipti u bë derë e përhapjes së Islamit në tërë Afrikën dhe banorët e Egjiptit janë bërë forcë dhe përgatitje, ndihmë dhe përkrahje në rrugën e Allahut.

Në “Sahihun e Muslimit transmetohet nga Ebi Dherri se Muhamedi a.s. ka thënë **“Vërtet ju do ta çlironi një vend që quhet “Kyrat” [Egjipti i sotëm] . Silluni mirë dhe porositni të sillen mirë me ta , pse prej tyre kini mbështetje dhe jeni të një gjaku”**.

Në një hadith tjetër thuhet: **“Ju do ta çlironi Egjiptin e ai vend quhet “Kyrat”;** kur do ta çlironi silluni mirë me banorët e atij vendi se me ta jeni të një gjaku dhe jeni miq ose farefisni dhe miqësi”.

Thonë dijetarët: Farefisnia me ta ka lidhje në Haxheren; nëna e Ismailit a.s. është prej tyre, ndërsa Maria nëna e Ibrahimit djali i Muhamedit a.s. ka qenë prej tyre- pra lidhje e miqësie [vjehrrisë]

Nuk është për t’u habitur se Imam Neveviu e përshkruan këtë hadith në librin “ Rijadu Salihin” në temën “Mirësia ndaj prindërve dhe lidhja farefisnore” duke tërhequr vërejtjen në lidhje farefisnore të cilën ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i tij për të lidhur marrëdhënie në mes të myslimanëve dhe të egjiptasve para se ta pranojnë ata Islamin.

Transmeton Keab bin Malik el Ensari se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: **“Kur të çlirohet Egjipti ju porositni dhe tregonu për koptët se ka të mira dhe dobi prej tyre se ata janë të një gjaku dhe të një fisi”**. Një transmetim tjetër **“ Ju me ta jeni të një fisi dhe të një gjaku”** e ka pasur për qëllim për të treguar se nëna e Ismailit ka qenë prej tyre.

I Dërguari i koptëve u ka dhënë të drejta më shumë se të tjerëve në këtë rastë **“ata kanë paktin me ne myslimanët”**. Kanë marrëveshjen me Allahun dhe të Dërguarin e tij. Kjo pa tjetër duhet ruajtur dhe duhet siguruar. Me ata ka lidhje të gjakut dhe lidhje farefisnore çka me të tjerët nuk ka, sepse Haxherja nëna e Ismailit është arabizuar prej tyre. Dhe Maria, kope ka lindur Ibrahimin me Muhamedin a.s.

XHAMIA DHE POLITIKA

Pyetja:

Dy palë kemi polemizuar shumë, për çështje shumë me rëndësi, e kemi kundërshtuar dhe e kemi kritikuar njëri-tjetrin shumë, njëra palë e argumenton tjetra e mohon, dhe asnjëra nuk mund ta bindë tjetrën.

Dhe dëshirojam që ju dijetar i nderuar për shkak të rëndësisë së çështjes dhe seriozitetit të saj posaçërisht në ditën e sodit të na përgjigjeni:

A lejohet shfrytëzimi i xhamisë për çështje politike?

-Nëse lejohet, cilat janë argumentet?

-Nëse nuk lejohet, cilat janë argumentet?

-Zoti qoftë i kënaqur me përgjigjen tuaj dhe me diturinë tënde t' i sjellni dobi myslimanëve.

Përgjigja:

Xhamia ka qenë qendër e thirrjes islame dhe pallat shtetëror në kohën e Pejgamberit a.s.

Xhamia në kohën e të Dërguarit, Muhamedit a.s. ka qenë qendër e aktiviteteve të tërë shoqërisë islame dhe kurrësi nuk ka qenë vetëm shtëpi [vend] i ibadetit dhe i namazit, por ka qenë xhami e ibadetit, xhami e diturisë [qendër arsimore] qendër e kulturës, parlament për konsultime dhe vendime, vend i njoftimeve. Në xhami kanë qëndruar delegacionet e Gadishullit Arabik, aty është takuar Muhamedi a.s. dhe ka biseduar me ata delegatë. Në xhami Muhamedi a.s. ka mbajtur fjalimet dhe ka dhënë porosi të cilat kanë të bëjnë me të gjitha çështjet e jetës si ato fetare, ashtu edhe ato shoqërore dhe politike.

Në kohën e Muhamedit a.s. nuk ka pasur ndarje në mes të fesë dhe politikës siç e konsiderojnë njerëzit sot, dhe me fjalë të tjera nuk ka pasur vend tjetër për politikë dhe për zgjidhjen e problemeve përpos në xhami për ta që quajtur këtë fe e atë dynja.

Xhamia ka qenë qendër e thirrjes islame dhe pallat shtetëror në kohën e Muhamedit a.s.

Xhamia në kohën e lulëzimit dhe në kohën e vyshkjes.

-Pas Muhamedit a.s. halifet e drejtë xhaminë e kanë pasur për çdo aktivitet politik dhe jopolitik.

Në xhami Ebu Bekri Sidiki e ka mbajtur fjalimin e parë si kryetar shteti ku e ka shpalosur programin e tij politik apo “strategjik” në pushtet; në atë fjalim pos tjerash ka thënë:

“O ju njerëz, unë jam zgjedhur si kryetar [mbrojtës] i juaji edhe pse nuk jam më i miri. Nëse veproj drejt, më përkrahni, nëse nuk veproj drejt, mos më përkrahni”.

Në xhami edhe Omeri r.a. e ka mbajtur fjalimin e parë ku ka thënë:

“O ju njerëz, nëse dikush vëren se diku gaboj, menjëherë le të ma tërheqë vërejtjen ‘’.

-Njëri prej xhematit i cili ka qenë në xhami, ka thënë:

Për Zotin nëse vërejmë te ti ndonjë devijim [nga Islami] do të të drejtojmë edhe me tërë shpatën.

Omeri r.a. e pranoi kritikën dhe tha:

“E falënderoj Allahun, i cili nga shtetasit e tij ka bërë prej atyre të cilët të shtrembëtën e drejtojnë me tërë shpatën”.

Kështu xhamia në shekujt më të mirë të umetit ka lulëzuar dhe ka shkëlqyer e ka shndërritur, ndërsa kur ylli i zhvillimit të islamit u zhduk dhe myslimanët ngecën në çdo çështje, ndryshoi gjendja e myslimanëve dhe u përkufizua e u izolua vetëm në namaz dhe filloi koha e fjalimeve [ligjëratave] të cilave u thuhet fjalime [hutbe, ligjërata] të vdekura për arsye se vetëm lexohen e këndohen si liturgji, dhe me fjalë të thukta, tema të ngushta dhe të përqendruara vetëm në një tematikë: si të jesh asketik në këtë botë, të përkujtohet vdekjen, dënimi në varre, dënimi në botën tjetër.

Për këtë arsye kur u kthye shpirti në trupin e vdekur dhe në njëfarë mënyre jeta iu kthye xhamisë dhe filluan disa hatibe [ligjërues] të flasin për çështjen e myslimanëve në përgjithësi duke i kritikuar disa veprime të padrejta [të mangëta] në jetën e umetit, e posaçërisht devijimin e udhëheqësve kur të fortët i bëjnë të padrejtë të dobët, kur pasanikët pasurohen në kurriz të të varfërve, dhe dijetarët heshtin, për pasivitetin e qeveritarëve disa prej xhematit e disa të tjerë thanë: vërtet Imami [hatibi, ligjëruesi] po hyn në çështje politike.

POLITIKA E LEJUAR DHE POLITIKA E NDALUAR

Nuk e di pse fjalën “politikë” e konsiderojnë thuaja se ajo është mëkat, apo çështje e fëlliqur dhe e urrejtur, kur dihet se politika nga aspekti shkencor konsiderohet një nga shkencat më fisnike dhe më të lavdëruara.

Derisa politika është shkencë, marrja me politikë është prej profesioneve më të lavdëruara dhe prej zanateve më të kërkuara dhe fisnike.

Interesant është kur disa politikanë pyesin: A lejohet që xhamia të jetë për qëllime politike. Ky është iluzion, fantazi e politikës prej këmbëve e deri në kokë.

Politika në esencë nuk është as e urrejtur, as e keqe, nëse është në përputhshmëri me parimet, me ligjet islame dhe me karakterin e tij.

Politika e ndaluar [e papranuar] është politika “mikafilije” (makiaveliste) e cila e parasheh se qëllimi e arsyeton mjetin dhe nuk vepron me rregulla të moralit as të karakterit dhe nuk e shikon a është hallall apo haram.

Ndërsa politika ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së shoqërisë, rregullimin e marrëdhënieve në shoqëri, pengimin dhe largimin e çdo çrregullie, vendosjen e rendit dhe të qetësisë, kjo me fenë është në një binar, me fjalë të tjera është pjesë

e fesë sonë, pse te ne myslimanët feja është: besim dhe ibadet, moral, karakter, rend dhe organizim i jetës në përgjithësi.

Qysh e parasheh Islami i shëndoshë, mesazh i xhamisë është që kurrë për të mos u larguar prej politikës në këtë formë dhe në këtë mënyrë të të kuptuarit.

Xhamia është vend ku diskutohen çështjet e myslimanëve, dhe çdo gjë çka u takon atyre dhe çka u sjell dobi për fenë e tyre dhe për jetën e tyre. Nëpërmjet xhamisë njerëzit e mësojnë të vërtetën, të mirën, vlerën, në të gjitha çështjet e jetës së tyre si ato shpirtërore, kulturore, shoqërore, ekonomike dhe politike.

Kjo bën pjesë në farzet e Islamit siç është “këshillimi” të cilin e ka bërë Muhamedi a.s. për fenë në përgjithësi kur ka thënë: Feja është **“këshillë”**

-E kanë pyetur: Për kë o i Dërguari i Allahut?

-Është përgjigjur: **“[këshillë] për Allahun, për të Dërguarin e tij, për librin e tij për umetin mysliman dhe çdo gjë çka ka të bëjë me ta”**.

Kjo është prej porosive për të drejtën dhe për durim kur Kur’ani e ka bërë kusht të fitimit dhe të triumfit ndaj dështimit në këtë botë dhe në botën tjetër.

“Pasha kohën”

Vërtet njeriu është në humbje.

Përpos atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe porositin për të drejtën dhe porositin për durim.

SURETUL ASR

Kur’ani e ka bërë prej cilësive themelore të besimtarëve dhe besimtareve:

“Besimtarët dhe besimtares janë miq të njëri-tjetrit, urdhërojnë në punë të mira dhe largojnë nga veprat e këqija, falin namazin, japin zekatin, e dëgjojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij; ata i mëshiron Allahu”.

SURETUL TEVBE 71

Shikoni në renditje: përpara përmendet farzi i urdhërimit në punë të mira dhe largimi nga veprat e këqija, pastaj namazi dhe zekati. E dini çka është namazi dhe zekati, prej shtyllave të Islamit që tregon për rëndësinë e atij farzi.

Ndërsa na ka lajmëruar se do të jemi të mallkuar nëse e lëmë këtë farz të madh siç e kanë lënë popujt e mëhershëm.

“Janë mallkuar ata të cilët e kanë mohuar prej beni israilëve prej Davudit dhe Isës, djalit të Merjemes. Për arsye se kanë gabuar dhe i kanë tejkaluar kufijtë. Kanë qenë prej atyre që nuk i kanë ndaluar nga veprimet e këqija[kur të tjerët kanë vepruar] [indiferenca e tyre] shumë keq kanë vepruar.

Nëpërmjet “këshillimit” porosisë për drejtësi, urdhërimit në punë të mira dhe largimit nga punët e këqija, patjetër xhamia duhet ta luajë rolin e saj në orientimin e politikës së umetit në përgjithësi, progresivitetin e çështjeve të umetit, dhe vizionin e qartë për të mos rënë ne grackë të armiqve të saj.

Si në të kaluarën ashtu edhe sot xhamia ka luajtur rol në nxitjen e xhihadit në rrugën e Allahut dhe revolucionin kundër okupatorëve.

Po ashtu revolucionin në Palestinë ka buruar prej xhamive, dhe thirrjet e para janë bërë prej minareve të xhamive; për këtë arsye edhe në fillim është quajtur revolucion i xhamive.

Xhamitë kanë luajt rol edhe në Afganistan kundër Rusisë dhe në çdo luftë ndaj okupatorit tjetër ngado që ka qenë.

Më kujtohet kur në vitin 1956 u sulmua Egjipti, Ministria e vakëfeve në krye me ministrin Ahmed Bakuri më ftuan për të mbajtur fjalim [ligjëratë] të xhumasë në njërën prej xhamive kryesore në Kajro me qëllim të forcimit të moralit shpirtëror tek njerëzit, edhe pse në atë kohë [më herët] e kisha të ndaluar të mbaj hytbe [ligjërata] për të mësuar të tjerët, dhe çdo çështje tjetër dhe çdo aktivitet në popull. Mirëpo domosdoshmëria i detyroi ata që të më thërrasin për të mbajtur fjalim në xhami.

Ministritë e vakëfeve, dhe të xhamive aty këtu kërkojnë nga hatibat të mbajnë ligjërata të caktuara, të cilat i parasheh shteti për realizimin e qëllimit të tij dhe politikës së tij si p.sh.; mos harxhimi i tepërt i artikujve, apo i shërbimeve deficitare, lufta kundër terrorizmit, kundër ekstremizmit, ose thirrja në unitet gjithëkombëtar, ose lufta kundër narkomanisë etj.etj., të cilat kanë të bëjnë me politikën.

Pra: Cilat janë qëllimet politike dhe cili është qëllimi i pyetjes në këtë rast?

“Pyetja e parashtruar nënkupton politikën e cila ka të bëjë me opozitën ndaj pozitës [partisë në pushtet]”.

Unë mendoj se nuk është e ndaluar [në tërësi] por as e lejuar në tërësi.

Ajo çka është e ndaluar është adresimi i individëve të caktuar apo personave në mënyrë rigoroze, duke i kritikuar, apo duke i popullarizuar. Minberi nuk duhet të shfrytëzohet për këso çështje. Nuk duhet trasuar rrugën e fanatizmit partiak dhe të urrejtjes.

Por duhet kundërshtuar secilin i cili është në kundërshtim me sheriatin, edhe nëse është politikë e shtetit, sepse xhamia është ndërtuar për t’u përkrahur ligji [sheriati] i Allahut, e jo për t’u përkrahur politika e ndonjë qeverie të caktuar [edhe nëse është në pushtet].

Nëse pushteti e kundërshton ligjin [sheriatin] e Allahut , xhamia duhet të rreshtohet në rreshtin e ligjit [sheriatis] të Allahut e jo të rreshtohet në rreshtin e pushtetit [qeverisë].

Në asnjë rast nuk lejohet për ta ndaluar xhaminë nga kjo e drejtë natyrore, logjike, morale dhe historike. Duhet zgjuar popullin dhe duhet tërhequr vërejtjen për mizorët, të cilët e paralizojnë ligjin e Allahut dhe qeverisin me ligje për qëllime të epsheve të tyre, ose të funksionarëve, të cilët kanë interesa personale, pse prej tyre nuk ka dobi pasi që veprojnë të pavarur ndaj ligjit të Allahut.

Në disa vende islame qeveritë kanë vendosur ligj i cili është në kundërshtim me ligjin e sheriatis islam sa i përket statusit personal, ligjit në familje. Dijetarët e kanë kundërshtuar, e kanë thënë haptazi nëpër xhamia, sepse nuk ka ligj më të mirë se ligji i Allahut. Ndërsa fatkeqësisht të gjitha mjetet e informimeve të tjera janë mjete në shërbim të shtetit. Ndërsa pushteti mizor nuk ka vepruar asgjë tjetër përpos i ka dënuar me ekzekutim ata dijetarë ose edhe i ka djegur në zjarr. Kështu ka ndodhur në Somali.

Organet shtetërore dëshirojnë ta shfrytëzojnë xhaminë për qëllime politike marrëveshjen me Izraelin, duke argumentuar me ajetin: marrëveshja është e dobishme.

“Nëse anojnë ka paqja ti përkrahe [ano edhe ti ka paqja] dhe mbështetju Allahut”.

SURETUL ENFAL

Edhe pse marrëdhëniet me Izraelin nuk janë të mira, jahuditë janë armiq të më të mëdhenj të besimtarëve, ndërsa marrëveshja me armikun okupator është haram, e ndaluar dhe tradhti.

Kështu minberi nuk e ka zërin e arsyes dhe porosisë islame por është mjet në shërbim të politikës së pushtetit, dhe kështu xhamia e humb origjinalitetin e vet, nuk mund të ketë ndikim në popull dhe shkelet autoriteti i dijetarëve dhe thirrësve islamë.

E lusim Allahun për të mira në këtë botë dhe në botën tjetër.

FEJA DHE LIRITË E NJERIUT

Pyetja;

Çfarë qëndrimi ka Islami ndaj lirisë. Disa të rinj mendojnë se Islami është kundër lirisë. Cila është liria të cilën e lejon Islami dhe cilët janë kufijtë e asaj lirie?

Përgjigjja:

Islami ka ardhur dhe e ka vendosur parimin e lirisë. Omeri r.a. e ka thënë fjalën e njohur: *“Deri kur do t’i robëroni njerëzit kurse nënat e tyre i kanë lindur të lirë”*.

Aliu r.a. ka porositur: *“Mos u bën rob i askujt se Allahu të ka krijuar të lirë”*.

Esenciale është se me ligjin e Allahut njerëzit janë të lirë, edhe nga aspekti natyror janë të lirë, por edhe nga aspekti i lindjeve ata lindin të lirë; ata janë të lirë, e kanë të drejtën e lirisë, nuk janë robër. Islami e ka vendosur ligjin e lirisë në kohën kur njerëzit kanë qenë robër. Nuk kanë pasur as liri të mendimit, as liri politike, as liri shoqërore, as liri fetare, as liri ekonomike. Ndërsa Islami u ka dhënë pastaj lirinë e besimit, lirinë e mendimit, lirinë e fjalës, lirinë e kritikës. Çështja më e rëndësishme, të cilën e kërkojnë njerëzit dhe Islami e ka sjellë, është liria e fesë dhe e besimit. Asnjëherë nuk e ka lejuar për t’i detyruar njerëzit ta përqafojnë fenë e tij apo pranimin e feve të tjera. Këtë e ka thënë Zoti i Madhëruar në Kur’an:

“A ti po i detyron njerëzit derisa të bëhen besimtarë. Po të kishte dashur Allahu do të kishin besuar çka ka në tokë të gjithë së bashku”.

SURETU JUNUS 69

Ky ajet ka zbritur në Meke.

Ndërsa në Medine zbret ajeti tjetër:

“Nuk ka dhunë në fe, është sqaruar rruga e vërtetë nga e shtrembëta.

SURETUL BEKARE 256

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti Kur'anor na tregon qartë se sa të shenjtë e konsideron Islami lirinë, sa e respekton këtë fjalë dhe sa e përkrah këtë parim. Në kohën e injorancës fisi evs dhe hazrexh e kanë bërë traditë nëse gruaja nuk mbetej shtatzënë i thoshin se nëse lind fëmijë do ta bëjë jehudi.

Kështu nga mesi i këtyre dy fiseve arabe u bënë disa prej fëmijëve të tyre jahudi. Kur erdhi Islami, Zoti e plotësoi fenë islame dhe e përforcoi, e fisnikëroi. Disa prej prindërve dëshironin që fëmijët e tyre të ktheheshin në Islam me dhunë, duke i nxjerrë prej fesë jehude. Për kundër shkaqeve se si kanë hyrë në fenë jehude, për kundër luftës të myslimanëve dhe jahudive nuk ka lejuar Islami asnjërin që me dhunë të kthehet prej fesë jehude në fenë islame, apo edhe në ndonjë fe tjetër.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Nuk ka dhunë në fe”.

SURETUL BEKARE 256

Dhe kjo ka qenë kur Perandoria Bizantine thoshte; “Ose bëhu i krishterë ose do të vritesh”, ndërsa persianët ishin në fenë e tyre.

Parimi i lirisë nuk ka qenë rezultat i zhvillimit shoqëror apo revolucion i cili e ka kërkuar atë, apo pjekurinë e shkallës njerëzore, por ka qenë parim kryesor i shoqërisë [Islame] në atë kohë.

Ky parim ka ardhur prej qiellit për t'i ngritur lart banorët e tokës. Islami ka ardhur me njeriun duke e vendosur këtë parim: parimin e lirisë së besimit, lirisë së fesë. Mirëpo këtë parim, të cilin e ka vendosur Islami, e ka kushtëzuar për të mos u bërë lojë në duar të njerëzve, sikur kanë thënë jahuditë:

“Besoni në atë çka ka zbritur gjatë ditës, dhe mohone tjetrën me qëllim që të kthehen [prej fesë së tyre]”.

SURETU ALL IMRAN 72

Besoni në mëngjes, ndërsa mos besoni në fund të ditës, në mbrëmje, pse në fenë e Muhamedit a.s. keni gjet këtë e atë. Për këtë arsye e keni lënë, ose kanë besuar sot kanë mohuar nesër, ose pas një jave. E kanë keqpërdorur këtë fe të re. Zoti i madhëruar nuk dëshiron që të luhet me këtë fe, apo këtë fe për ta konsideruar lodër. Kush e pranon Islamin pasi që e kupton dhe e vërteton, duhet të qëndrojë në të ose në të kundërtën dënohet me dënimin e “tradhtisë fetare”. Liria e parë ka qenë liri e fesë dhe e besimit.

Sa i përket lirisë së dytë: liria e ideve dhe e mendimeve Islami i fton njerëzit të vështrojnë gjithësinë, dhe të mendojnë.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Vërtet ju këshilloj në një çështje: të qëndroni në rrugën e Allahut me sinqeritet dy nga dy ose një nga një e pastaj për të logjikuar, e për të menduar mire”.

“Thuah shikoni e vështrohi çka ka në qiell dhe në tokë”.
SURETUL SEBEE 130

“A nuk po udhëtojnë në tokë dhe t’i kanë zemrat [mendjet] me të cilat logjikojnë, ose veshët për të dëgjuar me ta. Vërtet ata nuk i kanë të verbët sytë, por të verbëta i kanë zemrat në gjokset e tyre”

SURETUL HAXH 46

Islami u ka bërë kritikë të ashpër atyre të cilët i pasojnë mendimet e verbëta dhe iluzionet. Zoti i Madhëruar thotë:

“Vërtet paragjykimi nuk ka asgjë të përbashkët me realitetin dhe të vërtetën”.

SURETUL NEXHM 27

Njësoj i kritikon ata të cilët i pasojnë epshet dhe emocionet edhe ata të cilët i pasojnë traditat e prindërve [verbërisht] ose i pasojnë traditat e udhëheqësve dhe prijësve [verbërisht]; u ka tërhequr vërejtjen dhe i ka gjykuar ata se do të thonë ditën e Kiametit:

“Vërtet ne dëgjuam udhëheqësit tanë dhe prijësit tanë dhe na kanë humbur rrugën”

SURETUL AHZAB 67

I ka kritikuar ata të cilët thonë: Ne kështu i kemi gjetur prindërit tanë dhe ne mbështetemi tragjeve të tyre. Dhe i ka bërë si kafshë por edhe më keq, i ka kritikuar tradicionalistët e ngurtë dhe ka apeluar për lirinë e mendimit, përdorimin e mendjes dhe përpunimin e ideve. I ka ftuar njerëzit duke u thënë: **“Bini argumentet tuaja nëse [flitni] të vërtetën.**

SURETUL BEKARE 111

Islami është mbështetur në argumente mendore në vërtetimin e besimit; për këtë Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vërtet mendja e shëndoshë është bazë për argumentin e tekstit [Kur’anor dhe sunetit] të shëndoshë”.

Pra , mendja është bazë argumentimi p.sh. çështja e ekzistimit të Allahut vërtetohet me argumente logjike; çështja e pejgamberllëkut të Muhamedit a.s. vërtetohet me argumente të mendjes [logjikës] në rend të parë. Logjika është ajo e cila thotë : Ky është pejgamber.

Ka argumente për vërtetësinë e tij: ka sjellë mrekulli mbinatyrore që kanë dëshmuar për pejgamberllëkun e tij.

Mendja thotë: Ai është rrenacak, ai tjetri dexhall pse nuk ka argumente, nuk ka mrekulli mbinatyrore. Pra kjo është ajo pse Islami e respekton logjikën dhe mendimin.

Nga këtu, në Islam është paraqitur rezultati i mendimit si liri e diturisë dhe shkencës; shohim se si dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme, e kanë konsideruar gabim njëri-tjetrin, e kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe asnjëri nuk sheh në këtë ndonjë mendim. Shohim pasues të një libri Muetezil, Sunij. Tefsiri

“Keshaf” i Imamat Zamahsheri është i Muetezileve mirëpo sunijet shërbejnë me të dhe nuk shohin kurrfarë pengese për të. Ajo çka sunijet apo dijetarët sunijë veprojnë dhe shtojnë, argumentojnë dhe komentojnë dhe kështu përfitojnë prej njëri-tjetrit. Siç është rasti i Ibni Munirit i cili shkruan komentin “Vërtetësia prej Keshafit ‘’ ose Hafidhi Ibën Haxher shkruan librin Kafi Shafi fi Tahrih Ehadith Eshafi”. Me mendimin e disave ne kemi pa edhe mendimet e ndryshme të fukahave, dhe gjerësinë e zemrave të tyre në kundërshtimet mes vete. E tërë kjo tregon lirinë e mendimit dhe të ideve, lirinë e diturisë dhe të shkencës në umetin Islam.

Edhe lirinë e fjalës dhe të kritikës e ka lejuar Islami, përpos kësaj i ka dhënë të drejtë edhe më të madhe fjalës dhe kritikës nëse është çështja e interesit gjithëkombëtar [umetit] dhe interesi i moralit dhe karakterit dhe e ka bërë obligim për ta thënë të vërtetën për të mos iu frikuar ditës së polemikës kur është e drejta e Allahut: për të urdhëruar në të mira , për të ndaluar nga e keqja, për të thirrur për drejtësi. Për t’i thënë të drejtë drejt e ke, të padrejtë keq e ke. Dhe kjo e drejtë kalon prej të drejtës në obligim [vaxhib] individual nëse nuk ka tjetër i cili nuk e kryen atë vaxhib. Nëse heshtja jote i sjellë dëme popullit [umetit] ose shkakton çrregulli, atëherë vaxhib e ke për ta thënë të vërtetën pa u frikuar se çka mundet të ndodhë. Zoti i Madhëruar thotë:

“Urdhëro në punë të mira dhe largo nga punët e këqija dhe ji i durueshëm me atë çka të ndodhë. Vërtet këto janë çështje parimore”.

SURETUL LUKMAN

Kjo është çka kërkon Islami. Në islam nuk lejohet për t’i fshehur as frymëmarrjet e njerëzve, e as për t’i mbyllur gojët e njerëzve dhe për të mos i lejuar të flasin përpos me leje, dhe për të mos besuar për veten me leje. Siç ishte rasti me magjistarët kur kanë thënë: “Keni besuar para se të merrni leje”; kanë dëshiruar që të mos besojnë njerëzit pa lejen e tyre. Dhe të mos falen njerëzit, përveçse me lejen e udhëheqësit ose me lejen e organeve të larta shtetërore. Ka ardhur Islami dhe ka lejuar njerëzit për të menduar , përpos kësaj, i ka urdhëruar njerëzit për të menduar dhe i ka lejuar që të besojnë në atë çka e shohin të drejtë. E ka obliguar ithtarit e besimit për ta mbrojtur besimin e tij nëse është nevoja edhe me armë. I ka urdhëruar myslimanët për ta mbrojtur lirinë e besimit dhe për të mos shkaktuar fitne [çrregulli] dhe të jetë feja e Allahut në përgjithësi dhe me të shpatës apo me armë të mbrohet ajo e drejtë dhe liri. Islami e ka ndaluar dëbimin masiv për të mos ndodhur fitne [çrregulli] d.m.th. për të mos e dhunuar askënd në besimin e tij ose në fenë e tij. Zoti i madhëruar në ajetin e parë i cili ka zbritur nga ligjësimi i luftës dhe i xhihadit në Islam ka thënë:

“Ju është lejuar atyre të cilët luftojnë [lufta] pse atyre iu është bërë krim dhe padrejtësi ; Pastaj vazhdon:

“Po mos të ishte që Allahu të lejonte për t’u mbrojtur ndaj njëri-tjetrit [nga krimi, dhe padrejtësia] do të shkatërroheshin sinagogat, kishat dhe xhamitë në të cilat përkujtohet shumë emri i Allahut.”

Po mos ta kishte kushtëzuar Allahu që besimtarët myslimanë të mbrojnë lirinë dhe të drejtat e tyre, askush në botë nuk do të kishte mundësi për ta adhuruar Allahun. Nuk do të ishte në këmbë asnjë kishë, asnjë sinagogë, asnjë xhami dhe asnjë vend tjetër ku adhurohet Allahu. Ky është Islami, i cili ka ardhur me këto liri dhe të drejta. Ka ardhur me liri, por me liri të së drejtës e jo me liri të mosbesimit dhe të shkatërrimit. Jo lirinë të cilën e thanë të tjerët dhe siç e quajnë “Liri personale” si lirinë e prostitucionit, lirinë e pirjes së alkoolit ose për të bërë krime e gabime të mëdha kur të dëshirojnë. Pastaj në çështjet të tjera të cilat kanë të bëjnë me interesin gjithëkombëtar” nuk ka liri aty”. Mos kritiko, mos thuaj atë që e s’beson . Mos i thuaj të padrejtimit mirë e ke; Mos i thuaj të drejtimit keq e ke, Jo, kurrësi jo . Vërtet ti atëherë ke liri personale , lirinë e shkatërrimit të vetes , shkatërrimit të moralit, shkatërrimit të karakterit, shkatërrimit të adhurimit tënd, shkatërrimit të familjes tënde. Ti ke liri në të . Nëse liria e ka këtë domethënie Islami nuk lejon këtë liri, pse ajo është liri e shkatërrimit jo liri e të drejtës . Islami e lejon lirinë e mendimit dhe të diturisë , lirinë e ideve , lirinë e fjalës, lirinë e kritikës dhe lirinë e fesë. Këto janë liri të cilat e mbajnë jetën . Lirinë e marrëveshjeve dhe veprimtarive me të cilat nuk e dëmton askënd. Lirinë e pronësisë me kushte të nxjerra me ligj, pa e dëmtuar askënd dhe pa u dëmtuar vetë. Kjo është edhe rregull e Islamit **“Mos dëmto dhe mos lejo për t’u dëmtuar ”**.

Çfarë lirie kërkojnë kur ajo e dëmton vetveten ose tjetrin? Kjo duhet të pengohet, dhe të kushtëzohet pse liria jote përfundon aty ku fillon liria e tjetrit . Ndërsa ti të kërkojë që ta shkelësh lirinë e tjetrit, këtë nuk e lejon askush .Ti ke liri për të qarkulluar në rrugë, por duke iu përmbajtur rregullave të qarkullimit, për të mos u shkakuar fatkeqësi të tjerëve. Ky është kushtëzim i lirisë tënde: për t’u ndalur në dritën e kuqe, për të shkuar në anën e djathtë etj. Këto janë rregulla të dobisë së përgjithshme. Çdo fe dhe çdo sistem pa tjetër duhet t’i ketë këto rregulla dhe kushtëzime. Në këtë formë ka ardhur edhe Islami. Dhe kjo është më e mira çka kërkon dhe i nevojitet njerëzimit.

NGA POROSITË E KUR'ANIT

Pyetje:

Ju lutem na shpjegoni ajetet Kur'anore të sures Isra.

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk di pse: për të dëgjuarit, të pamurit dhe për zemrën; për të gjitha këto me siguri ka përgjigje. Mos ec mendjemadh nëpër tokë, sepse ti tokën nuk mund ta çash e as t'i arrish malet e larta”.

SURETUL ISRA 35-36

Përgjigje:

Këto dy ajete fisnike janë porosi të urta të cilat Zoti i Madhëruar i ka këshilluar robët e tij në suretull Isra.

“Mos t'i qasesh asaj për të cilën nuk ke dituri pse të dëgjuarit, të pamurit, zemra për të gjitha këto me siguri ka përgjigje. Mos ec mendjemadh nëpër tokë sepse ti tokën nuk mund ta çash e as t'i arrish malet e larta”.

SURETUL ISRA 35-36

Në ajetin e parë Kur'ani përshkruan edukimin arsimor dhe shkencor të myslimanit. Ne kemi dy lloje të mendimeve.

-Mendimet destruktive - të cilat u besojnë iluzioneve, shkojnë pas injorancës, çka do që flitet e dëgjojnë dhe e pranojnë pa logjikë të shëndoshë.

Këtë lloj të mendimit e refuzon Islami.

-Mendimet e tjera - të cilat i kërkon Islami, mendimet logjike të cilat prahen me argumente dhe i nënshtrohen intelektit dhe logjikës, dhe shkojnë pas vërejtjeve dhe përvojës në materie dhe i përdorin mjetet të cilat ua ka dhuruar Zoti- e ato mjete janë: dëgjimi, shikimi dhe zemra. Këto janë mjetet e diturisë siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Allahu ju ka nxjerrë nga barqet e nënave tuaja kur nuk keni ditur asgjë, ju ka dhënë juve dëgjimin, shikimet dhe zemrat me qëllim që të jeni mirënjohës”.

SURETU NAHL 78

Dëgjimi - Nga këtu njeriu duhet të përdorë dëgjimin si mjet, pse në të kalojnë njohuritë në mes të njerëzve nëpërmjet të transmetimeve.

Shikimi - Me të vijnë vërejtjet dhe përvojat, me të zhvillohen shkencat e gjithësisë.

Zemra - d.m.th. mendja, me të njeriu e përdor logjikën e tij dhe nxjerr rezultate përfundimtare [teorema] për të ardhmen.

Këto janë mjetet-dritaret me të cilat njeriu i nxjerr krijesat e Allahut, urdhëresat e Allahut dhe ndalesat e tij.

Pra nuk lejohet për t'i paralizuar dhe për t'i lënë të pashfrytëzuara e për t'i pasuar iluzionet, paragjykimet ose për të pasuar çdo gjë që thuhet dhe çka do që thuhet. Për këtë kemi shumë ajete në Kur'an

“ A nuk po dëgjoni “

“ A nuk po shihni “

“ A nuk po logjikoni “

Ka dallim të madh në mes të besimtarëve të udhëzuar dhe pabesimtarëve të humbur, sepse të tjerët i kanë paralizuar mjetet e njohurisë dhe të udhëzimit të cilat i kanë pasur në disponim si dhuratë. Ata nuk e kryejnë punën e tyre: **“Ata kanë zemra por nuk kuptojnë me to. Ata kanë sy por nuk shohin me ta. Ata kanë veshë por nuk dëgjojnë me ta. Ata janë si kafshë, por edhe më të humbur se kafshët. Ata janë të paditur”.**

SURETUL EARAF

Për këtë arsye ajeti tërheq vërejtjen për mospërdorimin e këtyre dhuntive. Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos iu qas asaj për çka nuk ke dituri”

SURETUL ISRA 36

D.m.th. mos paso atë çka nuk e di dhe shkon pas iluzioneve, pas paragjyqimeve dhe pas destrukcioneve, por përdore dëgjimin tënd, shikimin tënd dhe zemrën tënde.

Vërtet Allahu do të të pyesë dhe do të japish përgjigje për këto mjete. **“Vërtet dëgjimi, shikimi dhe zemra për të gjitha këto ke për të dhënë përgjegjësi”.**

SURETUL ISRA 35

Ky ajet në pika të shkurta ka këtë kuptim, ndërsa sa i përket ajetit tjetër; “Mos ec mendjemadh nëpër tokë, sepse ti tokën nuk munda ta çash, e as t’i arrish malet e larta”, ka domethënie: Mos ec mendjemadh në tokë, me kryelartësi, me arrogancë, me vrazhdësi se kjo nuk i takon besimtarit pse ajo ecje nuk është e robërve të Gjithëmëshirshmit. Pse Allahu ka cilësuar se robërit e Allahut **“Ecin nëpër tokë të qetë dhe modest”**

SURETUL FURKAN 63

Pse ec me arrogancë

A mund ta qashë tokën

Sado që i mëshon fort tokës me këmbët tua nuk mund ta bësh atë.

Sado që e zgjat qafën dhe sado që e ngrit kokën nuk mund të arrish lartësinë e maleve.

Më mirë pra ec modest, i qetë, me butësi dhe me përlulshmëri.

Mos ec në tokë ndryshe por vetëm i qetë

Sa janë nën të e kanë qenë më kryelartë se ti

Nëse je i fuqishëm, i pashëm dhe nuk ta kalon askush

Sa e sa kanë vdekur si ti të cilët ta kanë tejkaluar.

Nga njeriu kërkohet të ecë modest, pa marrë parasysh a është në këmbë apo në automjet.

Disa njerëz pse kanë automjete të shtrenjta dhe luksoze dëshirojnë që automjetin ta vozisin të shfrenuar. Nuk i respektojnë rregullat e komunikacionit as të shpejtësisë; ata sikur dëshirojnë të shkelin çka do që kanë përpara apo dëshirojnë të fluturojnë pa flatra.

Kush vepron ashtu, ai ka ecur në tokë si mendjemadh jo i qetë, për këtë arsye pjesa më e madhe e fatkeqësive të komunikacionit ndodhin për shkak të shpejtësisë dhe mendjemadhësisë.

Myslimani i cili edukohet me etikën e Allahut duhet të ketë parasysh këtë, të ecë me kujdes, i qetë e jo me arrogancë dhe kryelartësi. Muhamedi a.s. thotë: **“Kush e zmadhon veten e tij dhe ec me kryelartësi kur do ta takojë Allahun do të jetë i hidhëruar në të”**.

Ajeti i lartpërmendur është përsëritur edhe në porositë e Llukmanit drejtuar birit të tij: **Mos ia kthe fytyrën njerëzve dhe mos ec me kryelartësi. Vërtet Allahu nuk e do çdo kryelartë dhe arrogant.**

SURETUL LLUKMAN 18

FORMIMI I KOALICIONIT TË QEVERISË ME PARTINË JOISLAME

Pyetje:

A lejohet për myslimanin e sinqertë apo shoqërinë e sinqertë të myslimanëve për të hyrë në koalicion me qeverinë joislame. Pa marrë parasysh ai shtet a është qytetar apo ushtarak, mbretëror apo republikan, demokratik apo diktatorial, liberal apo socialist, sekularist apo i fshehur nën petkun e fesë apo ashtu e kështu. Koalicionet në qeveri kanë për qëllim formimin e qeverisë d.m.th. për t'i marrë disa përgjegjësi politike si p.sh. pozitën e kryeministrit, apo pozitën e kryetarit të kuvendit apo ndonjë pozitë në kuadër të politikës shtetërore.

Për këtë çështje janë kundërshtuar myslimanët mes vete, disa e lejojnë të tjerët e ndalojnë. Edhe dijetarët kanë dhënë fetva të ndryshme: disa thonë është e ndaluar, disa është e lejuar. Shpresojmë se do të na sqaroni këtë.

Çështja është tepër serioze dhe shumë e rëndësishme, për këtë arsye kërkohet sqarim për ta ndriçuar rrugën për atë që dëshirojnë ta zgjedhin [nëse u jepet rasti] dhe ata të cilët janë të dyshimtë, posaçërisht në disa shtete islame ku kanë hyrë në koalicion për formimin e qeverisë në vendet e tyre si në Jemen dhe Jordani e në fund edhe në Turqi. Sa i përket Turqisë ajo është sekulariste, pa dyshim. Ndërsa Jemeni është sekularist, por sa i përket kushtetutës islame ajo është më afër ligjit islam.

Këta myslimanë e kanë humbur rrugën e tyre apo ata janë munduar për ta gjetur të drejtën, por kanë gabuar ose ia kanë qëlluar. Kemi parasysh se kjo çështje është çështje e “ixhtihadit” apo çështje që është e ndaluar dhe nuk kërkon analizë të gjerë dhe “ixhtihad” sikur pretendojnë disa myslimanë të sinqertë, të cilët janë tepër të bindur në atë çka e thonë dhe janë tepër rigoroz ndaj atyre të cilët nuk e pranojnë filozofinë e tyre, të cilët sot jo por nesër apo ndonjëherë tjetër do të jenë tepër ekstrem.

Shpresoj se nuk do të përtoni të na shpjegoni këtë çështje me argumente të qarta të sheriatit dhe me diturinë që ju ka dhënë Zoti. Zoti ju shpërbleftë juve dhe neve dhe gjithë myslimanët me shpërblimin që i jep dijetarëve të sinqertë.

ESENCIALE PËR TË MOS HYRË NE KOALICION

Përgjigje:

Nuk ka dyshim se sa i përket kësaj çështjeje esenciale është për myslimanin për të mos bashkqeverisur në qeverinë e cila nuk e praktikon ligjin e Allahut në postet e rëndësishme si në postet kyçe në kuvend apo ministri dhe për të mos kundërshtuar asnjë urdhër të Allahut dhe të Dërguarit të tij, sepse duhet për t'iu nënshtruar vetëm ligjit të Allahut dhe çka obligon besimi në Allahun siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Nuk ka të drejtë asnjë besimtar e as besimtare që kur Allahu dhe i Dërguari i tij caktojnë ndonjë urdhër të zgjedhin për të vepruar sipas dëshirës së tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e tij ai ka humbur definitivisht në humbje të sigurt”

SURETUL AHZAB 36

Në ajet tjetër Zoti i Madhëruar ka thënë:

“Le të kenë kujdes ata të cilët largohen nga urdhrat e Tij që të mos u ndodhë pastaj çrregulli [anomali] dhe fitne ose t' i kaplojë ndonjë dënim i dhimbshëm”

SURETU NUR 63

Kur të jetë qeveria joislame d.m.th. nuk e praktikon ligjin e sheriatit islam dhe ligjet të cilat kanë të bëjnë me jetën e përditshme si: juridike, edukative, kulturore, informative, ekonomike, politike dhe shtetërore, por bazohet në burime të tjera joislame, të cilat e kanë prejardhjen prej Lindjes apo Perëndimit, prej djathtistëve apo majtistëve prej filozofive liberale apo socialiste marksiste etj.etj. ose p.sh. disa burime të sheriatit i merr si bazë por burimeve të tjera i jep përparësi nga ligjet e prera dhe të qarta islame, të gjitha këto janë të papranuara në Islam, i cili obligon të mos qeveriset tjetër, vetëm se në atë çka ka zbritur Allahu. Nuk lejohet që disa ligje të praktikohen e të tjerat të refuzohen. Siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Dhe le të gjykojnë mes vete çka iu ka zbritur prej Allahut dhe mos të pasojnë epshet e tyre dhe tërheqja vërejtjen që mos të tentojnë të largojnë [të bëjnë fitne] nga disa [ligje] çka të ka zbritur Allahu ty. Nëse e kthejnë shpinën, ta dish se Allahu dëshiron t' i dënojë për shkak të disa gabimeve të tyre dhe shumica e njerëzve janë gabimtarë”.

SURETUL MAIDE 49

Kur'ani në mënyrë rigoroze ka qortuar beni israilët të cilët disa urdhra prej librit të tyre i kanë pranuar, të tjerat i kanë refuzuar. Thotë Zoti i Madhëruar:

“A po besoni në disa pjesë të librit dhe i mohoni disa pjesë të tjera. Kush vepron kështu, nuk ka dënim tjetër për të përpos nënçmim dhe poshtërim në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të hidhen edhe në dënim më të ashpër. Allahu nuk është indiferent në atë çka veprojnë. Ata janë të cilët e kanë shitur botën tjetër për këtë dunja, për këtë as nuk do t’ u lehtësohet dënimi as nuk do të ndihmohen”. SURETUL BEKARE 85-86

Nëse kryetari i shtetit është përgjegjës i parë nga ky devijim pa marrë parasysh a është mbret, premier apo komandant i forcave të armatosura, ata të cilët e përkrahin dhe i ndihmojnë në këtë do të jenë bashkëfajtorë në dënim aq sa e përkrahin dhe i ndihmojnë. Kur’ani ushtrinë e firaunit e ka barazuar në gabim me firaunin dhe i ka dënuar njësoj si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër, siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Vërtet, firauni, Hamani dhe ushtritë e tyre kanë qenë mëkatarë”.

SURETUL KASAS 8

Zoti i Madhëruar thotë:

“E kemi dënuar atë dhe ushtrinë e tij e i kemi hedhur në det, shiko pra si ka qenë dënimi i mizorëve dhe i kemi bërë një popull që nga zjarri në ditën e kijametit do të thërrasin për ndihmë, por nuk do t’u ndihmohet atyre, ndërsa në këtë botë i përcjell vetëm mallkimi, e po ashtu edhe në ditën e kijametit do të jenë të nënçmuar”

SURETUL KASAS 40-42

Kur’ani i bën bashkëfajtorë popujt të cilët i kanë pasuar udhëheqësit e tyre mizorë dhe kriminelë dhe njësoj edhe ata janë mëkatarë dhe njësoj do të dënohen.

Kur’ani e ka kritikuar popullin e Nuhut:

“Tha Nuhu; “ O Zoti im ata më kundërshtuan mua dhe dëgjuan atë i cili pasurisë së tyre dhe pasardhësve të tyre u shtojnë humbje të madhe”.

SURETU NUH 21

E ka kritikuar adin, popullin e Hudit.

“Dhe ky ka qenë adi që i ka mohuar argumentet e Zotit të tyre dhe ka kundërshtuar të dërguarin e Allahut, ndërsa kanë pasuar çdo urdhër të arrogantit kokëfortë”.

SURETU HUD 59

E ka kritikuar firaunin:

“Dhe kanë pasuar urdhrat e firaunit, ndërsa firauni nuk ka urdhëruar në rrugë të drejtë. I prin popullit të tij në ditën e kijametit deri në zjarr, po në çfarë vendi të keq do t’i sjellë ai”.

SURETU HUD 97-98

Në një sure tjetër thotë Zoti i Madhëruar:

“E ka frikuar popullin e tij dhe e kanë dëgjuar atë, vërtet ata kanë qenë shkatërrimtarë dhe mëkatarë”

SURETU ZUHRUF 54

Çdo veprim apo çdo shërbim e përkrahje i bëhet firaunëve apo mizorëve konsiderohet mëkat në aspekt të sheriatit, pse sheriatu urdhëron të përkrahet dhe

të ndihmohet në punë të mira dhe ka ndaluar të ndihmohet dhe të përkrahet në punë të këqija, mëkate e armiqësi siç thotë Zoti i Madhëruar:

Ndihmoni njëri tjetrin në punë të mira e mos ndihmoni njëri tjetrin në punë të këqija dhe armiqësi.

SURETU MAIDE 2

Ndihma në punë të mira dhe devotshmëri ka shkallë dhe kategori, sikurse edhe puna në punë të këqija dhe armiqësi ka shkallë dhe kategori:

Zoti i Madhëruar thotë:

Mos mbështetni, mos pëlqeni dhe mos anoni nga ata të cilët kanë bërë mizori se do të ju kaplojë zjarri e pastaj nuk do të mund të gjeni mbrojtës përpos Allahut e pastaj nuk do t'ju ndihmojë”.

SURETUL HUD 113

Në këtë ajet fjala “mbështetje” ka për qëllim “anim”. Kurrësi nuk lejohet për myslimanin që të pëlqejë apo dëshirat e tij të jenë me kriminelët se i kaplon zjarri dhe e humb mbrojtjen prej Allahut dhe ndihmën e tij. E çka do të bëhej nëse ndihmohet fizikisht dhe materialisht.

Disa prej të parëve në këtë çështje kanë qenë tepër rigorozë.

PËR NEVOJA TË SHERIATIT LEJOHET TË KALOHET NGA ESENCA [NGA PARIMI]

Siç cekëm më parë është e ndaluar për të bashkëpunuar me ata të cilët bëjnë padrejtësi dhe janë kriminelë dhe kjo është parimore dhe esenciale. Kjo është rregull thelbësore apo e përgjithshme dhe nga kjo mund të kuptojmë se ka raste ku lejohet kalimi nga parimi [esenca] për çështjet të cilat i parasheh sheriatu sa të jetë e nevojshme dhe sa të jetë e mundur.

Nga këto raste janë:

Për ta zvogëluar të keqen dhe krimin është e lejuar sa të ketë mundësi.

1.- Kush ka mundësi për të zvogëluar sherrin, të keqen, armiqësinë, ose për ta larguar të keqen në një mënyrë apo formë tjetër, ai duhet të bëjë ashtu, sepse i ndihmohet të dobët, forcohet i dobët, dhe i ndihmohet atij të cilit i është bërë padrejtësi. Kështu ngushtohet rrethi i të keqes, krimit dhe armiqësisë në bazë të mundësive.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Frikujuni Allahut sa të keni mundësi” SURETU TEGABUN 16

Po ashtu edhe Muhamedi a.s. thotë: **“Nëse urdhëroheni për një çështje, kryejeni sa të keni mundësi”** [MUTEFIKUN ALEJHI]

Zoti i Madhëruar thotë: **“Allahu nuk e ngarkon askënd vetëm sa të ketë mundësi ai.”** SURETUL BEKARE 286

Ne e kemi mësuar se si Nexhashiju, mbret i Etiopisë e ka pranuar Islamin në kohën e Muhamedit a.s., mirëpo prapëseprapë nuk ka mundur të vendosë qeverinë islame në mbretërinë e tij, sepse po ta bënte këtë, populli i tij do ta

rrëzonte nga pushteti; për këtë arsye i Dërguari i Allahut Muhamedi a.s. nuk e ka urrejtur.

Filozofia “Ose të tërën [qeverinë] ose asgjë” është e papranuar edhe nga aspekti faktik por edhe nga aspekti i sheriatit.

NËNSHTRIMI DËMIT MË TË VOGËL NGA TË DY DËMET

2.-Ky është rasti dhe nevoja e dytë të cilën e ka lejuar sheriatit për t’iu nënshtruar apo për të bërë të keqen më të vogël, apo më të lehtë kur të paraqitet domosdoshmëria; për ta hequr dëmin më të madh, ose prej dy dobive për ta fituar dobinë më të madhe.

Për këtë arsye e kanë lejuar dijetarët heshtjen për të keqen, nëse e sheh se nga kundërvënja vjen e keqja edhe më e madhe.

Argumentohen për këtë me thënien e Ajshes r.a. nga Muhamedi a.s. “Po mos të ishte populli yt që para pak kohe ka qenë idhujtarë do ta ndërtoja Qaben mbi themelet e Ibrahimit a.s.

MUTEFIKUN ALEJHI

E ka lënë çka është vaxhib nga frika se do të fillojë çrregullia nga ndryshimi i themeleve të Qabes, pse ata ende nuk i kanë pasur këmbët e forcuar në Islam.

Unë argumentoj edhe me ajet të Kur’anit me rastin e Musasë a.s. kur ka shkuar për të folur me Allahun, i kishte kryer tridhjetë ditë pastaj i ka plotësuar edhe me dhjetë ditë të tjera, d.m.th. katërdhjetë ditë ka qëndruar për të folur me Allahun. Gjatë mungesës së tij, Samriu e humbi popullin, kur e ndërtoi një viç prej ari dhe u tha: Ky është Zoti i juaj se Zoti i Musasë a.s. u ka harruar juve. Ata i besuan dhe e dëgjuan. Haruni a.s. ua tërhoqi vërejtjen duke u thënë:

“O popull ju jeni sprovuar dhe do të humbni me këtë, pse nuk ka dyshim se Zoti i Juaj është i Gjithëmëshirshmi, më dëgjoni mua dhe më pasoni mua. Ata i thanë ne nuk kemi çka të presim deri sa të vijë Musa”.

SURETU TAHA 90-91

Kur erdhi Musa dhe e pa popullin e tij në atë gjendje, u zemërua dhe u hidhërua shumë, dhe i tha popullit të tij: *“Po sa keq keni vepruar dhe s’keni pasuar pas meje”.* I gjuajti pllakat prej zemërimit, e kapi për koke vëllanë e tij e tërhoqi me zemërim dhe e qortoi me të madhe:

“Tha o Harun çka të ndali ty kur i ke parë se kanë humbur dhe nuk pasojnë [të drejtën]. A edhe ti e ke kundërshtuar urdhrin tim. Tha o djali nënës sime mos më kap as për mjekre as për koke. Unë jam frikësuar se ti do të më thuash i ke ndarë dhe i ke përçarë beni israilët dhe nuk e ke dëgjuar nuk e ke përcjellë urdhrin tim.”

SURETU TAHA 92-94

Kjo d.m.th. se i Dërguari i Allahut ka heshtur atë të cilën e ka bërë populli i tij dhe ajo është send shumë i keq bile edhe më e fëlliqura është adhurimi i viçit. Ndërsa ai e ka paraparë ruajtjen e unitetit dhe bashkësisë në atë fazë deri sa të kthehet Musa e pastaj për t’u marrë vesh si të shërohet ai problem në mënyrën më të përshtatshme.

NGA SHEMBULLI MË I MIRË ZBRITJA NË GJENDJEN FAKTIKE MË TË ULTË

3.-Shembulli më i mirë është ai të cilën e ka paraparë sheriatit për njeriun mysliman si më e përshtatshme për aktivitetin e tij, por në shumicën e rasteve gjendja faktike dominon dhe e mund dhe nuk mund të arrijë dhe për këtë arsye duhet të zbresë në atë më të poshtmen, nën shtypjen e rrethanave të domosdoshme, duke vepruar çka është më e mundshme, pasi që bëhet e pamundur arritja në shkallën më të mirë dhe në shembullin më të mirë.

Nga këto shkaqe burojnë rregullat: Domosdoshmëria e lejon të ndaluarën; rregulla tjetër; “Vështirësia kërkon për ta gjetur më të lehtë” dhe rregulla “Mos të dëmtohet dhe mos të lejohet për t’u dëmtuar” dhe rregulla “Duhet të largohet pesha e rëndë dhe vështirësia”.

Kush e lexon Kur’anin dhe sunetet, këto çështje i sheh shumë qartë. Kur’ani veç e ka sqaruar se Zoti i Madhëruar ka vendosur ligjet e sheriatit për lehtësim jo për vështirësim, për lirim jo për shtrëngim, dhe duke i paraparë rrethanat më të lehta pse domosdoshmëria imponon diçka tjetër, ndërsa nevoja e kërkon tjetrën.

Siç thotë Zoti i Madhëruar:

“Allahu dëshiron për ju lehtësim dhe nuk do për ju vështirësim”

SURETUL BEKARE 185

“Allahu dëshiron për të lehtësuar barrën për ju, ndërsa njeriu është krijuar i dobët ”

SURETU NISA 28

“Kjo është lehtësim prej Zotit Tuaj dhe mëshirë”

SURETU BEKARE 178

“Ai ju ka zgjedhur juve dhe nuk u ka bërë në fe diçka çka ju mundon dhe ju vështirëson ”

SURETUL HAXH 78

Kush detyrohet [i lejohet] me kusht që mos ta teprojë dhe mos të tejkalojë nuk është mëkat për të. Vërtet Allahu është falës dhe i mëshirshëm.

SURETUL BEKARE 1

Vetëm nëse ai që detyrohet ndërsa zemrën e ka të mbushur plot iman [besim]”

SURETUL NAHL 106

Në hadithe Sahihe Muhamedi a.s. thotë: **“Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos përndjekin”**

Në hadith tjetër; **“Vërtet ju jeni të zgjedhur për lehtësim dhe nuk jeni të zgjedhur për vështirësi”.**

Po ashtu edhe në një hadith tjetër Muhamedi a.s. thotë:

“Feja më e dashur te Allahu është e pastërta dhe tolerantja”.

Për këtë arsye ne shohim se dijetarët e kanë lejuar për individin mysliman dhe për shoqërinë islame, për të zbritur nga më e mira dhe shembullorja në gjendjen faktike të mjaftueshme për të mos u paralizuar interesi dhe dobia e njeriut, mos të humbin të drejtat e tyre dhe për të humbur edhe fenë edhe këtë botë. Shembull për këtë kemi: Dëshmia e të pamoralshmit [fasikut] lejohet kur nuk ka dëshmitar tjetër të drejtë, i cili është kusht për dëshmi.

Lejohet prokuroria [velajetul kadi] tradicionale nëse nuk ka prokuror “muxhtehid” i cili për të qenë prokuror parim është që të jetë “muxhtehid” njësoj si në emërimin e kryetarit të shtetit parim është për të qenë muxhtehid, mirëpo e kanë lejuar për të qenë edhe mukalid [pasues i kryetarëve të parë] bile edhe jodijetar, por me kusht që të konsultohet me dijetarët.

E kanë lejuar për të luftuar më të mirët dhe jo të mirët ndërsa esenciale është për të luftuar më të mirët.

Është pyetur imami Ahmed për prijësin e aftë të fortë dhe të fuqishëm, mirëpo mëkatar dhe për tjetrin zemërmirë, bamirës, mirëpo i dobët dhe i paaftë, me cilin prej tyre duhet shkuar në luftë. E imam Ahmedi r.a. është përgjigjur:” I afti, i forti dhe i fuqishmi mëkatar, por mëkatet i ka për vete, ndërsa aftësinë dhe fuqinë për myslimanët, ndërsa zemërmiri, bamirësi i paaftë dhe i dobët, bamirësinë [sevapet] e ka për vete, ndërsa dobësinë për myslimanët. Shkohet në luftë me të aftin dhe të fortin edhe nëse është mëkatar”. Kjo ka qenë ide dhe mendim për gjendjet faktike dhe realitetin nga ky imam i mrekullueshëm.

Nëse e shikojmë gjendjen faktike të myslimanëve se në çfarë humnere janë dhe çfarë prapambeturie dhe me gjendjen e kundërshtarëve të tyre se çka posedojnë, se çfarë force kanë, e shohim se gjendja momentale faktike na obligon që të pranojmë në momentet e dobësisë atë që duhet të mos e pranojmë në momentet e gjendjes kur të jemi të fortë. Dhe për ta pranuar në momentet e ndarjeve atë që duhet refuzuar në unitet.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Pra tani Allahu ju ka lehtësuar juve pse e di se në mesin e juaj ka të dobët”

SURETUL ENFAL 66

Kur’ani ka treguar se dobësia kërkon lehtësim, edhe pse myslimani gjithmonë duhet të jetë i fortë. Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur te Allahu sesa besimtari i dobët.

Nëse shoqëritë [partitë] islame nuk mund të arrijnë në pushtet vetë siç është rasti në shumë vende islame sot, nuk ka kurrfarë pengese pranimi për të hyrë në koalicion me të tjerët, nëse me këtë koalicion ka interes dhe dobi populli në përgjithësi.

NATYRSHMERIA E EVOLUCIONIT

4.- Asaj çka përmendëm më parë i shtojmë edhe këtë se ligj e ka paraparë Allahu që krijesat lindin, rriten dhe zhvillohen, ndaj kësaj nuk mund të jemi indiferent, ndaj “ligjit të evolucionit.”

Çdo gjë fillon e vogël e pastaj rritet, çdo gjë fillon e dobët pastaj forcohet. Këtë ligj e shohim te bimët, te kafshët dhe te njeriu.

Njeriu nuk lind në moshën madhore dhe i mençur por lind fëmijë, i vogël duke pirë qumësht, pastaj fëmijë në moshën e pubertetit, i ri, dhe në fund burrë etj.etj.

Para kësaj në barkun e nënës fëmija ka qenë lëngë, gjak pastaj copë mishi, e pastaj kockë e butë, e cili më vonë u mbështjell prapë me mish, pastaj formësohet krejt në formë tjetër, pra bëhet njeri.

Lavdërimi i takon Allahut i cili është krijuesi më i miri.

Sheriati e ka paraparë këtë ligj dhe e ka shkallëzuar për të obliguarit farzet prej farzeve, sikurse i ka shkallëzuar ndalesat prej ndalesave, mëshirë për ta dhe lehtësim për ta.

Në shumicën e rasteve njeriu përkundër dëshirave të tij nuk mund të arrijë në qëllimet e larta të tij përnjëherë. Mirëpo ai mund të arrijë hap pas hapi varësisht prej mundësisë dhe rrethanave, për këtë arsye nuk duhet refuzuar, sepse as sheriatu nuk e ndalon këtë, as tradita, as logjika e shëndoshë. Dijetarët kanë rënë në ujdë se çka nuk arrihet përnjëherë nuk lihet e tëra.

Për të arritur në qeveri islame të plotë është pikësynim madhështor; pa kurrfarë dyshimi duhet pasur vizion të qartë, duhet qenë largpamës dhe zemrën e mbushur me vullnet, mirëpo është e pamundur që të arrihet menjëherë. Çfarë pengese ka që arrihet vetëm një pjesë e saj që ka mundësi e pastaj për t’u dhënë të tjerëve shembull, për t’u sjellë argumente, e për ta realizuar atë çka ka mundësi të realizohet, të përhapet e mira, të dominojë drejtësia, e për t’ia çelur derën të tjerëve, për t’i trimëruar të tjerët dhe për t’u dhënë vullnet që të veprojnë si ai.

Në historinë tonë islame kemi shembuj e shembuj shumë të mirë në këtë drejtim për t’u bazuar dhe për të gjetur rrugën e vërtetë.

Këtë e gjejmë edhe te halifja [kryetari] i pestë i drejtë Omer bin Abdul Azizi i cili ka vendosur në veprimtari sunetet e Muhamedit a.s. dhe ka vendosur bazat e drejtësisë, e ka shpërndarë të mirën, të cilën nuk mund ta mohojë askush dhe nuk mund ta fshehë historia; mirëpo ai nuk ka mundur për të arritur krejt çka ka dëshiruar, me argumentin se ai nuk e ka kthyer sistemin parlamentar të zgjedhjes së halifes [kryetarit] i cili është parim në islam; mirëpo këtë e kanë hequr [sistemin konsultativ dhe parlamentar] umevijinët.

Sikurse edhe veprimtarinë në pushtet e ka zhvilluar në mënyrë të shkallëzuar, me urtësi dhe me butësi derisa edhe biri i tij Abdul Meliki ka qenë i ri, i devotshëm dhe i thotë një ditë: *“O babai im, çka është kjo që në ekzekutimin e urdhrave je shumë i ngadalshëm dhe i kujdesshëm. Se për Zotin nuk mërzitem nëse na ndodh ndonjë e keqe [kadër] deri sa e dimë se e keni të drejtë dhe jemi në rrugën e Allahut”*.

I biri ka dëshirat që prindi sa më shpejt të arrinte cakun e dëshiruar, e ai nuk është mërzitur se çfarë pasojash do të ketë pastaj, deri sa ai të jetë në rrugën e Allahut.

Babai i mençur dhe i urtë i tha: *“Mos shpejto o biri im. Unë kam frikë se ndoshta po i ngarkoj shumë përnjëherë për shkak të drejtësisë dhe largohen menjëherë prej saj dhe pastaj mund të bëhet kaos dhe çrregulli se Allahu në Kur'an dy herë e ka gjykuar alkoolin, ndërsa herën e tretë e ka ndaluar”*.

KUSHTET TË CILAT PATJETËR DUHET PLOTËSUAR PËR TË HYRË NË KOALICION

Për t'u lejuar bashkëqeverisja patjetër duhet të plotësohen kushtet, nëse nuk plotësohen atëherë është e ndaluar hyrja në koalicion.

Kushti i parë: Të jetë bashkëqeverisja me vepër e jo me fjalë e me deklarata. Bashkëqeverisja nuk pranohet për të qenë mjet vetëm në dorën e tjetrit sa që qeveritari në vepër bën çka të dëshirojë ai, pse nuk ka mirësi dhe përmirësim apo specifika të cilat i pranon logjika që në atë formë mund të realizohet drejtësia, e as të zhdukë padrejtësinë, nuk mund të vendoset rendi për t'u larguar e keqja dhe çdo gjë çka shpie tek ajo edhe nëse është e pjesërishme. Përndryshe bashkëqeverisja nuk do të kishte kurrfarë kuptimi dhe kurrfarë ndikimi.

Kushti i dytë: Të mos ketë qeveria karakter mizorie dhe kriminaliteti ose t' i shkelë të drejtat e njeriut haptazi. Dihet se prej myslimanit të devotshëm kërkohet që të drejtat e njeriut t'i mbrojë dhe atë qeveri duhet hequr sa të ketë mundësi me dorën e tij, nëse nuk ka mundësi, atëherë me zemrën e tij e kjo është shkalla më e ultë e Imanit.

Kërkohet prej myslimanit ta heqë atë qeveri, ose ta ndërrojë e jo ta përkrahë ose të bashkëqeverisë me të.

Po të kishte kërkuar firauni, i cili ka qenë arrogant dhe popullin ta kishte përçarë vetëm e vetëm që vetës së tij për t'i siguruar vend të sigurt, Jusufi a.s. do ta kishte refuzuar dhe nuk do të kishte kërkuar nga ai për qenë ministër i financave të Egjiptit. Mirëpo mbreti i Egjiptit në atë kohë nuk ka qenë si firauni në kohën e Musasë a.s.

Për këtë arsye as myslimani i devotshëm e as shoqëria myslimane nuk lejohet për të hyrë në koalicion [për të bashkëpunuar] me qeverinë diktatoriale e cila udhëheq në shpinë dhe në dëm të popullit, pa marrë parasysh nëse ajo qeveri është autokrate apo me sundim ushtarak të egër.

Ndërsa bashkëpunimi dhe koalicioni bëhet në sistem demokratik ku respektohen aftësitë e njerëzve.

Kushti i tretë: Për të pasur të drejtë të kundërshtohet çdo gjë çka është në kundërshtim me ligjet e qarta të sheriatit ose së paku për të qenë e përmbajtur. Ministri i drejtësisë p.sh. mund të gjykojë drejt në bazë të mundësive në ministri, mirëpo kërkohet prej tij në kuvendin e ministrave [pasi që ai është njeri prej tyre] për të qenë në pajtim me ligjet, marrëveshjet apo projektligjet e jo në pajtim me ligjet e prera të sheriatit; Ai atë duhet kundërshtuar ose të jetë i distancuar varësisht prej llojit kontradiktor apo peshës së saj.

Por kur kemi kundërshtime që janë të rrezikshme, me ndikim të madh që kanë peshë të madhe dhe janë gabime të mëdha, në këto raste nuk mjafton që t'i kundërshtojmë ose të distancohemi, por duhet larguar nga qeveria, që të mos shkruajë historia se myslimani apo shoqëria myslimane është pajtuar dhe është dakorduar me atë gabim të qartë.

Po e sqaroj me një shembull. Marrëveshja me Izraelin dhe pranimi i saj me tokat e uzurpuara dhe të okupuara të Palestinës dhe lënia Kudsit në çdo kohë dhe përgjithmonë të jetë kryeqytet i shtetit të tyre, dhe për të mos u lejuar miliona të dëbuarve [palestinezë] që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre, ndërsa në vendet e tyre të vendosen jehudë të ardhur nga vendet e ndryshme vetëm për ta popullzuar Palestinën me jahudi, kjo nuk është e lejueshme.

E katërta: Ata që bashkëqeverisin të provojnë për të fituar eksperiencë kohë pas kohe, e pastaj të shikojnë dhe të analizojnë çka është arritur e pastaj të vërtetojnë a kanë përfutur diçka apo jo. A e kanë realizuar çka kanë dëshiruar, a kanë vendosur drejtësi dhe a kanë përmirësuar diçka, e nëse po, sa ka qenë ajo arritje.

Ky studim dhe analizim pastaj ndihmon për të vendosur për të ardhmen a të jenë në qeveri në të ardhmen dhe ta vazhdojnë bashkëpunimin apo për t'u tërhequr definitivisht nga qeveria.

FETVATË E DIJETARËVE MË EMINENTË PËR KËTË ÇËSHTJE

Për këtë çështje janë përgjigjur edhe dijetarët më eminentë prej ekspertëve islamë, fukahave të mëdhenj, të cilët e kanë lejuar marrjen e posteve politike në organe juridike dhe udhëheqëse edhe nën komandën e prijësve dhe udhëheqësve të padrejtë, nëse marrja e atij posti sjell më shumë dobi për popullin dhe më shumë i largon dobësitë dhe të metat.

Fetvatë e tyre janë të bazuara në atë që ne e quajmë [Fikhu i balancimeve] Fikhu i bazuar në prioritetin e çështjeve të cilat janë më të dobishme se të tjerat që nëse paraqiten duhet shikuar cila ka përparësi, dhe cila nuk ka përparësi, cila çështje duhet më herët e cila më vonë.

Po ashtu balancimi i të këqijave të dëmshme. Njësoj veprohet edhe me të kundërtat pra vendosen në peshojë të sheriatit të mirat në njërën anë, të këqijat në anën tjetër e pastaj shikohet, vështrohet, analizohet dhe studiohet a është dëmi më i madh e dobia më e vogël apo dobia e madhe ndërsa dëmi i vogël.

Këto balancime dhe dhënia prioritet çështjeve ka nevojë për dy lloje të fikhut.

1.-Fiku i dispozitave dhe argumenteve nën sferën e citateve dhe teksteve të sheriatit dhe pikësnyimeve të përgjithshme.

2.-Fikhu i gjendjes momentale dhe rrethanave që ekzistojnë pa i nënçmuar dhe pa marrë parasysh gjendjen e myslimanëve, të kundërshtarëve apo gjendjen lokale, rajonale apo ndërkombëtare.

Në dritën e këtij fikhu pra fikhu i vendosjes së çështjeve në peshojë burojnë këto fetva të paraqitura:

FETVA E IZUD-DIN ABDUS SELAMIT

Prej dijetarëve mbreti i imamëve Izud-din Abdus-Selam në librin e tij *“Rregullat e dispozitave dhe dobitë e më të mirit”* shkruan:

“Sikur pabesimtarët të arrinin në pushtet të një rajoni të madh apo krahinë dhe emërojnë në postin e ministrit të drejtësisë atë i cili i jep përparësi interesit të përgjithshëm të myslimanëve, i cili ka rast për të realizuar të gjitha kërkesat të cilat janë në dobi të myslimanëve, dhe i largon pengesat e përgjithshme d.m.th. largohet prej mëshirës së ligjit të sheriatit, ndërsa ai kujdeset për përmirësimin e gjendjes së robërve të Allahut, plotëson kushte për të mirën e përgjithshme, ndërsa pengon dhe ndalon shkatërrimin e përgjithshëm dhe e kryen me përkushtueshmëri atë detyrë që e merr, le ta marrë atë post”. Ky dijetarë në këtë rast ka përdorur çka është logjike, sepse ka përdorur urtësi për të ardhur te interesi i përgjithshëm dhe largimin e shkatërrimin në bazë të mundësive.

FETVATE E IBNI TEJMIJES

Dijetari i njohur islam Ibn Tejmije ka dhënë fetva të njohur në këtë drejtim duke e lejuar pranimin e posteve në shtetin ku dominon padrejtësia, nëse ai i cili e merr atë post ka mundësi për t’i larguar disa padrejtësi ose zvogëlimin e peshës së sherrit dhe çrregullirave. Këtë fetva e kemi dhënë në librin tonë *“Prioriteti i aktiviteteve në Islam”* ku kemi shkruar:

Është pyetur dijetari Ibn Tejmije Zoti e ngritë lart shpirtin e tij, për njeriun e emëruar në poste qendrore apo lokale dhe ai ka detyra nga udhëheqësit më të lartë siç është zakoni. Ai duhet të zgjedhë ose të shkojë, ose të tërën ose asgjë pra ta rrëzojë atë pushtet ose të angazhohet varësisht sa të ketë mundësi. Pse ai e di nëse nuk e pranon atë detyrë emërohet në post dikush tjetër e atëherë padrejtësia vazhdon, bile mund të rritet edhe më shumë. Ndërsa nëse është ai vetë mundet par ta zvogëluar në komunën e vet të keqen dhe padrejtësinë ose gjysmën e asaj

padrejtësie e heq, ndërsa sa i përket gjysmës tjetër atë nuk ka mundësi ta heqë dhe kërkohet prej tij për gjysmën tjetër ta heqë, mirëpo ai nuk ka mundësi atë tjetrën. Personi i tillë a duhet të mbetet në atë post apo në atë detyrë kur dihet nijeti i tij, angazhimi i tij dhe çka ka hequr prej padrejtësive sa ka pasur mundësi apo për të dhënë dorëheqje nga ai post dhe nga ajo detyrë. Por nëse jep dorëheqje nuk hiqet padrejtësia, por mbetet ende në fuqi, bile edhe shtohet. A lejohet pra që ai të vazhdojë detyrën dhe të mbetet në post, siç e përmendëm dhe a ka ai gabim në këtë çështje apo jo. Nëse nuk ka gabim ai vetë, a kërkohet prej tij përgjegjësi apo jo. Dhe cila është më mirë për të: për të vazhduar detyrën dhe për t' u angazhuar të heqë të padrejtën ose të zvogëlojë atë apo për të dhënë dorëheqje e për të mbetur padrejtësia e për t' u rritur edhe më shumë.

Është përgjigjur:

E falenderoj Allahun. Po, nëse angazhimi i tij është për të vendosur rend dhe drejtësi dhe për ta hequr padrejtësinë sa të ketë mundësi, sepse mbetja e tij në post, apo emërimi i tij është në interes dhe dobi të myslimanëve e jo në emërimin e tjetrit. Të udhëheqë ai në rajonin e vet është më mirë se tjetri siç e kemi përmendur. Lejohet ai të mbetet në atë pozitë dhe në atë post dhe nuk ka kurrfarë gabimi, bile më e vlefshme dhe më e pëlqyeshme është të mbetet në post sesa të japë dorëheqje, nëse nuk emërohet në post më të lart se aty.

Në shumicën e rasteve është vaxhib nëse nuk ka të aftë për atë detyrë pse vendosja e rendit dhe e drejtësisë në bazë të mundësive dhe heqja e padrejtësisë në bazë të mundësive është farz kifaje, duhet ta kryejë secili njeri që ka aftësi për atë, nëse nuk ka të tjetër për ta kryer atë. Dhe në këtë rast nuk jep përgjegjësi dhe nuk i kërkohet llogari për atë padrejtësi të cilën nuk ka mund ta heqë.

Ndërsa për udhëheqësit të cilët i vendosin dhe i caktojnë në vendet dhe detyrat dhe nuk munden të ndikojnë në ato vende dhe detyra, nuk kërkohet llogari për ta edhe nëse janë zëvendësministra dhe kërkohen mjete pa të cilat mjete nuk do të mund të caktoheshin në ato pozita. Nëse nuk u paguhen, ato mjete ato sigurojnë mjete prej rajoneve të tjera. Përgjegjësia bie në ata të cilët e shtojnë dhunën ose e zvogëlojnë. Për t' i marrë ato pozita dhe për të mos u dhënë rast të tjerëve është në dobi të myslimanëve. Kush vepron me drejtësi dhe me mirësi ai është më i mirë se ai tjetri, sepse po ta merrte atë post ai do të ishte edhe me larg nga drejtësia dhe më larg nga mirësia. Kështu, pra, ai me marrjen e postit e largon të keqen e të këqijave dhe duke kryer çka urdhërohet në bazë të mundësive. Çka nuk mundet të heqë prej padrejtësive ajo është mirësi për myslimanët, sepse së paku nuk sillet vetë i padrejtë. Shpërblehet dhe nuk ka gabim për atë çka e merr prej tyre. Dhe nuk denohet për atë çka e merr, dhe nuk denohet as në këtë botë as në botën tjetër, nëse është “muxhtehid” pra dijetar, i cili angazhohet me mish e me shpirt për drejtësi dhe bamirësi sa të ketë mundësi.

Njësoj mbikëqyrësi i jetimit dhe përgjegjësi i vakëfeve, dhe agjenti ekonomik në shoqërinë aksionare etj.etj., të cilët veprojnë dhe punojnë për tjetrin si kujdestar ose si të autorizuar. Nëse nuk mundet të jetë në interes të tyre pa dhënë

prej pasurisë së tyre atij i cili mundet t'ia shkatërrojë pasurinë, ai me këtë rast ka dhënë pak për të mbrojtur shumë, ai ka bërë mirë e jo keq.

Ajo çka ndalohet nga kjo është që vetë për të mos bërë asnjë padrejtësi qoftë edhe e vogël. Nëse të tjerët e pranojnë aty shtohet kriminaliteti, padrejtësia dhe çrregullia mbi ta. Kjo i ngjason sikur të jesh në rrugë dhe dalin plaçkitësit nëse plaçka për ta është e vogël dhe nuk e pëlqejnë, ua marrin udhëtarëve tërë pasurinë dhe i vrasin. Nëse thotë ndonjëri i atij karvani se nuk u lejohet për t'u dhënë atyre asgjë, ai ka për qëllim për ta ruajtur atë pjesë të pasurisë së vogël e cila është e ndaluar për t'iu dhënë; mirëpo nëse e dëgjojnë çka thotë, u shkon edhe pjesa e vogël dhe pjesa e madhe e pasurisë dhe vriten. I mençuri nuk e thotë këtë e mos të flasim për të thënë ashtu me shariat. Allahu ka dërguar peygamberë për t'i realizuar qëllimet e mira, dhe për t'i plotësuar ato, për t'i paralizuar shkatërrimet, trazirat dhe çrregullirat ose për t'i zvogëluar ato në bazë të aftësive dhe mundësive.

Ndërsa ai deputet apo ai i cili caktohet përgjegjës dhe mbrojtës i rajonit [kryetar komune] mbron çdo gjë çka është në kompetencën e tij dhe largon prej myslimanëve padrejtësinë dhe të keqen dhe çka është më e dëmshme për ta ndërsa pa qenë në atë pozitë nuk do të mund t'i largonte ato të këqija. Dhe nëse jep dorëheqje, atëherë atë post e merr dikush tjetër e nuk mundet të bëjë asgjë. Ndërsa po të jetë vetë shpërblehet dhe nuk ka kurrfarë gabimi për atë dhe nuk denohet as në këtë botë as në botën tjetër.

Kjo është njësoj sikur i porosituri për t'u kujdesur për jetimin dhe mbikëqyrësi i vakëfit i cili kujdeset për të mirën e tyre dhe nuk mundet ta realizojë atë apo për ta penguar, nëse diçka i pakësohet apo i bëhet padrejtësi nga pushteti apo udhëheqësi, nëse heq dorë e merr përkujdesjen ai i cili është më i keq dhe shtohet padrejtësia. Mbikëqyrja dhe kujdestaria e tij lejohet dhe nuk ka kurrfarë gabimi për atë që nuk mund ta pengojë, bile e ka vaxhib për ta marrë atë kujdestari dhe atë përgjegjësi.

Po ashtu ushtria e rajonit e cila i zvogëlon depërtimet në vendin e saj, por nuk mundet për ta mbrojtur në tërësi, por ajo kërkon kuajt, armë, financim dhe atë nuk mundet ta mbrojë pa i pasur disa pika kufitare, dhe kjo u ndihmon myslimanëve për xhihad. Nëse i thuhet atij nuk të lejohet për ta kryer atë detyrë por tërhiquni nga ky rajon, dhe largohet ushtria nga ai rajon dhe e merr përsipër komandën dhe atë rajon ai i cili dëshiron kaos dhe padrejtësi e nuk u bën dobi myslimanëve, ai i cili i ka thënë atij për të dhënë dorëheqje ka gabuar dhe është treguar injorant ndaj fesë, bile po të jetë në ushtrinë turke apo arabe, të cilat janë më të mira se të tjerat dhe më të dobishëm për myslimanët, sesa në qeveri tjerët e cila më pak sjellin dobi e më shumë padrejtësi.

Çdo muxhtehid prej tyre në ato rajone të cilët janë të drejtë, të mirë në bazë të mundësive Zoti i shpërblen me të mira për veprat e tyre, ndërsa nuk i dënon për atë çka nuk kanë pasur mundësi për ta kryer dhe nuk e dënon për atë çka ka marrë dhe çka ka shpenzuar nëse patjetër ka qenë dashur të veprohet ashtu ndërsa po të ishte larguar nga detyra e keqja do të ishte më e madhe.

MENDIMI TJETËR I IBN TEJMIJES: PROBLEMATIKA E ÇËSHTJES KUR TË PARAQITEN EDHE TE MIRAT EDHE TË KËQIJAT NË TË NJEJTËN KOHË

Ibn Tejmije thotë për atë sa i përket kur të jenë në një vijë edhe e mira edhe e keqja:

Nëse vërtetohet se prej atyre të mirave ka dobi të përgjithshme dhe se është vaxhib, dhënia dorëheqje është e dëmshme, pse të këqijat janë të dëmshme. Në mekruh ka disa të mira.

Munden të paraqiten dy të mira, por njëra është më e mirë se tjetra, atëherë i jepet prioritet më të mirës. Në anën tjetër mund të paraqiten dy të këqija dhe njëra patjetër duhet të veprohet, atëherë të keqen e madhe e largon me të keqen e vogël. Ndonjëherë mund të paraqitet edhe e mira edhe e keqja dhe patjetër duhet të pranohen që të dyjat, atëherë është e domosdoshme të realizohet e mira ndërsa edhe të keqen duhet realizuar pse patjetër duhet nënshtruar nevojës.

E para: si vaxhibi edhe mustehabi apo si farzi ajn dhe farzi kifaje shembull; Larja e borxhi është me e kërkuar sesa dhënia lëmoshë vullnetare [sadak].

E dyta: shpenzimi për t'i ushqyer prindërit ka përparësi ndaj shpenzimit për xhihadin i cili nuk është obligativ prej instancave më të larta siç ekziston në hadithin sahihë kur është pyetur Muhamedi a.s.:

-Cila është vepra më e mire:

-Falja e namazeve në kohën e tyre

-Pastaj cila:

-Sjellja mirë ndaj prindërve

-Pastaj cila:

Lufta në rrugën e Allahut

Lufta në rrugën e Allahut ka përparësi ndaj haxhit siç është e definuar mirë në Kur'an dhe sunet.

Pra farzi ajn, me farzin ajn shihet çka ka përparësi. Mustehabi me mustehab duhet shikuar cilës për t'i dhanë përparësi.

Leximi i Kur'anit me zemër ka përparësi ndaj "dhikrit" me zemër. Leximi i Kur'anit me gjuhë ka përparësi ndaj "dhikrit" me gjuhë. Namazi ka përparësi ndaj leximit të Kur'anit dhe dhikrit nëse namazi bahet me zemër. Janë raste të tjera ku "dhikri" me zemër dhe "dhikri" çka e trondit zemrën ka përparësi ndaj leximit të Kur'anit i cili nuk arrin as në vesh të lexuesit e mos të flasim në zemër. Kjo është një tematik e gjërë e cila kërkon diskutim të thellë.

E treta: Gruaja ka përparësi për të udhëtuar edhe pa kujdestar nëse migron në rrugën e Allahut e nuk dëshiron të qëndrojë në shtetin joislam siç ka vepruar Umi Kulthumi për të cilën ka zbritur ajeti Kur'anor;

“ O ju të cilët keni besuar nëse vijnë te ju të migruarat në rrugën e Allahut ju pyetni ata “.
SURETUL MUMTEHINE 10

Në poezi thuhet:

“Nëse në shtëpi paraqiten dy sëmundje të ndryshme

Shërohet ajo e cila është më e rrezikshme”

Kjo formë e veprimit ekziston në të gjitha çështjet. Për këtë arsye ka mbetur në kokat e njerëzvet se në kohën e thatësisë shiu është rahmet për atë popull edhe pse ai shi e forcon pozitën e popujve mizorë pse bëhet bereqeti mirëpo thatësia apo mungesa e shiut është dëm edhe më i madh; po ashtu thonë: Më mirë është për të pasur udhëheqësi të padrejtë se mos për të mos pasur fare.

Disa të mençurë kanë thënë: Më mirë është që 60 vite të jetë një udhëheqës i padrejtë se një natë të mbetet populli pa udhëheqës.

Pastaj udhëheqësi denohet për atë padrejtësi apo për armiqësi apo për shkeljen e të drejtave njerëzore kur të paraqitet mundësia që ai të dënohet. Mirëpo po shtoj edhe këtë: nëse është fjala për pushtetin qendror ose çështja e ministrive si ministria e drejtësisë etj. dhe nuk i realizon detyrat e tij dhe nuk mund të largohet prej haramëve, mirëpo ai e ka pikësynimin realizimin e detyrave dhe heqjen e haramëve e të tjerët nuk e kanë atë pikësynim, lejohet për t'u emëruar në post të pushtetit qendror, ndoshta edhe e ka vaxhib për arsye se emërimi në poste nëse është prej vaxhibeve të cilat janë interes i përgjithshëm kombëtar si p.sh. lufta kundër armikut, ndarja e pasurisë nga fronti, vendosja e ligjeve, forcimi i kufijve, sigurimi rrugëve, atëherë është vaxhib pse dihet nëse patjetër duhet të funksionojë ai post qendror, por e merr kush nuk e meriton, kush nuk ka të drejtë ta marrë dhe kush nuk është mirë ta marrë; kjo përbën rregullën e fikhut; “Çdo vaxhib i cili nuk mundet të realizohet pa një element të caktuar, ai element bëhet vaxhib. Çdo vepër mustehab e cila nuk arrihet pa një element të caktuar ai element bëhet mustehab. Pra emërimi në post të pushtetit qendror është vaxhib nëse tjetri i cili emërohet sjell çrregulli e shkatërrime e jo përmirësim, rend e qetësi. Bile edhe nëse emërimi në atë post nuk është vaxhib, ose ajo detyrë kërkon për t'u bërë disa padrejtësi, pse kush emërohet i bën ato padrejtësi pa dëshirë, lejohet, sepse qëllimi është për t'i zvogëluar padrejtësitë dhe për të zhdukur sa më shumë padrejtësi, kjo është edhe e mirë me atë nijet. Ndërsa për të këqijat që i bënë janë të arsyetuara duke u bazuar në rregullën e fikhut: për t'u larguar ajo çka është më e keqe është e mirë dhe e lejuar.

Kjo është temë e cila ndryshon me ndryshimin e nijeteve dhe pikësynimeve. Nëse kërkohet prej dikujt për të ndërmjetësuar në mes të dy palëve njeri me padrejtësi i ka marrë tjetrit pasuri. E ai me sa të ketë mundësi angazhohet dhe ndërmjetëson për t'iu kthyer e drejta [borxhi] atij të cilit i është marrë pasuria është i mirë ai ndërmjetësim. Ndërsa nëse ndërmjetëson me për t'ia mbajtur anën më të fortit dhe të padrejtit, atëherë është keq.

Kështu në rregullat e luftës, edhe pse dihet është e ndaluar për të vrarë gra, fëmijë e pleq, ndërsa lufta është gjithëpërfshirëse sa që gjuajtja natën, apo granatimet [hedhja me top zjarri] atëherë lejohet. Kështu ka ndodhur në izolimin e Taifit dhe gjuajtja me top zjarri.

Po ashtu në çështjen e tatarëve, të cilën e tregojnë se për të larguar fitnen e pabesimit, por mund të ndodhë edhe për ndonjë rast më të lehtë. Për këtë arsye kanë thënë dijetarët: Nëse e keqja dhe dëmi i myslimanëve nuk mund të largohet vetëm se me likuidimin e tyre.

E katërta: shembulli i ngrënies së coftirës gjatë urisë për vdekje. Ngrënia e coftirës është mirë dhe vaxhib. Dhe nuk mund të largohet ajo uri vetëm me atë të keqe [ngrënia e coftirës]. Dhe e kundërta ilaçet e fëlliqura [të këqija]. Dobia e ilaçit të fëlliqtë është më e madhe se dëmi prej saj, siç është rasti i alkoolit për shërim.

Shihet qartë se e keqja veprohet në dy raste; E para për ta larguar atë çka është më e keqe, nëse nuk mund të largohet vetëm me atë të keqe dhe e dyta: për të arritur atë çka është më e dobishme, nëse ajo e dobishme nuk arrihet vetëm me atë të keqe.

E mira lihet në dy raste; E para nëse lënia e asaj të mire i lëshon vend të mirës e cila është më e dobishme se ajo, e dyta: në të vepruarit e të mirës sjell të keqe edhe më të madhe ose paraqitet dëmi më i madh në anën tjetër.

Kjo është ajo çka ka të bëjë me vendosjen e gjërave në peshojë nga aspekti i fesë.

Ndërsa mosveprimi i vaxhibit për shkak të dëmtimit në këtë botë ose të lejuarit e haramit për nevojë të kësaj bote njësor sikur agjërimi [farz] nuk realizohet ai farz për shkak të udhëtimit, apo mosrealizimi i farzeve të namazit [qëndrimi në këmbë p.sh.] për shkak të sëmundjes. Kjo është temë tjetër e cila tregon gjerësinë e fesë, dhe lehtësimin e vështirësisë kur të ndryshojnë rrethanat për dallim nga tema e parë ku nuk mund të ndryshojnë dispozitat edhe nëse ndryshojnë rrethanat. Pse ajo e para është e vërtetuar logjikisht ku ekziston thënia: Nuk është i mençur ai i cili e di të mirën apo e dallon të mirën prej të keqes, por i mençur është ai i cili di për të dalluar çka është më prioritare për të lënë prej dy të këqijave.

Në shumicën e rasteve në këtë çështje është qëllimi i keq dhe veprimi i keq. Sa i përket qëllimit udhëheqësi ka për qëllim pasuri. Sa i përket veprimit ai i vepron të ndaluarat dhe i lë vaxhibet. Jo për shkak se cila është më e mirë dhe më e dobishme dhe jo për shkak të prioritetit kur të paraqitet rasti.

Pastaj emërtimi në post edhe pse është e lejuar, ose ndonjëherë mustehab, ose ndonjëherë vaxhib. Mundet të jetë e drejtë e ndonjë individi edhe më vaxhib nëse e meriton, ose më mustehab, atëherë ju jepet përparësi prej dy vaxhibeve, ose prej dy mustehabeve.

Për këtë arsye Jusufi i drejtë u bë ministër i ekonomisë në vendin e mbretit të Egjiptit, bile edhe vetë ka kërkuar të jetë ministër i financave kur mbreti dhe populli i tij kanë qenë pabesimtarë, ku thotë Zoti i Madhëruar:

“Edhe Jusufi qysh më herët, u ka sjellë ajete të qarta, porse ju vazhdimisht keni dyshuar në atë që ju ka sjellë”

SURETUL GAFIR 34

Thotë Zoti i Madhëruar se Jusufi a.s. u ka thënë shokëve në burg:

“O shokë të mi të burgut. A janë Zotërat e llojlojshëm më të mirë apo Allahu i vetmi Ngadhënjimtar. Ata që i adhuron në vend të Allahut janë vetëm emra me çka i keni emërtuar ju dhe baballarët tuaj”.

SURETU JUSUF 39-40

Dhe shumë mirë dihet se te pabesimtarët ka qenë zakon për të mbledhur tatime, për të shpenzuar dhe për të grumbulluar mjete për arkën e mbretit, familjen e tij, ushtrinë e tij dhe organet e tij, çka nuk ka qenë traditë te pejgamberët të cilët kanë qenë të drejtë. Jusufi a.s. nuk ka mundur të veprojë çka ka dëshiruar, sepse çka ka paraparë ai në fenë e Allahut populli nuk iu kish përgjigjur por ka vepruar me drejtësi sa ka pasur mundësi. Dhe ia ka arritur që me pozitën e tij të cilën e ka pasur te mbreti të nderojë dhe të respektojë familjen e tij çka po të mos kishte qenë në post nuk do të mund ta bënte . E tëra kjo përfshihet në fjalën e Allahut:

“Dhe ruajuni Allahut sa të keni mundësi”

SURETU TEGABUN 16

Kur të ndeshen dy vaxhibe dhe nuk mund të bëhet bashkimi i tyre i jepet prioritet asaj që është më e rëndësishme dhe në atë rast vaxhibi tjetër nuk e merr rrolin e vërtetë të tij [rolin e vaxhibit]. Dhe ai i cili e ka lënë atë vaxhib për ta kryer çka është më e rëndësishme ai nuk e ka lënë vaxhibin realisht.

Njësoj kur të ndeshen dy ndalesa, ndalesën e madhe nuk e realizon por ajo çka është ndalesë me peshë më të lehtë. Dhe veprimi i ndalesës më të lehtë në këtë rast nuk konsiderohet veprim i ndalesës absolutisht. Por edhe pse quhet lënia e vaxhibit, ose veprimi i ndalesës në realitet nuk dëmton asgjë dhe nuk prish punë. Në këto raste thuhet si vijon: Lënia e vaxhibit me arsye, ose veprimi i ndalesës për shkak të dobisë dhe interesit më të madh ose për shkak të domosdoshmërisë ose për shkak të largimit të haramit më të madh.

Kjo problematikë është shumë, shumë e thellë dhe e gjerë, posaçërisht në kohërat dhe vendet ku mungojnë traditat, veprat e pejgamberit ose hilafeti i pejgamberit. Vërtet këto problematika shtohen aty ku mungon njohja e vërtetë e veprimit të Muhamedit a.s. Dhe kjo pastaj shkakton fitne dhe trazira në umet. Pse kur të përzihen të mirat dhe të këqijat ndodh ngjashmëria e çështjeve aq shumë sa që nuk dihet si të veprohet. Popujt e tjerë i shikojnë të mirat dhe i japin përparësi interesit kombëtar edhe nëse u shkaktohet e keqe e madhe. Ndërsa popujt e tjerë i shikojnë të këqijat dhe u japin përparësi çështjeve të tjera edhe nëse i lënë të mirat e shumëfishta. Ndërsa mesatarët i shikojnë që të dy çështjet.

KANDIDIMI I JOMYSLIMANËVE PËR PUSHTETIN QENDROR NË SHTETET ISLAME

Pyetje:

A lejohet që jomyslimanët në shtetet islame ta kandidojnë veten e tyre për në kuvend ose parlament.

Përgjigje:

Falënderojmë Allahun, përshëndesim të dërguarin e Allahut, shokët e tij dhe kush pason rrugën e tij.

Shumica e studentëve posaçërisht gjenerata e re shpejtojnë në fetva për çështje shumë të rëndësishme dhe madhështore, pa u kujtuar fare dhe pa analizuar mirë dhe pa u konsultuar me dijetarë të cilët janë më të vjetër dhe kanë ecur më shumë e pastaj haramin e bëjnë hallall e hallalin haram apo vaxhibin nuk e bëjnë vaxhib ose disa gabime të vogla i bëjnë të mëdha ose disa mekruhe i bëjnë haram. Disa prej tyre e vështirësojnë atë çka e ka lehtësuar Allahu, me fjalë të tjera lidhin nyje me ligjet të cilat i ka zgjidhur Allahu apo i ngushtojnë njerëzit në atë çka i ka zgjeruar Allahu.

Këtë e ka urrejtur i Dërguari ynë Muhamedi a.s. te disa sehabë kur kanë dhënë përgjigje me shpejtësi në atë çka nuk e kanë ditur, kështu që kanë shkaktuar me fetvatë e tyre vdekjen e myslimanit pa kurrfarë fajti. Kjo ka ndodhur kur një njeri i plagosur ka mbetur një natë i papastër [xhunub] dhe i ka pyetur shokët e ata i përgjigjen se patjetër duhet për t'u pastruar, e ai është pastruar dhe varra i është zgjeruar aq shumë dhe u infektua sa që edhe ka vdekur. Kur ka dëgjuar për këtë Muhamedi a.s. ka thënë: **“E kanë vrarë, Zoti i mallkoftë. Pse nuk kanë pyetur kur nuk kanë ditur, pse ilaç i problemit është pyetja. Ka mjaftuar për të marrë tejmemur e për të mos e lënduar varrën”**.

Nuk befasohe mi kur ndonjëri nuk e lejon kandidimin e jomyslimanit për të hyrë në kuvend, organet më të larta shtetërore apo në parlament dhe e ndalojnë votimin për jomyslimanët. Kemi dëgjuar se i ndalojnë për t'u kandiduar për deputet edhe vetë myslimanët, ose vetë myslimani për t'u propozuar për kandidat të kuvendit shtetëror. Ato argumentohen se kush e propozon veten për në parlament ai e ka kërkuar për të qenë vetë në post udhëheqës, ndërsa kush kërkon për të qenë në post udhëheqës ai refuzohet në atë post, sikurse është në hadithin sahih të Muhamedit a.s. I ka thënë Abdurrahman bin Semre: Mos kërko post udhëheqës, sepse nëse e kërkon merr përgjegjësi të madhe, nëse nuk e kërkon ke përkrahje për atë.

Kur këta e ndalojnë për ta propozuar myslimani veten për kandidat nuk duhet habitur se e ndalojnë edhe për jomyslimanët.

Mendimi im është se delegimi në kryesi është pjesë e popullit dhe përfaqësim i një pjese të popullit, i cili nuk konsiderohet prej posteve, apo organeve udhëheqëse të cilën e ka gjykuar hadithi për ta kërkuar apo për ta dëshiruar. Përfaqësuesi në kryesi nuk është udhëheqës, as princ as pushtetar por përfaqëson rrethin e vet në kuvend apo parlament ku kërkohet llogari prej prijësave, udhëheqësve dhe ministrave. Për këtë arsye ai kërkon llogari dhe nuk i kërkohet llogari pse nuk ka kush e udhëheq apo kush kërkon llogari prej tij.

Pastaj ai merr pjesë në përpilimin e rregulloreve për umetin në të cilat nuk ka argument të prerë ose në përpilimin e rregulloreve ku ka argument por nuk është i prerë dhe nuk është i qartë.

Nëse jomyslimanët jetojnë në shtetin islam apo, me fjalë të tjera, janë nënshetetas të shtetit islam nuk ka kurrfarë pengese në sheriat që ai të inkuadrohet në kuvende për të përfaqësuar konfesion apo popullsi të caktuar derisa në kuvend shumica apo pjesa dërmuese janë myslimanë. Sikurse kemi shpjeguar kandidimin e femrës dhe votimi është prej myslimanëve dhe myslimaneve, aty nuk ka kurrfarë të mete derisa shumica janë meshkuj. Theksojmë sa i përket çështjes së pakicave joislame të cilët jetojnë në shoqëri islame ata kanë të drejta çka kanë myslimanët dhe ata kanë të njëjtat përgjegjësi të cilat i kanë myslimanët, sepse Kur'ani fisionik thotë:

“Nuk ju ndalon Allahu që ata të cilët nuk ju kanë luftuar juve për fenë tuaj dhe nuk ju kanë nxjerrë nga shtëpitë tuaja, për t’u bërë mirë atyre ose për të qenë të drejtë ndaj tyre. Vërtet Allahu i do të drejtën.

SURETU MUMTEHINE 8

Mirësi është për t’u sjellë me drejtësi dhe për t’u dhënë të drejtën të cilën e meritojnë, pra për të pasur përfaqësues në Kuvend ku mund t’i shprehin kërkesat e shoqërisë së tyre. Sikurse edhe gratë i shprehin kërkesat e gjinisë së tyre e pastaj këtë e shfrytëzojnë armiqët e Islamit dhe të myslimanëve për të mbjellë te ta armiqësi dhe urrejtje ndaj myslimanëve. Në këtë nuk ka kurrfarë dëmi dhe nuk i kanoset rreziku umetit të myslimanëve dhe jomyslimanëve.

Nëpër epoka të ndryshme kanë lejuar myslimanët për të qenë në organe udhëheqëse jomyslimanët dhe pakicat e tjera [ehli dhime] si në ministri dhe organe ekzekutive. Dihet shumë ministra që kanë qenë në kohën e sundimit abasit dhe asnjë prej dijetarëve nuk e ka gjykuar atë si jo të lejuar. Vetëm nëse kanë devijuar dhe janë treguar arrogantë ndaj myslimanëve, çka për fat të keq ka pasur raste të shumta, ndërsa asnjë dijetar [fekih] nuk ka gjetur aty argument për t’i ndaluar prej ministrive të ngjashme [prej pakicës jo islame] se jomyslimani nuk mundet të jetë udhëheqës i myslimanëve pse myslimanët janë ata të cilët ia kanë besuar atë pozitë, pse feja e tyre ua ka lejuar, ata janë udhëheqës në ministrinë e tyre apo në natyrën e tyre, mirëpo nën pushtetin qendror të myslimanëve.

Islami e konsideron të lejuar që myslimani të martohet me ndonjë prej ithtareve të librit dhe ajo bëhet pronare në shtëpinë e tij, nënë e fëmijëve të tij dhe kjo i jep asaj një masë të udhëheqësisë dhe përgjegjësi në shtëpi dhe tek fëmijët e tij. Siç është në hadithin [mutefikun alejhi] nga Ibn Omeri ku Muhamedi a.s. ka thënë: **“Të gjithë jeni bari dhe secili do të jep llogari për bagëtinë e tij...dhe gruaja është bari në shtëpinë e burrit të saj dhe ajo është përgjegjëse për bagëtinë e saj”**. Mirëpo udhëheqja e gruas dhe kujdesi në shtëpinë e saj është nën udhëheqjen e përgjithshme [e lartë] të shoqërisë myslimane.

Ndërsa pretendimeve e disave: se nuk lejohet që myslimani të jetë anëtar i kuvendit më të lartë shtetëror pse ajo është pjesë e udhëheqjes së jomyslimanëve dhe ajo kategorikisht është e ndaluar në librin e Allahut, u përgjigjemi si vijon:

“Për ta kuptuar një dispozitë të prerë dhe të qartë nevojitet për të përcaktuar “udhëheqjen” mbikëqyrjen e ndaluar. Pse përcaktimi dhe definimi i kuptimit të fjalëve është çështje e domosdoshme për nxjerrjen e ligjeve me qëllim që të mos përzihen lëmshtet dhe të çrregullohet kandari.

Disa njerëz ajetet të cilat kanë të bëjnë me miqësimin dhe bashkëpunimin me jomyslimanët i kanë keqkuptuar. Ata i kanë keqkuptuar në atë masë sa që thonë se duhet urrëjtur, dhe duhet shpëputur marrëdhëniet me jomyslimanët edhe nëse janë në shtetin islam dhe janë dashamirë të sinqertë të myslimanëve dhe të shoqërisë së tyre. Ata kontribuojnë në ndërtimin e atdheut jetojnë dhe banojnë së bashku e ruajnë atdheun së bashku qëndrojnë në një rresht për t’u mbrojtur prej sulmit të armikut nëse atdheu sulmohet.

E vërteta është se ai i cili i analizon ajetet e përmendura me një analizë më të thellë dhe e mëson kronologjinë e zbritjes së ajeteve, shkaqet e zbritjes së ajeteve kupton si vijon:

E para: Ndalesa e cila përfshihet në ajete vërtet është për t’i marrë si miq nga cilësia e tyre si shoqëri specifike e ndame me fenë e tij, besimin e tij, mendimet e tij dhe simbolet e tij d.m.th. nga cilësia e tyre si jehudi, i krishteri, idhujtari e të ngjashme e jo nga cilësia e tyre si fqinjë, shokë, bashkëvendës dhe atdhetarë. Është obligative që udhëheqjen e myslimanëve ta kenë vetë myslimanët këta edhe duhet kujdesur dhe në këtë drejtim; vjen vërejtja prej ajeteve për të mos i marrë si udhëheqës [përpos besimtarëve] siç është në ajetin Kur’anor:

“Besimtarët mos të marrin për miq [udhëheqës, prijës] përpos besimtarëve, se kush vepron kështu nuk ka asgjë nga ndihma e Allahut, përveç nëse seriozisht [dhe me kujdes] mbroheni prej tyre”

SURETU ALI IMRAN 28

“O ju të cilët keni besuar mos i merrni pabesimtarët për mbrojtës [udhëheqës] përpos besimtarëve. A po dëshironi t’i tregoni Allahut argument flagrant kundër vetvetes”.

SURETU NISA 144

“Lajmëroni hipokritët se i pret vuajtje e dhimbshme [pse ata janë] të cilët i marrin pabesimtarët për mbrojtës [udhëheqës] përpos besimtarëve. Vallë a tek ata e kërkojnë forcën kur e tërë forca i takon vetëm Allahut”.

SURETU NISA 138-139

D.m.th. ai i do, i simpatizon dhe afrohet e vepron në llogari të shoqërisë së tyre dhe nuk e do sistemin e fesë e as sistemin e shoqërisë së tij, largohet prej shoqërisë të cilës i përket, jeton në kurriz të tyre për ta vendosur udhëheqës në shoqërinë [popullin] tjetër. Kjo në aspekt shkencor atdhetar llogaritet spiunim dhe tradhti ndaj popullit dhe atdheut.

E dyta: Dashuria, simpatia të cilën e ka ndaluar Allahu në këto ajet nuk është dashuria ndaj atij i cili i përket fesë tjetër dhe nëse është që jeton në mesin e myslimanëve, ka marrëdhënie të mira me myslimanët dhe jeton në paqe me myslimanë. Por e ndaluar është dashuria dhe simpatia ndaj atyre të cilët i nënçmojnë myslimanët, janë armiq të myslimanëve dhe luftojnë kundër myslimanëve që në gjuhën e Kur'anit janë ata të cilët i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të tij, këtë e tregon ajeti Kur'anor:

“Nuk do të gjesh asnjë popull që i beson Allahut dhe ditës së gjykimit që i do, i simpatizon dhe miqësohet me ata që e sulmojnë dhe i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të tij”.

MUXHADELETU 22

Kundërvimi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij nuk është vetëm mosbesimi në ta por luftimi ndaj tyre, luftimi ndaj thirrjes në rrugën e tyre, përqendrimi kundër tyre, nënçmimi i pasuesve të rrugës së tyre dhe të cilët i mbyllin të gjitha rrugët që shpien në dëgjimin e tyre.

b. -Thënia e Zotit të Madhëruar në suretul muntehine;

“O ju të cilët keni besuar, armikun tim dhe armikun tuaj mos i merrni për udhëheqës, miq e mbrojtës duke u shprehur edhe simpati atyre pse ata e kanë mohuar të vërtetën e cila ju ka ardhur juve [Kur'anin] të cilët mundohen që edhe të Dërguarin e edhe juve t'ju nxjerrin prej besimit në Allahun i cili është Zoti juaj”.

SURETU MUMTEHINE 1

Ajeti tregon qartë shkakun e ndalesës se miqësia dhe simpatia ndaj idhujtarëve nuk është e ndaluar vetëm për shkak të mosbesimit të tyre por për shkak të dy çështjeve të përbashkëta; mohimi dhe mospranimi i Islamit dhe dëbimi i të Dërguarit dhe besimtarëve nga shtëpitë e tyre pa kurrfarë faji.

C.- Thënia e Zotit të Madhëruar po në të njëjtën sure:

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe me drejtësi ndaj atyre që nuk ju luftojnë për shkak të fesë dhe nuk ju përzënë nga shtëpitë tuaja. Me të vërtetë Allahu i do të drejtë. Vetëm se Allahu ju ndalon t'i konsideroni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe u përzënë nga shtëpitë

tuaja dhe ndihmojnë të jeni të përzënë. Pra ata që i konsiderojnë këta për miq, ata janë kriminelë.

SURETUL MUMTEHINE 8-9

Pra i ka ndarë ata të cilët kanë fe tjetër në dy grupe:

Grupi i pare.-Kanë të drejtë për t'u bërë mire dhe për t'u sjellë me drejtësi, pse ky grup jeton në paqe me myslimanët, nuk i lufton myslimanët për shkak të fesë, dhe nuk i dëbon nga shtëpitë e tyre.

Grupi i dytë.-i cili merr qëndrim armiqësor dhe i sulmon myslimanët, i lufton ose i dëbon prej shtëpive të tyre ose i përkrah dhe u ndihmon për t' i dëbuar myslimanët nga shtëpitë e tyre. Këtë grup e ndalon Allahu për të bashkëpunuar dhe për t'u miqësuar. Shembulli i idhujtarëve të Mekës prej të cilëve myslimanët kanë përjetuar vuajtje dhe torturime, nga kjo kuptojmë se sa i përket grupit të parë nuk është e ndaluar për t'u miqësuar me ta.

D.-Islami e ka lejuar që myslimani të martohet me ithtarën e librit, ndërsa jeta bashkëshortore kërkon qetësi shpirtërore të dyanshme, simpati dhe mëshirë siç tregon Kur'ani:

“Një prej argumenteve të Tij është se ju ka krijuar prej qenjes së juve bashkëshortore për ta qetësuar shpirtin te ta, dhe ka bërë në mes të bashkëshortësisë dashuri, simpati dhe mëshirë”.

SURETU RRUM 21

Kjo tregon se simpatia e myslimanit ndaj jomyslimanit nuk është mëkat. Si është e mundur që burri mos ta dojë bashkëshorten e tij dhe shokun e jetës së tij nëse është ithtare e librit. Si mos të duhen vjehrria [babën dhe nënën e bashkëshortes]. Për këtë arsye thotë Zoti i Madhëruar:

“Ai [Allahu] është që ka krijuar prej ujit njeri dhe i ka bërë atij pasardhës dhe vjehrrë”.

Si të mos e duash fëmijën, gjyshin e tij, gjyshen e tij, tezen e tij, hallën e tij dhe të mos lidhësh farefisninë nëse nëna e fëmijës është pakicë joislame, po ashtu edhe fëmijët e tezeve dhe të dajallarëve [të fëmijës së tij] ata janë farefis për çka edhe Kur'ani ka bërë obligim lidhjen farefisnore po ashtu edhe hadithi e ka vërtetuar dhe ka iniciuar për t' u dhënë të drejtë atyre.

E katërta.-E vërteta e cila nuk mund të dyshohet në Islam është ndërlidhja e fesë në shkallën më të lartë në mes vete sesa me të tjerët, pa marrë parasysh a është ajo ndërlidhje në nivel të farefisnisë, apo të vendit, apo të racës apo të klasës. Myslmani është vëlla i myslimanit. Besimtarët janë vëllezër. Myslimanët janë një popull i cili angazhohet për kujdesin e çdo pjesëtari fillim e mbarim, ata janë si një grusht. Myslmani është më i afërt te myslimani se çdo pabesimtarë i fesë së tij, pa marrë parasysh a është vëlla, djalë apo babë.

Kjo nuk është vetëm në Islam, por realitet i çdo feje, natyrshmëri e çdo feje dhe çdo besimi. Kush e lexon inxhilin(ungjillin) e has këtë në shumë vende por

është me rëndësi për ta ditur se ekzistojnë lloje të ndryshme vëllazërimi të cilat i pranon Islami përpos vëllazërimit në fe.

Kemi vëllazëri të vendit, vëllazëri të popullit, vëllazëri njerëzore për këtë arsye edhe Kur'ani përdor këtë terminologji:

“Ka rrejtur populli i Nuhut peygamber, kur u tha atyre vëllai i tyre Nuhu a nuk po frikësoheni”.

SURETU SHUARA 105-106

“Ka rrejtur populli i Nuhut peygamber kur u tha atyre vëllai i tyre Luti a nuk po frikësoheni”

SURETU SHUARA 160-161

Për popullin ad

“Kur iu tha atyre vëllai i tyre Hudi”

SURETU SHUARA 142

Pra Kur'ani i quan vëllezër nga aspekti se kanë qenë peygamberë prej atij populli edhe pse i kanë quajtur rrenacakë dhe nuk u kanë besuar atyre. Ajo nuk është vëllazëri fetare por vëllazëri kombëtare.

Transmeton Ahmedi nga Zejd Bin Erkemi se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Unë jam dëshmitar se të gjithë njerëzit [robërit e Allahut] janë vëllezër. Kjo është vëllazëri njerëzore e mos të flasim për vëllazërinë kombëtare, siç është rasti në mes të myslimanëve dhe koptëve në Egjipt, po ashtu për myslimanët dhe të krishterët në Liban, Siri, Jordani, të gjitha këto janë vëllazëri kombëtare. Të gjithë myslimanët dhe krishterët në atëdheun arab janë vëllezërit e një kombi”.

Ndërsa ekstremitetet dhe tejkalimet prej çfarëdo grupi janë të papranueshme. Në realitet ajo është kundër atdheut dhe kundër fesë pra, kundër të dyjave; kjo nuk i shërben askujt tjetër përpos atyre që përgatisin kurtha dhe dëshirojnë të fusin përçarje të pafund. Çdo vend shpik mjete e metoda për t' i përçarë mes vete. Në disa vende dëshirojnë të nxisin urrejtje mes sunijëve dhe shiitëve. Në disa vende e nxisin çështjen arabe dhe berbere, në disa vende arabë dhe kurdë e në disa vende nxisin urrejtje në çështjen myslimane dhe jomyslimane. Nëse nuk gjejnë asgjë prej këtyre kush e di çka e çka imagjinojnë dhe shpikin për të ndarë vëllanë prej vëllait.

“Dhe kurthojnë por edhe Allahu i kurthon. Allahu është ai që i përgatit kurthat më së miri”.

SISTEMI KONSULTATIV, PARLAMENTAR A ËSHTË DOMOSDOSHMËRI APO FAKULTATIV

Pyetje:

Në sheriatin islam sistemi parlamentar për udhëheqësin apo për kryetarin a është e domosdoshme për të pranuar vendimin e kuvendit ose të parlamentit apo ajo është vetëm për ta verifikuar apo për ta mësuar udhëheqësi

apo kryetari për ta ndriçuar rrugën e pastaj për të marrë ai vetë vendimin që i konvenon dhe i përshtatet. Edhe nëse e tejkalon vendimin të cilin e ka marrë kuvendi apo parlamenti, ose lejohet ashtu për të vepruar vetëm në raste të caktuara. Nëse po, cilat janë ato. Dhe a duhet të praktikohet kjo në organizatat fetare islame, dhe shoqatat islame të cilat veprojnë në Perëndim.

Përgjigje:

E falenderoj Allahun, dijetarët sa i përket çështjes së sistemit parlamentar janë kundërshtuar mes vete sa i përket dy aspekteve.

E para.-A është obligim për kryetarin, për organin shtetëror apo zëvendës kryetarin apo nuk është obligative.

E dyta.-Nëse është vaxhib, a është obligative për kryetarin apo organin shtetëror apo është vetëm fakultative- pra për të mësuar jo për të marrë vendim.

VENDIMI I PARLAMENTIT OBLIGATIV

Sa i përket çështjes së parë, të gjitha argumentet shprien tek ajo se sistemi parlamentar është vaxhib për kryetarin. Pse Zoti i Madhëruar e ka urdhëruar Muhamedin a.s. në suretull Ali Imran edhe pas betejës së Uhudit për të cilën betejë Muhamedi a.s. është këshilluar me shokët dhe në fund e ka pranuar vendimin e shumicës dhe ne e dimë si ka qenë përfundimi dhe prapëseprapë vazhdimisht ka urdhëruar për këshillime dhe konsultime. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Falu atyre, dhe kërko për t’u falë gabimet atyre dhe këshillohu, konsultohu me ta për çështjet”

SURETU ALI IMRAN 159

Primare është se kur të vjen fjala urdhërore posaçërisht në Kur’an është vaxhib.

Kjo sa i përket ajeteve të cilat kanë zbritur në Medine, por edhe në ajetet e Mekës Zoti i Madhëruar e ka cilësuar shoqërinë e besimtarëve me cilësi të këshillimeve dhe konsultimeve në mes vete. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Ata të cilët i përgjigjen Zotit të tyre, falin namazin dhe veprimet e tyre i bëjnë me këshillime mes vete dhe konsultime dhe me çka i kemi furnizuar shpërndajnë”

SURETU SHURA 38

“Përgjigjja urdhrave të Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit të gjitha këto janë farze dhe çështje shumë të rëndësishme të fesë, e pse vetëm konsultimi këshillimi [sistemi parlamentar] të jetë në mes tyre Mendub.

SISTEMI PARLAMENTIT OBLIGATIV

Sa i përket çështjes së dytë për të cilën është parashtruar pyetja: A është vendimi i parlamentit obligativ për kryetarin apo për kuvendin që d.m.th. nuk guxojnë të mos e aprovojnë atë çka ka vendosur parlamenti, apo nuk e kanë obligim, sepse ajo është vetëm për të mësuar diçka prej tyre, pra për t'u këshilluar, për t'i ditur mendimet dhe orientimet e pastaj vetë për të marrë vendim, çka e sheh të arsyeshme vetë dhe vetë të marrë përgjegjësinë.

Që të dy mendimet ekzistojnë në fikhun islam. Ndërsa sa më përket mua, në të gjitha librat kam shkruar dhe kam thënë se vendimi i parlamentit është obligim për kryetarin ose për qeverinë ose sistemi konsultativ është obligim për kryetarin e çdo organizate apo shoqate, apo ndonjë organi tjetër.

Ai e ka për detyrë për të paraqitur mendime, për të shpjeguar, për të diskutuar në liri të plotë e pastaj për të votuar për atë mendim nëse të gjithë pajtohen ai është pikësynimi kryesor.

Nëse disa e kundërshtojnë, atëherë patjetër vendos shumica, pra si ta parasheh shumica ashtu vendoset.

ARGUMENTET PËR TË VENDOSUR PËR MENDIMIN E SHUMICËS

Prej argumenteve të cilat dëshmojnë se duhet vepruar sipas vendimit të shumicës po përmendim:

1.-Muhamedi a.s. nuk ka pasur mendim për të dalë në luftë kundër idhujtarëve jashtë Medinës. Mirëpo pasi që shumica ishin unanimitë në mendimin për t'u pozicionuar në Uhud, Ai e pranoi vendimin e tyre. E vërteta është se Ai nuk ka urdhëruar pastaj kush pajtohet, e kush kundërshton dhe secili grup të veprojë pas mendimit të vet, por ka marrë vendim siç është pajtuar shumica.

2.- Muhamedi a.s. i ka thënë Ebu Bekrit: Nëse ju dy pajtoheni ndryshe nga mendimi im nuk do të ju kundërshtoja.

Kjo d.m.th. se i ka dhënë përparësi mendimit të dy vetëve ndaj njërit edhe nëse ai mendim është i tij si i Dërguar i Allahut.

3.-Ka urdhëruar Muhamedi a.s. për t'i dëgjuar vendimet e sahabeve më eminentë [SUVAD EADHAM].

4.-Ibni Kethiri në tefsirin e tij e tregon se Ibn Merdevije e ka transmetuar hadithin nga Aliu r.a. se kur është pyetur Muhamedi a.s. për ta sqaruar pjesën e ajetit Kur'anor të suretul Ali Imran **“Kur të vendosësh mbështetju Allahut”** Muhamedi a.s. ka thënë: **“Konsultimi me intelektualët e pastaj për t'i dëgjuar mendimet e tyre”**.

5.-Omeri e ka bërë që parlamenti të vendosë për gjashtë sehabet më eminentë si deputetë [Ehlil hal vel akd] të umetit e pastaj vendim përfundimtar, siç e shohin shumica prej tyre. Nëse votat barazohen tre me tre të shtohet si deputet edhe i shtati jashtë tyre të propozuarin Abdullah bin Umerin për të hyrë në parlament,

por nëse parlamenti nuk pajtohen me të, atëherë i shtati të jetë Abdurrahman bin Aufi.

6.-Kur'ani fisnik i ka gjykuar kryelartët dhe mizorët të cilët kanë vepruar si egoistë, totalitarë si p.sh. rastin e firaunit dhe Hamanit, ku Zoti i Madhëruar thotë:

“Kështu e vulos Allahu zemrën e çdo kryelarti mizor arrogant dhe shtypës”

SURETUL GAFIR 35

Dhe e ka gjykuar për të dështuar çdo shtypës kryefortë”

SURETU IBRAHIM 15

7.-Po ashtu Kur'ani i ka gjykuar rreptë të gjithë popujt të cilët iu kanë nënshtruar, iu kanë dorëzuar dhe janë pajtuar me ta dhe kanë shkuar rrugëve të tyre: as nuk i kanë kundërshtuar dhe as nuk i kanë urrejtur dhe nuk i kanë gjykuar veprimet e tyre, siç thotë Zoti i Madhëruar për popullin e Nuhut:

“Kanë pasuar atë i cili fëmijët e tyre dhe pasurinë e tyre e ka shpie në shkatërrim të plotë”

SURETU NUH 21

Për popullin e hudit thotë Zoti i Madhëruar:

“E kanë pasuar urdhrin e çdo shtypësi kryefortë”

SURETU HUD 59

Për popullin e firaunit po ashtu thotë Zoti i Madhëruar:

“E kanë pasuar urdhrin e firaunit, ndërsa urdhri i firaunit nuk i ka shpie në rrugë të drejtë”

SURETU HUD 98

“E ka frikësuar popullin e tij e prej frikës e kanë dëgjuar atë. Ata janë bërë popull shkatërrimtar i mbushur plot gabime”

SURETU ZUHRUF 54

8.-Deputetët e parlamentit në historinë islame janë të njohur si [ehlul hal vel akd] nëse vendimi i tyre nuk është vendim obligativ, atëherë çka kanë për të lejuar dhe çka kanë për të vendosur pro.

9.-Dijetarët në përgjithësi i japin përparësi mendimit të shumicës nëse nuk ka argument tjetër.

10.- Historia dhe e sotmja na mëson se mendimi i shumicës është më i mirë se mendimi i një individi. Mendimi i dy personave është më i mirë se i njërit. Fatkeqësia më e madhe që e ka kapluar umetin tonë është se për një periudhë ka funksionuar pushteti autokratik dhe totalitar. Kanë sunduar udhëheqës të këqinj në popujt e umetit në bijtë tanë të pastër dhe të lirë.

Në hadith Merfuë të transmetuar nga Omeri thuhet:

“Me njeriun është shejtani, ndërsa kur të bëhen dy ai largohet edhe më larg”

KANDIDIMI I FEMRËS PËR DEPUTETE NË PARLAMENT I LEJUAR APO I NDALUAR

Femra është e llojit njeri e obliguar sikurse mashkulli. Ka obligim për ta adhuruar Allahun, t'i përmbahet fesë, kryerjen e farzeve, largimin prej haramëve, t'u përmbahet dispozitave të Allahut, të thirr në rrugën e Allahut dhe për të urdhëruar në punë të mira dhe për t'u larguar prej punëve të këqija.

Çdo urdhër dhe çdo çështje e sheriatit e përfshin edhe atë vetëm nëse ndonjë argument i caktuar i cili ka të bëjë me çështjen posaçërisht të meshkujve. Nëse thotë Zoti i Madhëruar **O ju njerëz ose [O ju të cilët keni besuar]** edhe femra bën pjesë në atë thirrje pa kurrfarë diskutimi apo polemike.

Për këtë arsye kur Muhamedi a.s. në një rast ka thirr **"O ju njerëz"** Umi Selmete r.a. kur e dëgjoi këtë thirrje i la të gjitha punët e tjera dhe shpejtoi te Muhamedi a.s. për t'iu përgjigjur ftesës; disa u befasuan se si ajo me atë shpejtësi iu përgjigj ftesës e ajo u tha: A nuk jam unë prej njerëzve?

Parim i përgjithshëm është se femra ka obligime sikur mashkulli vetëm nëse bën përjashtim me ndonjë nënligj, duke u bazuar në fjalën e Zotit të Madhëruar [njeri ndaj tjetrit] dhe në thënien e Muhamedit a.s.: **"Vërtet femrat janë "vëllezër" të meshkujve"** transmeton Ahmedi, Termidhiu, Ebu Davudi dhe Darimiu.

Kur'ani fisnik që të dy gjinive femra e meshkuj së bashku u jep detyra dhe përgjegjësi për të formuar shoqëri të shëndoshë dhe për të vendosur rend, rregull e disiplinë, siç e parasheh Islami në adresën:

"Për të urdhëruar në punë të mira dhe për t'u larguar nga punët e këqija". Thotë Zoti i Madhëruar:

"Besimtarët dhe besimtare të dashamirë të njëri-tjetrit, urdhërojnë në punë të mira dhe largojnë nga punët e këqija, falin namazin, japin zekatin dhe e dëgjojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij. Ata do t'i mëshirojë Allahu"

SURETU TEVB 71

Kur'ani i ka përmendur këto karakteristika të besimtarëve pasi i ka përmendur karakteristikat e hipokritëve:

"Hipokritët dhe hipokritet janë mbështetës të njëri-tjetrit. Urdhërojnë në punë të këqija dhe largojnë nga punët e mira".

SURETU TEVB 67

Nëse hipokritet e luajnë rolin e tyre për ta shkatërruar shoqërinë krah për krah me meshkujt ashtu duhet edhe besimtarët të luajnë rolin e tyre për të rregulluar situatën në shoqëri së bashku me meshkujt besimtarë.

Femra e ka luajtur rolin e saj në kohën e Muhamedit a.s. sa që zëri i parë i cili është ngritur për ta vërtetuar pejgamberinë e Muhamedit a.s. dhe përkrahjen e tij ka qenë zëri i femrës e ai zë ka qenë zëri i Hatixhës r.a. po ashtu dëshmorja e parë në Islam ka qenë femër, e ajo është Sumeja nëna e Amarit r.a.

Disa prej femrave kanë luftuar së bashku me Muhamedin a.s. si në Uhud, në betejën e hunejnit etj.etj., derisa në librat e Buhariut është një kapitull i plotë “Lufta e grave dhe luftëtarët”.

Studiuesi në Kur’an dhe hadithë gjen argumente se të gjitha ligjet në shariat përfshinë të dy gjinitë, përpos në çështjet natyrore në të cilat dallohet femra prej mashkullit si p.sh. femra ka rregulla të posaçme sa i përket kohës së menstruacionit, lehonisë, istihadës, shtatëzënisë, lindjes, gjidhënies, kujdesit për fëmijët e të ngjashme.

Mashkulli ka prioritet dhe përgjegjësi në familje, ai ka obligim dhe detyrë për ta mbajtur familjen dhe për t’u kujdesur për shpenzimet në familje dhe për familjen.

Ka ligje sa i përket trashëgimisë ku femra merr një hise ndërsa mashkulli dy hise, por urtësia në të është e qartë, ajo ka të bëjë me dallimin në detyra të përkujdesjes mes femrës dhe mashkullit.

Ka edhe ligje të tjera sa i përket dëshmisë për çështjet pronësore dhe qytetare. E ka ligjësuar sheriati që dëshmia e dy femrave është e barabartë me dëshminë e një mashkulli. Edhe kjo është e bazuar në rrethanat dhe kushtet, të cilat e imponojnë atë realitet për vërtetimin e fakteve dhe për t’i marrë si rezervë për ruajtjen e të drejtave të njerëzve dhe çështjet shumë të rëndësishme të njerëzve.

Për këtë arsye kemi edhe raste ku është ligji i shariatit ku pranohet dëshmia vetëm e një femre sikurse në dëshminë për lindje ose dëshmia për gjidhënie.

Dëshiroj të tërheq vërejtjen në përgjithësi për disa çështje shumë të rëndësishme.

E para: Ne nuk duhet ta ngarkojmë vetën përpos me argumente të qarta të prera dhe të domosdoshme. Ndërsa çka argumentohet me hadithe të dobëta [Daifë] ose në atë çka ka kuptim të dyfishtë apo të dyanshëm, apo komentim të shumëfishtë sikurse ka ardhur ajeti për gratë e Muhamedit a.s. askush nuk ka të drejtë për t’i bërë obligim për umetin, kurse të tjerët e kanë paraparë jo obligative. Posaçërisht nëse i përket çështjeve shoqërore të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe ka nevojë për lehtësim.

E dyta.-Ka ligje dhe fetva të cilat assesi nuk mund t’i ndajmë, t’i ndajmë prej një kohe në një kohë tjetër, apo prej një vendi në një vend tjetër, ndërsa ka ligje dhe fetva të cilat ndryshojnë për shkak ndryshimit të rrethanave. Për këtë kanë vendosur ekspertët rregullin për ndryshimin e fetvave për shkak të ndryshimit të kohës, vendit, gjendjes dhe traditës.

Më të shumtat e këtij lloji kanë të bëjnë me femrën. Aq shumë janë shprehur rigoroz dhe e kanë vështirësuar gjendjen e saj, sa që është ndaluar për të shkuar edhe në xhami, përkundër argumenteve të vërteta, të qarta të cilat e lejojnë femrën për të shkuar në xhami. Mirëpo këtë e kanë bërë për shkak të “Sedi

Dhirai” [mbylljes së kanaleve të cilat keqpërdoren për amoralitet] duke u bazuar në ndryshimin e kohës.

E treta.-Sot sekularistët bëjnë pazarllëqe me çështjen e gruas dhe dëshirojnë të ia mveshin Islamit petkun e zi të cilin nuk e ka dhe Islami është i pastër prej asaj çka shpifin për të, duke thënë se Islami i shkel të drejtat e gruas, e ka paralizuar rolin e saj në shoqëri, i janë nënçmuar vlerat e femrës, dhe argumentohen me atë çka ka ndodhur në kohët e fundit dhe me deklaratat e disa dijetarëve bashkëkohorë rigorozë dhe kategorikë.

SHQYRTIM NË ARGUMENTE

Në këtë bazë duhet të shikojmë temën e hyrjes së femrës në parlament, ose kuvend, dhe a është e lejuar të kandidohet për në pushtetin qendror, dhe ligjësimi i zgjedhjes së saj në këto poste dhe detyra në dritën e argumenteve të sheriatit.

Disa prej njerëzve këtë e parashohin haram dhe mëkat të madh. Mirëpo ndalesa nuk është argumentuar me argument të qartë, por me argument të dyshimtë. Parimore është se aktivitetet e kësaj bote janë të lejuara vetëm nëse ekziston argumenti për ta ndaluar një aktivitet. Po këta ku e kanë argumentin për ndalimin e saj për në parlament?

Ajeti Kur'anor: **“Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja”**

Disa në këtë ajet **“Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja”** e argumentojnë se nuk lejohet që femra të dalë prej shtëpisë së saj vetëm nëse është e domosdoshme, ose për ndonjë nevojë.

Ky argument nuk e tregon atë çka thonë, për këto arsye:

E para: Ajeti u drejtohet grave të Muhamedit a.s. pse gratë e tij e kanë pasur më të nevojshme, dhe ka qenë shumë e rëndësishme për të qenë në shtëpi se gratë e tjera; për këtë arsye shpërblimi i ndonjërës prej tyre nëse ka vepruar mirë ka qenë i shumëfishtë, sikurse edhe dënimi nëse ndonjëra prej tyre ka vepruar keq ka qenë i shumëfishtë, po ashtu.

E dyta: Nëna e besimtarëve Ajshja edhe pse e ka ditur këtë ajet ka dalë prej shtëpisë së saj dhe ka marrë pjesë në luftën e deveve [pse ajo ka marrë pjesë në atë luftë me deve] duke e paraparë ajo se ka obligim fetar për t'u hakmarrë për vrasjen e Othmanit. Edhe pse pastaj e ka kuptuar se nuk ka qenë dashtë për të shkuar në atë betejë.

E treta: -Femra faktikisht ka dalë prej shtëpisë së saj, ka shkuar në shkollë dhe në xhami, ka mësuar dhe ka studiuar në shumë sfera të jetës si në medicinë, për edukatore, mësuese, drejtore e ekonomisë e të tjera, pa e diskutuar askush këtë që konsiderohet “ixhma ameliun”. Unitet i dijetarëve në vepër për lejimin e femrës për të punuar jashtë shtëpisë së saj, por me kushte.

E katërta.-Nevoja e kërkon që myslimanet e devotshme t'i hyjnë betejës së zgjedhjeve për të dalë në duel me femrat e lira dhe sekulariste të cilat pretendojnë të jenë udhëheqëse të punëve dhe çështjeve të grave. Nevoja shoqërore-politike

është më e rëndësishme dhe më madhështore se nevoja personale, pra ajo nevojë kërkon që femra të dalë në jetën shoqërore në përgjithësi.

E pesta.- Izolimi i femrës në shtëpi nuk dihet se ka ekzistuar ndonjëherë, përpos në disa raste siç është në shariat, kur të bëjnë amoralitet haptazi dhe i kalojnë të gjithë kufijtë:”**Mbani ato në shtëpi deri sa të ju vjen momenti i vdekjes ose Allahu t’iu gjejë ndonjë zgjidhje tjetër**”.

SURETU NISAE 15

Si mundet që t’i ndodhë kështu femrës myslimane të devotshme dhe kur ajo është e ndershme dhe në momente të rëndomta.

Dikush e shikon këtë çështje nga një kënd tjetër, e ai kënd është “**Sedu Dhirai**”. Femra kur të kandidohet në parlament, ajo do të jetë e përzier me burra, e ndonjëherë do të jetë e vetmuar me një burrë gjatë procesit zgjedhor, ndërsa kjo është e ndaluar e dihet mirëfilli se “**çdo gjë që shpie në ndalesë është e ndaluar**.”

Nuk ka dyshim se kjo duhet pasur parasysh. Mirëpo dijetarët kanë vendosur se teprimi në mbylljen e rrugëve, dhe teprimi në çeljen e rrugëve, ndoshta në të mund të humbin me shumë të shumëfishta sesa për t’u larguar prej çrregullive të cilat janë të dyshimta e nuk mund të ndodhin.

Ky është argument në të cilën mbështeten ata të cilët e ndalojnë femrën për të qenë e zgjedhur prej frikës se shpie në çrregullim dhe shkatërrim me zërin e saj kështu që fetarët humbin shumë vota, të cilat nëse do t’i fitonin do të ishin të rreshtuar kundër sekularistëve, posaçërisht kur ata i shfrytëzojnë votat e femrave të lira dhe nuk janë fetare.

Disa dijetarë kanë marrë qëndrim negativ edhe për arsimimin e femrës shkollimin e saj apo në anëtarësimin nëpër shoqata për shkak të mbylljes së rrugës së imoralitetit, sa që disa kanë thënë: për të mësuar lexim jo shkrim, për arsye se nëse mësojnë shkrimin, e mësojnë lapsin për letra dashurie, mirëpo ana tjetër i mposhtë me argumente se vetë mësimi nuk është sherr përkundrazi mësimi shpie në të mira të shumta dhe të panumërta.

Nga kjo çka thamë konkludojmë se muslimanja e devotshme, nëse është e kandiduar ose e zgjedhur duhet që të ruhet mos të njolloset me meshkuj në çështje të cilat janë në kundërshtim me shariat; ajo duhet të jetë e matur në fjalë, mos të zdeshet, të mos vetmohet me meshkuj, përpos me farefisën, apo për t’u përzier me meshkuj si e shfrenuar. Këto janë çështje të cilat nuk i përkasin femrës së ndershme myslimane.

FEMRA DHE UDHEHEQJA E SAJ NDAJ MASHKULLIT

Disa e argumentojnë ndalimin e femrës për pushtet qendror nga arsyeja se ajo bëhet udhëheqëse e meshkujve, ndërsa ajo e ka të ndaluar për të qenë udhëheqëse e meshkujve, bile parim të cilin e ka vendosur Kur'ani fisnik është se meshkujt janë udhëheqës ndaj femrave; E si të ndryshohet parimi e të bëhet femra udhëheqëse e meshkujve?

Dëshiroj të sqaroj këto dy çështje;

E para, numri i caktuar i femrave të cilat do të kandidohen në parlament do të jetë i caktuar ndërsa numri i meshkujve është shumicë, e shumica në parlament vendos, pra shumica lejon vendimet, merr vendimet, atëherë nuk ka vend për thënjen se kandidimi i femrës në parlament e bën femrën udhëheqëse ndaj meshkujve.

E dyta; Ajeti fisnik i cili përmend përparësinë e udhëheqjes së mashkullit ndaj femrës, ka të bëjë me jetën bashkëshortore. Burri duhet të jetë kujdestar i familjes, përgjegjës i familjes. Këtë e themi duke u bazuar në të njëjtin ajet:

“Meshkujt kanë përparësi në udhëheqje ndaj femrave nga arsyeja se i ka dalluar Allahu njërin ndaj tjetrit, dhe në atë çka kanë pasuri kujdesen dhe shpenzojnë”

SURETU NISA 34

Teksti në këtë ajet “Dhe në atë çka kanë pasuri kujdesen dhe shpenzojnë” na tregon se ka për qëllim udhëheqjen dhe kujdesin në familje. Kjo është një gradë, një shkallë më e lartë, e cila iu është dhënë meshkujve në fjalën e Allahut.

“Edhe ato [femrat] kanë shpërblim sikur ata të cilat veprojnë mirë dhe me drejtësi, ndërsa meshkujt kanë epërsi ndaj tyre”.

SURETU BEKARE 228

Edhe pse burri ka udhëheqje në familje duhet edhe gruaja të luajë rolin e saj, të japë mendimin e saj për atë çka ka nevojë familja. Sikurse e tregon në çështjen e gjidhënjes së fëmijës **“Dhe nëse japin mendimin dhe pajtohen që fëmijës t’i ndërpritet gjidhënja dhe pas konsultimit në mes vete nuk kanë mëkat”**

SURETU BEKARE 233

Edhe në hadithin e transmetuar nga Ahmedi, Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kërkoni mendimin e grave për [martesën] e vajzave të tyre”** që d.m.th. ka kërkuar për t’u konsultuar me to për martesën e bijave të tyre.

Ndërsa në disa pozita udhëheqëse jashtë rrethit familjar nuk ka argument që e ndalon, por e ndaluar është që femra të jetë udhëheqëse absolute në pushtet për çdo çështje.

Hadithi, të cilin e transmeton Buhariu nga Ebu Bekri Merfuë: **“Kurrë nuk fiton [është i gjykuar për dështim] populli, të cilin e udhëheq për çështjet e tyre femra”** ka të bëjë me pozitën e udhëheqësit kryesor për të gjitha çështjet e umetit, pra pozita e kryetarit siç tregon pjesa e hadithit: **“për të gjitha çështjet e tyre”** pra ka të bëjë me udhëheqjen dhe prirjen absolute për të gjitha çështjet. Ndërsa, sa i përket disa çështjeve të tjera nuk ka pengesë që femra të jetë udhëheqëse si p.sh. e drejta për fetva dhe ixhtihad, për mësim, për transmetimin e haditheve, në drejtori, e të tjera; për këto çështje ka të drejtë udhëheqje me ixhma [mendimi unanim i të gjithë ekspertëve islamë]. Ajo i ka pasur këto pozita brez pas brezi, madje atë edhe prokuroria e ka lejuar; Ebu Hanifja ka dëshmuar për çështjet të cilat ka mundur për të dëshmuar, d.m.th. jashtë sferës **“Hududit dhe Kisasit”**. Edhe pse fukahatë, dijetarët e parë e kanë lejuar edhe në këto çështje. Sikurse e përshkruan Ibni Kajimi në librin “Rrugët e gjykimit” Taberiu e ka lejuar në përgjithësi. E ka lejuar Ibn Hazm, Dhahirijët. Kjo është dëshmi se nuk ka argument të qartë në sheriatin islam për të mos qenë femra prokurore [ministreshë e drejtësisë]. Përndryshe Ibn Hazmi do të kishte ndaluar këtë çështje dhe do të kishte kundërshtuar siç e ka pasur zakon.

Shkaku i thënies së hadithit tregon se hadithi ka pasur për qëllim përkufizimin vetëm në postin kryesor udhëheqës [për kryetar] i kanë treguar Muhamedit a.s. se në Persi ka vdekur imperatori, ndërsa pas vdekjes së tij mbretëreshë është bërë e bija e tij Buran bint Kisra, e Muhamedi a.s. ka thënë: **“Nuk shpëton populli të cilin e udhëheq femra”**.

DYSHIMET DHE PERGJEGJET

Disa dijetarë bashkëkohorë kanë shprehur dyshimin në kandidimin e femrës në parlament apo në kuvend me deklaratat e tyre si vijon:

Deputetët në parlament kanë pozitë më të lartë sesa vetë qeveria, bile dhe më të lartë se kryesia dhe kryetari, pse ajo respektivisht ai është vendosur me vendimin e parlamentit, i kërkon llogari kryetarit edhe qeverisë e kjo d.m.th. ne nuk kemi lejuar për të qenë kryetare, ndërsa e kemi vendosur në formë tjetër.

Kjo na detyron për të dhënë një vështrim dhe për ta shpjeguar domethënien e deputetit në parlament apo kuvend.

Dihet se parlamenti në sistemin demokratik ka organin juridik dhe organin ekzekutiv.

Kur t’i analizojmë këto dy organe kuptojmë si vijon:

Organi ekzekutiv

Ekzekutivi, organi kontrollues në përgjithësi përkthehet në terminologjinë islame: “Për të urdhëruar në punë të mira dhe për t’u larguar nga punët e këqia” dhe në hadithin “Feja është Këshill” e cila është vaxhib [obligim] për ekspertët e myslimanëve dhe të gjithë myslimanët.

“Urdhëresa, ndalesa, këshilla është e kërkuar prej femrave dhe meshkujve së bashku. Në Kur’an kjo shihet qartë në ajetin:

“Besimtarët dhe besimtares janë dashamirë dhe mbrojtës të njëri-tjetrit urdhërojnë në punë të mira dhe largojnë nga punët e këqija”.

I Dërguari Muhamedi a.s. kur ka thënë **“Feja është këshillë për Allahun, të Dërguarin e tij, Librin e tij, dijetarët islamë dhe për të gjithë myslimanët”** nuk e ka përkufizuar vetëm për meshkujt.

E dimë se femra e ka kundërshtuar mendimin e Omerit në xhami e ai e ka pranuar mendimin e femrës e ka thënë:

“Mendim të drejtë ka thënë gruaja, ndërsa Omeri ka gabuar” sikurse e transmetojnë këtë shumë rrugë, dhe e mbështesin.

Muhamedi a.s. është konsultuar me Umi Sulmete në betejën e Hudejbijes dhe ajo ka dhënë mendimin real dhe të drejtë, e Muhamedi a.s. e ka pranuar dhe ka vepruar sipas mendimit të saj e pastaj ka pasur sukses nga ai mendim.

Derisa femra ka të drejtë për të këshilluar, për t’u konsultuar për atë çka mendon për një çështje, urdhëron në punë të mira dhe largon në punët e këqija, dhe ka të drejtë për të thënë kjo është e drejtë kjo është gabim, si person fizik nuk ka argumente në sheriat për ta ndaluar të mos jetë deputete në parlament.

Primare në veprimtaritë e përbashkëta njerëzore, në tradita të njerëzve është lejimi vetëm nëse ekziston ndonjë argument i qartë i cili e ndalon. Dhe nuk duhet të thuhet se në historinë islame në të kaluarën nuk dihet se ndonjëherë femra ka qenë deputete në parlament apo në kuvend. Ky nuk është argument dhe nuk duhet bazuar.

Kjo bën pjesë në fetvatë ku ndryshojnë me ndryshimin e kohërave, vendeve, dhe gjendjeve, ndërsa sistemi konsultativ, parlamentar nuk ka qenë sistem i definuar për femra dhe meshkuj. Ato fetva kanë qenë të përgjithësuara, jo të precizuara, as të definuara, por janë lënë si çështje të hapura për “ixhtihad” të myslimanëve, varësisht prej kushteve të tyre, vendit të tyre dhe gjendjes së tyre shoqërore.

Nëse vepra e Muhamedit a.s. është më shumë se e lejuar si mund të veprojë dikush tjetër, i cili nuk është i pagabueshëm.

Ne sot femrave u ofrojmë punë të cilat më parë nuk kanë qenë të njohura; Themelojmë dhe hapim shkolla dhe fakultete për to ku shkojnë me miliona femra e studiojnë, ku dalin mësuese e profesoresha, mjeke, ekonomiste, e mbajtëse të financave e disa prej tyre drejtoresha në organe e organizata ku punojnë meshkujt. Sa mësues [meshkuj] janë në shkollat ku drejtore janë femra. Sa e sa punëtorë janë në organizata apo fabrika ku drejtore është femra, apo pronare e asaj fabrike është femra. Është e mundur që edhe burri të jetë i udhëhequr prej gruas në shkollë p.sh. në fakultet apo spital, apo në organizatën të cilën e drejton ajo, ndërsa kur të kthehet në shtëpi udhëheqjen prapë e merr burri saj.

Ndërsa deklarimi se kuvendi, parlamenti varësisht prej emërtimeve është organi më i lartë, sepse ekzekutivi apo qeveria ku është edhe kryetari i shtetit parlamentit i jep përgjegjësi, është i papranueshëm absolutisht. Çdo kërkues i

llogarisë nuk është e domosdoshme të jetë me post më të lartë se llogaridhënësi, por me rendësi është që për të pasur të drejtë për të kërkuar llogari edhe nëse është me post më të ulët se llogaridhënësi.

Nuk ka dyshim se udhëheqësi i besimtarëve, apo kryetari i shtetit është posti më i lartë dhe pushteti qendror, është organi më i lartë, mirëpo përkundër kësaj shohim se e drejtë e të ultit qoftë edhe person fizik është se ka të drejtë për t' u kujdesur, për ta këshilluar atë, për të kritikuar, për të urdhëruar, për të ndaluar në mënyrën siç ka thënë Halifja i parë:

“Nëse më shihni në të drejtë më tregoni dhe më mbështetni, ndërsa nëse më shihni se gaboj e devijoj më kundërvini”

Po ashtu edhe Halifja i dytë: *“ Kush sheh në mua ndonjë lakim apo devijim, apo gabim le të më kundërvihet”*.

Askush nuk e mohon atë se gruaja ka të drejtë për të kërkuar llogari prej burrit edhe pse ai prin në çështjet e shtëpisë dhe në shpenzimet e shtëpisë. I thotë burrit pse e ke blerë këtë, pse ke shpenzuar shumë për këtë, pse nuk po kujdesesh për fëmijën tënd, pse nuk po shkon në fafëfisni e të tjera, të cilat kanë të bëjnë me çështjen “urdhëro në punë të mira dhe ndalo nga punët e këqija”.

Duke pasur parasysh se parlamenti është mbi qeverinë nga cilësia se e ka formuar atë dhe kërkon llogari prej saj, kjo është si formë kolektiviteti e jo individi. Ndërsa shumica në parlament janë meshkuj.

PARLAMENTI VENDOS LIGJET DHE KUSHTETUTËN

Ana tjetër e parlamentit ka të bëjë me ligjet dhe kushtetutën. Disa të shtyrë nga entuziazmi i tepërt i japin epitete shumë të lartë parlamentit duke deklaruar se ai është më i rëndësishëm se kryetari i shtetit apo i qeverisë pse ai është i cili vendos ligjin dhe rendin në shtet, vendos rregullat duke ardhur në përfundim se kjo çështje [parlamenti] është shumë serioze, e rëndësishme dhe madhështore dhe nuk lejohet për femrën për t'u marrë me të dhe për të qenë pjesë përbërëse e parlamentit.

Në realitet kjo çështje është shumë e thjeshtë dhe shumë e lehtë. Formuesi i kushtetutës është Allahu edhe bazat e shariatit, urdhëresat dhe ndalesat janë prej Allahut të LartëMadhëruar, ndërsa punë jona si qenie njerëzore është nxjerrja e ligjit, i cili nuk ka bazë definitive, apo sqarimin e ligjeve të cilat janë globale dhe të përgjithshme; me fjalë të tjera puna jonë është për t'u angazhuar në nxjerrjen e ligjit prej bazës Kur'anore dhe sunetit, për të shpjeguar dhe sqaruar që ndryshe quhet “ixhtihad”.

Në shariatin islam ixhtihadi është çështje e hapur në tavolinë edhe për meshkuj edhe për femra së bashku. Asnjë prej ekspertëve të fikhut dhe të parimeve të fikhut [usulijinet] nuk ka thënë se kusht i ixhtihadit është për të qenë mashkull dhe se femra është e ndaluar për të bërë ixhtihad.

Nëna e besimtarëve Ajshja ka qenë prej muxhtehideve të shokëve të Muhamedit a.s. dhe ka dhënë përgjigje për shumë pyetje të parashtruara. Ajo ka diskutuar dhe ka shqyrtuar, ka dialoguar me dijetarët e njohur të sehaveve. Aktivitetet e saja janë të përmbledhura në libra të njohur.

E vërteta është se në historinë tonë nuk është përhapur ixhtihadi shumë te femrat sikurse te meshkujt. Kjo nga shkak se edhe dituria nuk është përhapur te femrat nëpër epoka si shkak i gjendjes dhe i rrethanave të cilat kanë dominuar në ato kohëra, ndërsa sot nuk ekzistojnë më ato kushte dhe ato rrethana. Sot është barazuar numri i femrave me të meshkujve sa i përket arsimimit, shkollimit dhe studimit. Ato kanë disa aftësi me të cilat ia tejkalojnë disa meshkujve. Gjenialiteti nuk është cilësi vetëm e meshkujve, ndoshta femrës i jepet ndonjë dhunti prej Zotit, të cilën meshkujt nuk do ta arrinin atë.

Kur'ani e tregon rastin e mbretëreshës të vendit Sebeë dhe çka i është dhënë asaj mençuri dhe urtësi kur erdh puna si të veprohej me Sulejmanin a.s. Pra ajo ka treguar urtësi kur i dërgon mesazhin hud-hudi[pulëbardha]. Si e shqyrtoi porosinë e letrës, si i tuboi intelektualët dhe parinë e popullit të saj dhe çfarë hapi mori para se të vendoste kur i tha popullit të saj:

Nuk kam dëshiruar të marr vendim të prerë, para se të vendosni ju dhe për t'u konsultuar me juve. Ndërsa ata të fortët [ushtria] i thanë asaj: ti zgjedh dhe vepro si të duash. Thotë Kur'ani famëlartë:

“Thanë ne jemi të fortë dhe të fuqishëm, por vendimi është te ti e ti vendos. Shiko ti pra çka duhet vendosur”

SURETU NEML 33

Si veproi Belkisja pas kësaj me urtësi dhe mençuri me pejgamberin e Allahut Sulejmanin a.s. dhe në fund e pranoi Islamin e tha: **“U bëra myslimane me Sulejmanin dhe të dytë së bashku iu dorëzuam Allahut krijuesit të Gjithësisë”**

SURETU SEBEE

Tregimi i kësaj ngjarjeje në Kur'an nuk është lojë, por tregon se femra mundet të ketë vizion të qartë, largpamësi, mendim të mire e të drejtë në çështje të politikës dhe të ligjit që shumica e meshkujve nuk i kanë.

Për atë çka nuk kemi çka të diskutojmë janë disa çështje të cilat kanë të bëjnë vetëm me femrën, për familjen dhe marrëdhëniet në familje duhet marrë mendimin e femrës dhe familjes me qëllim që të mos u mungojë pse ndoshta në disa raste mundet të jetë më largpamëse se meshkujt.

Femra e cila e ka kundërshtuar Omerin r.a. në xhami ka pasur të bëjë me çështjen e familjes, caktimi i mehrit në shumën maksimale. Ndërsa pas diskutimit të femrës Omeri r.a. e ka rishqyrtuar dhe e ka kthyer prapë vendimin për caktimin e shumës së mehrit.

Omeri r.a. ka marrë edhe vendime të tjera pasi që është konsultuar me femra, një prej atyre vendimeve ka qenë që burri në ushtri mos të mungojë nga shtëpia e

tij dhe gruaja e tij më shumë se gjashtë muaj. E ka pyetur bijën e tij Hafsën sa është koha maksimale që gruaja të durojë për burrin e saj. I është përgjigjur 4 muaj, eventualisht 6 muaj.

E ka tronditur Omerin femra, e cila ishte e vetmuar larg burrit të saj pasi që kishte thurrur vargje kur ajo ishte para shtratit në mbrëmje:

“Nata u errësua dhe po zgjat shumë

Nuk e kam mbështetjen, burrin me të cilin do të lozsha

Për Allahun po mos të ishte frika ndaj Allahut i cili dënon

Anët e këtij shtrati do të ishin të lëkundura”.

Po ashtu edhe vendimin të cilin e ka marrë për t’i dhënë ndihmë [shpërblim] çdo fëmije në Islam, pasi që më herët kishte marrë vendim për t’i dhënë ndihmë fëmijës vetëm pas ndërprerjes së gjidhënies. Për këtë arsye gratë i ndanin fëmijët e tyre nga gjiri pa e plotësuar kohën e duhur, vetëm për të marrë ndihmë. Kur një ditë dëgjo i se një fëmijë qante pandërprerë, pyet Omeri për çka po qante. Ajo iu përgjigj e nuk e njihte: Udhëheqësi i besimtarëve nuk i jep ndihmë fëmijës pa u ndarë nga gjiri, për këtë arsye e kam ndarë nga gjiri herët e ai po qan. Omeri tha: “Mjerë për ty o Omer, sa fëmijë të myslimanëve i ke marrë në qafë”. Pastaj ka marrë vendim për t’i dhënë ndihmë çdo fëmije.

Ne kur deklarojmë se lejohet femra për të qenë deputete në parlament kjo nuk d.m.th. që ajo të përzihet me meshkuj pa moral dhe pa edukatë dhe pa rregulla të posaçme ose për të qenë në dëm të burrit të saj, të fëmijëve të saj apo të shtëpisë së saj ose për t’i tejkaluar rregullat e moralit si në veshje, në të ecur ashtu edhe në të folur; në të gjitha këto duhet pasur kujdes pa kurrfarë dyshimi dhe pa kurrfarë diskutimi si dhe pa kurrfarë polarizimi prej askujt.

Kjo kërkohet prej femrës në parlament, në xhami, në fakultet apo veprimtaria e femrës jashtë shtëpisë së saj çfarëdo pune apo çfarëdo veprimtarie të ketë ajo.

Kërkohet prej shtetit për të pasur rregulla islame që të ketë vende të posaçme në parlament, rendet e posaçme, apo këndin e posaçëm e të ngjashme çka i ofrojnë asaj ambient të përshtatshëm të qetë dhe siguri ndaj çdo çrregullie.

POLEMIKA RRETH ÇËSHTJES SE FEMRA E KA TË NDALUAR TË KETË TË DREJTË POLITIKE

Kam shkruar disa faqe sa i përket kandidimit të femrës në parlament, pasi më shtynë disa fetva të dijetarëve të hershëm të Ez-herit, të cilat kanë ardhur në përfundim se femra nuk ka të drejtë politike absolutisht. E para nuk ka të drejtë të dalë në votim dhe të votojë për kandidatin me po ose jo e mos të flasim që ajo vetë të jetë kandidate për parlament apo për pushtetin qendror, kur asaj i është e ndaluar edhe vetë votimi.

POZITA E GRAVE TË PEJGAMBERIT DHE DALJA E TYRE PREJ SHTËPIE

Fetva e atyre të cilët e ndalojnë që femra të ketë të drejtë politike mbështetjen e kanë si vijon:

Femra si qenie njerëzore është e krijuar për ndjenja dhe pasione të cilat i përshtaten asaj. Ajo ka detyrë dhe rol të lindë fëmijë, për t'u kujdesur për fëmijën dhe për ta edukuar fëmijën. Për këtë arsye ajo ka influencë të posaçme sa i përket ndjenjave.

Dhe për të mos shkaktuar probleme të ngjashme, të cilat kanë ndodhur në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohërat për shkak të emocioneve, dhe pasioneve të posaçme të cilat i posedon femra. Këto emocione dhe pasione e kanë shtyrë femrën për t'u veçuar me karakteristika femërore ku emocioni dominon mbi mendjen e saj dhe mençurinë e saj.

Ajetet e Kur'anit në suretul Ahzab tregojnë për gratë e Muhamedit a.s. se kanë pasur ndjenja për stoli dhe zbukurim të dynjasë dhe dëfrim në dynja, dhe kërkesat e tyre kanë qenë që edhe ato të shfrytëzojnë pasurinë e luftës dhe të jetojnë si kanë jetuar gratë e mbretërve dhe udhëheqësve të popujve të tjerë;

Mirëpo Kur'ani e ka kundërshtuar mendjen dhe mençurinë e tyre: **“O i dërguar thuaju grave tua:”Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani; unë po ju jap furnizimin [për shkurorëzim] dhe po ju liroj ashtu siç është më së miri. E në qoftë se e doni Allahun, të Dërguarin e tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira”.**

SURETU AHZAB 28-29

Po ashtu edhe ajeti tjetër në suretu tehrimë flet tërë xhelozinë e disa grave : **Nëse ju dyja pendoheni te Allahu [është më mire për ju] Muhamedit a.s. dhe çka ka ndikuar në dominimin e ndjenjave mbi mendjen dhe logjikën çka i ka shtyrë për të bashkëvepruar kundër të Dërguarit [s.a.v.s.]. Kur'ani kritikon me seriozitet; “sepse zemrat tuaja tani më kanë rrëshqitur, e nëse bashkëveproni kundër tij, ta dini se Allahu është Ai mbrojtës i tij si edhe Xhibrili dhe besimtarët e drejtë dhe të ndershëm, e kur është kështu edhe melaqet i dalin në ndihmë”.**

SURETU TEHRIME 4

Këto gra kanë pasur karakteristikat më të dalluara të grave, mirëpo prapëseprapë u janë nënshtruar ndjenjave dhe emocioneve, ndërsa fuqia morale nuk mundi t'i ndalonte nga xhelozia edhe pse e kanë pasur imanin e fortë, janë edukuar në shtëpinë e Pejgamberit dhe të shpalljes. E çka mund të ndodhë me femrat e tjera, të cilat imanin e kanë të dobët, apo nuk besojnë, dhe nuk janë të

edukuara me edukatën e shtëpisë së Muhamedit a.s. dhe nuk kanë pozita të larta familjare, apo nuk janë afër edukatës së familjes së Muhamedit a.s.

Kjo është çka është thënë për gratë e Muhamedit a.s.

Mirëpo ato kanë harruar për të thënë edhe diçka të rëndësishme, se **kur iu është thënë për të zgjedhur, ato kanë zgjedhur të gjitha Allahun, të Dërguarin e tij dhe botën tjetër.**

Edhe pse kanë lakmuar në stoli, kënaqësi të kësaj bote sikurse të gjitha gratë posaçërisht gratë e mbretërve, nuk tregojnë kjo për dobësinë e mendjes së tyre dhe as për mosgjykimin e drejtë në çështjet e përgjithshme, por tregohet natyrshmëria e njeriut dhe natyrshmëria e grave, pse menjëherë pasi janë hequr mjegullat dhe është kthjelluar, ka zbritur ajeti i zgjedhjes së tyre.

A janë të pagabueshëm meshkujt në këto raste të ngjashme kur është fjala për mbështetjen në kënaqësitë e kësaj bote, pastaj kthjellohen dhe zgjohen përnjëherë kur u zbret shpallja dhe u tërhiqet vërejtja për gabimin apo harresën e tyre.

A nuk thotë Kur’ani për sehabet kur i janë drejtuar të Dërguarit fisnik:

“Po kur të shohin ndonjë tregti ose ndonjë aheng ia mësyjnë atje, kurse ty të lënë në këmbë [duke ligjëruar] Thuaju: - Ajo që është tek Allahu është shumë më e mirë se dëfrimi dhe tregtia, e Allahu është furnizuesi më i mirë”.

SURETU XHUMUA 11

A nuk kanë zbritur ajetet pas luftës së Uhudit duke i kritikuar Zoti i Madhëruar sehabet të cilët janë gjenerata më e dalluar e njerëzimit pasi që nuk e kishin dëgjuar urdhrin e Allahut dhe të Dërguarit dhe i kishin lëshuar pozicionet për të mbledhur pasuri në front për çka edhe kanë humbur luftën.

Thotë Zoti i Madhëruar:

“Allahu përmbushi premtimin e vet ndaj jush, nga se me vullnetin e Tij i korrët ata [me shpata] deri kur u dobësuat dhe u përçatë ndërmjet vete, në çështjen e vendit [që u pat caktuar Pejgamberi] dhe pasi që e vërejtët atë që e dëshironit [prenë e luftës], e atëherë kundërshtuat [urdhrin e Pejgamberit]. Pati prej jush që e deshën këtë jetë [ata që lëshuan pozicionet për pasurinë e luftës] por pati prej jush që e deshën botën tjetër.

SURETU ALI IMRAN 152

Ka thënë Ibni Mes’udi; *“Nuk e kam ditur kush prej neve e do këtë jetë, derisa ka zbritur ky ajet”.*

A munden të merren si argument këto raste e qëndrime për t’i konsideruar meshkujt e dalluar të cilët ka dominuar dëshira e tyre ndaj logjikës dhe mendjes që meshkujt nuk janë të aftë për pozita kyçe në pushtet.

Kur’ani përshkruan edhe raste të tjera të ngjashme, si në luftën e Bedrit çka ka ndodhur para luftës dhe pas luftës.

Thotë Zoti i Madhëruar:

“[Mospajtimi i tyre për prenë e luftës është] Ashtu si ai kur të nxori Zoti yt nga shtëpia jote për të vërtetën, e një grup nga besimtarët nuk ishte i kënaqur [se ti vepron me lejen e Zotit] sikur shtyheshin në vdekje të sigurt.

Përkujtoni kur Allahu ju premtoi njërën prej dy grupeve se është juaja, e ju dëshironit t’ju takojë ai [grup] i paarmatosur...”

SURETU ENFAL 5-6-7

Ndërsa pas luftës thotë Zoti i Madhëruar për qëndrimin e tyre ndaj robërve:

Ju keni për qëllim përjetimet e kësaj bote, ndërsa Allahu dëshiron për ju Ahiretin. Allahu është i Fuqishëm i Urtë. Po të mos ishte dispozita e hershme e caktuar prej Allahut [që të mos dënohet ai që përpiqet e nuk e qëllon] juve do t’ju kishte goditur një dënim i madh për atë që e morët.

SURETU ENFAL 67-68

Dobësia e qenies njerëzore i përfshin njësoj edhe femrat edhe meshkujt.

Pse nuk e përmendim për këtë rast konsultimin e Umi Selmete me pejgamberin në ditën e Hudejbijes, pse pas kësaj ka pasuar e mira dhe dobia e përgjithshme.

Pse nuk e përmendim atë çka e ka përshkruar Kur’ani për femrën e cila ka vepruar me urtësi dhe mençuri dhe e ka udhëhequr popullin me politikë të mençur, dhe i ka udhëhequr në momentet më të vështira dhe iu ka sjellë dobi dhe të mira edhe në këtë jetë edhe në botën tjetër e ajo ka qenë mbretëresha e popullit sebeë. Ajo e ka vërejtur se çka veprojnë popujt kur ta çlirojnë dhe e okupojnë një vend dhe popullit të saj i ka sqaruar me fjalë bindëse.

“Dhe tha nuk ka dyshim se mbretërit kur të hynë në një vend [e çlirojnë ose e okupojnë] njerëzit më eminentë, dhe më të ndershëm i bëjnë më të ultit dhe më të nënçmuarit.

SURETU NEML 34

DUKURITË NATYRORE TË FEMRËS

Ata të cilët e mbështesin ndalimin e femrës për kandidate në parlament argumentojnë edhe me dukuritë natyrore të cilat i paraqiten femrës si cikli mujor apo menstruacioni, dhe dhembjet për shkak të gjakderdhjes, shtatzënia dhe shtrëngimet e shtatzënisë, lindja e fëmijës dhe vështirësitë gjatë lindjes, gjidhënia dhe lodhjet, roli i saj si nënë etj. Të gjitha këto dukuri e bëjnë të paaftë për këtë botë si në aspektin shpirtëror ashtu edhe mendor për të marrë përgjegjësi si anëtare e një kuvendi ku vendosen ligjet dhe rregullat dhe ku kontrollohet qeveria.

Ne themi: Kjo është e vërtetë, se çdo femër nuk është në gjendje për të qenë në kuvend apo parlament, femra e cila është e ngarkuar si nënë dhe me kërkesat që i paraqiten nuk e lejon veten për t’u kandiduar për këtë detyrë, por edhe nëse pranon edhe femrat edhe meshkujt i thonë asaj: Jo, përparësi kanë fëmijët e tu.

Mirëpo femra e cila nuk ka fëmijë ajo ka kohë, ka forcë, ka dituri, ka mençuri po ashtu edhe femra e cila i kalon të katërdhjetat apo të pesëdhjetat dhe nuk i paraqiten dukuritë të cilat i përmendëm dhe iu kanë martuar djemtë dhe vajzat e saj, ka arritur pjekuri, ka fituar përvojë dhe ka kohë për t’u angazhuar në aktivitetet shoqërore të përgjithshme. Çka e pengon atë për të qenë deputete në kuvend apo

parlament, nëse i plotëson edhe kushtet e tjera të cilat duhet t'i plotësojë çdo kandidat, pavarësisht a është femër apo mashkull.

Ajeti Kur'anor **“Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja”**

SURETU AHZAB 33

Ata të cilët e ndalojnë që femra të jetë kandidatë për në parlament argumentojnë edhe me këtë ajet.

Ne e kemi diskutuar edhe më herët këtë çështje, por po shtojmë: Dihet shumë mirë se në këtë ajet Zoti i Madhëruar u drejtohet grave të Pejgamberit siç e tregon edhe fillimi i ajetit; Gratë e Muhamedit a.s. kanë pasur ligj të posaçëm dhe dënim të shumëfishtë, nëse ato bëjnë amoralitet haptazi por edhe shpërblim e shumëfishtë nëse bëjnë vepra të mira, dhe e kanë pasur të ndaluar për t'u martuar pas vdekjes së Muhamedit a.s. Në fillim të ajetit Zoti i Madhëruar e shpjegon **“O ju gra të pejgamberit ju më nuk jeni sikur gratë e tjera”**.

Për këtë arsye myslimanët pa kurrfarë diskutimi në kohën tonë e kanë lejuar që femra të dalë prej shtëpisë për të mësuar në shkollë, pastaj në fakultet, për të dalë në qytet e në treg, për të punuar jashtë shtëpisë së saj si mësuese, si motër medicinale, si mjeke e të ngjashme prej punëve të lejuara në kushte dhe rrethana të cilat i lejon sheriatu islam.

Ky ajet fisnik **“Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja”** nuk e ka penguar nënën e besimtarëve dhe dijetaren më eminente të umetit në fikh Ajshen r.a. për të dalë prej shtëpisë së saj, bile edhe prej Medines së ndriçuar dhe për të udhëtuar për në Basra në krye të ushtrisë ku ka pasur shumë sehabë në mesin e tyre dy të garantuarit për në xhenet, në mesin e tyre kanë qenë edhe gjashtë kandidatët e parlamentit të propozuar për kryetar [halife]; Talha dhe Zubejri kanë kërkuar prej saj që vendimin që e ka marrë a ka qenë gabim apo i drejtë për shpejtimin e hakmarrjes së vrasjes Othmanit r.a.

Nuk thuhet se ajo është penduar pse ka dalë, jo pse ajo ka dalë duke thyer ligjin, por për arsye se mendimi i saj politik ka qenë i gabuar e kjo është temë tjetër.

Disa, pjesën e ajetit [Qëndroni në shtëpitë tuaja] e marrin si argument të përgjithshëm se gruaja nuk lejohet të dalë prej shtëpisë vetëm në rast të domosdoshmërisë ose ndonjë nevojë, e cila është e domosdoshme, derisa edhe mësimin në shkollë, ose studimin në fakultet nuk e lejojnë dhe nuk na habit fakti se ia ndalojnë femrës për të dalë në votime, ose për të dalë në referendum.

Me këtë e paralizojnë dëshminë e 50 përqind të umetit për çështjet më të rëndësishme dhe më madhështore. E nëse e do më konkretisht dhe më reale e ke paralizuar dhe i ke ndaluar gratë e ndershme në dhënien e dëshmisë së tyre ndërsa femrat e tjera dalin në votime dhe ua japin votat sekularistëve, kundërshtarëve dhe armiqve të shariatit islamik.

Harrojnë këta se pjesa tjetër e ajetit tregon aspektin e daljes së femrës nga shtëpia e saj nëse i përmbahet rregullave dhe edukatës dhe nuk zdeshet [lakuriq e gjysmëlakuriq] si në injorancën e hershme. Ndalesa për zdashje ka të bëjë kur të dale jashtë shtëpisë, ndërsa femra në shtëpinë e saj i lejohet për t'u zbukuruar

dhe për të qenë e zdashur. Pra zdashja e femrës është e ndaluar jashtë shtëpisë së saj.

HADITHI: “Nuk shpëton populli të cilin e udhëheq femra”:

Fetvatë e përmendura e mbështesin mendimin e tyre se është e ndaluar femra për të qenë deputete në kuvend ose parlament në hadithin të cilin e transmeton Buhariu e të tjerët nga Ebu Bekri se kur ka dëgjuar Muhamedi a.s. se Persia e ka vendosur udhëheqëse vajzën e mbretit Kisra pas vdekjes së mbretit ka thënë; **“Nuk shpëton populli të cili e udhëheq femra”**

Për këtë argumentim ne i kemi qëndrimet tona;

E para, Hadithi a merret si argumentim i përgjithshëm apo posaçërisht argumentim i shkaktuar të rastit për të cilin është thënë. Me fjalë tjera ka dëshiruar të lajmëronte se Persia do të dështojë dhe nuk do të shpëtojë pse e ka vendosur sistemin e pushtetit trashëgues [mbretëror] për të sunduar vajza e imperatorit, edhe nëse ka në atë popull më të mire, më të fortë se ajo njëmijë herë.

Është e vërtetë se ekspertët e parimeve të fikhut [uslijinet] pjesa dërmuese e tyre thonë: Bazë është teksti i fjalës në përgjithësi jo shkaku i thënies në veçanti”. Mirëpo në këtë rast nuk janë pajtuar në përgjithësi. Transmetohet nga Ibni Abasi dhe Ibni Omeri e të tjerët se është e domosdoshme të kenë kujdes në shkaqet e thënieve [të zbritjeve] se për ndryshe ndodhin keqkuptime dhe keqinterpretime, sikurse ka ndodhur te havarixhët dhe të ngjashmit me ta, të cilët i kanë marrë ajetet që kanë zbritur posaçërisht për idhujtarët ndërsa ata i kanë përgjithësuar ato ajete edhe për besimtarët.

Kjo tregon se shkaku i zbritjes së ajetit e posaçërisht shkaku i thënies së hadithit duhet shikuar në rend të parë në kuptimin e tekstit. Kuptimi i fjalës nuk merret parasysh si rregull e plotë.

Kjo vërtetohet posaçërisht sa i përket këtij hadithi sikur të merret se i përgjithshmi do ta kundërshtonte Kur’anin. Kur’ani na ka treguar faktin se femra e ka udhëhequr popullin e saj për mrekulli. Ka sunduar me drejtësi sa që nuk merret me mend, ka vepruar me mençuri dhe urtësi të papërshkrueshme dhe e ka shpëtuar popullin e saj me mendim të drejtë duke mos shkuar në luftë shkatërrimtare, për t’u mbytur burrat, për t’iu shkuar pasuria, dhe për të mos iu mbetur asgjë tjetër.

Ajo mbretëreshë është Belkisja të cilën e ka përmendur Kur’ani në suretu Neml me pejgamberin e Allahut Sulejmanin dhe në përfundim prapë ka thënë: **“O Zoti im. I kam bërë padrejtësi vetes sime, unë së bashku me Sulejmanin i dorzohemi Allahut, Zotit të gjithësisë”**

SURETU NEML 44

Se ka qenë hadithi veçanërisht për Persinë e dëshmon edhe fakti dhe realiteti se shumica e grave të cilat kanë qenë në vendet e tyre si udhëheqëse kanë qenë më të mire se shumica e meshkujve.

Disa prej grave kanë aftësi më të mëdha politike, ekonomike e drejtuese sesa shumica e meshkujve qeveritarë arabë dhe myslimanë e nuk po them se shumica e “burrave”.

E dyta: Dijetarët janë unanimesë sa i përket asaj se e ka të ndaluar për të qenë udhëheqëse e tërë umetit Islam, Halife. Kjo është për çka është thënë hadithi [shkak] sikurse e vërteton fjala “I udhëheq të gjitha çështjet e tyre” në një transmetim tjetër “i sundon ata femra” kjo ka të bëjë me atë që femra për t’u bërë mbretëreshë ose kryetare shtetit, e cila i vendos të gjitha çështjet e popullit, nuk ka për qëllim qeverisje, apo post në qeveri. Me fjalë të tjera t’i marrë të gjitha kompetencat në dorë absolutisht d.m.th. çdo çështje për të qenë në dorë të saj dhe çdo veprim ta ketë në dorë.

Ndërsa sa i përket përpos Halifetit [Imamit] e të ngjashme si kryetare shteti dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme.

Mundet të jetë ajo kryeministër, mundet të jetë prokurore [ministre e drejtësisë]. Mundet të jetë e para në organin ekzekutiv, kontrollues etj.

Omeri r.a. e ka emëruar shefe bint Abdullah el Advije si kontrolluese inspektore për inspektimin e tregut dhe të ekonomisë e ajo ka qenë pjesë e pushtetit qendror.

E treta: Shoqëria bashkëkohore nën hijen e sistemit demokratik kur ta emërojë femrën në pushtetin qendror si kryeministre, apo zëvendës kryeministre e të ngjashme nuk d.m.th. kjo se i ka të gjitha çështjet në duar por kompetencat e asaj çështjeje për të cilën emërohet dhe jep përgjegjësi të plotë për atë.

E vërteta është se përgjegjësia kolektive dhe përgjegjësi të përbashkët jepet si tërësi e organeve dhe aparatit të shtetit ndërsa femra është vetëm një pjesë e asaj përgjegjësie.

Për këtë arsye sa i përket Margareta Thaçerit në Britani, Indira Gandit në Indi Gold Majerit në Palestinën e okupuar pas një vështrimi dhe analize e kuptojmë se ato nuk i kanë tëra çështjet e popullit në dorë, por është qeveri e organeve dhe organizmave të qeverisjes dhe sundimit edhe pse në krye është femra. Por ai i cili qeveris është organi i ministrive si kolektivitet e jo kryeministresha.

Ajo nuk është sundimtare absolute të cilës nuk guxon kush për t’ia refuzuar vendimin, apo për ta kundërshtuar në ide, por ajo kryeson një parti e cila e ka pozitën. Mundet që me zgjedhjet e ardhshme ajo të bie prej postit, sikurse ndodhi me Indira Gandin në Indi. Ajo e ka vetëm votën e partisë së saj. Nëse shumica e kundërshtojnë dhe e mbivotojnë atëherë mendimi i saj është si një mendim i çdo njeriut në mes të rrugës.

Biografia e autorit, Dr. Jusuf Kardavit

Dr. Jusuf el-Kardavi U lind dhe u rrit në Egjipt. Para moshës dhjetëvjeçare bëri hifzin e Kur'anit, më pastaj vazhdoi mësimet në universitetin e njohur të El-Az'harit. Në vitin 1953 diplomoi në Fakultetin e Usulud-dinit, ndërsa në vitin 1954 fitoi të drejtën për mësimdhënës. Ishte shembullor dhe në vitin 1973 doktoroi. Pas diplomimit ushtroi disa funksione: ishte mbikëqyrës i çështjeve fetare pranë Vakëfeve Egjiptase, ishte drejtues i sektorit të kulturës islame pranë Az'harit, drejtor i institutit fetar në Katar, më pastaj shef i katedrës për studime islame pranë Fakultetit të pedagogjisë dhe sheriatit, pastaj dekan i Fakultetit të sheriatit dhe drejtor i Qendrës për hulumtime mbi Sunnetin dhe Siren (biografinë e Pejgamberit) në Katar. Pastaj u transferua për një kohë të shkurtër në Algjeri për t'i udhëhequr këshillat shkencore të universiteteve dhe institutive islame.

Që nga vitet e hershme të rinisë së tij u preokupua me çështje të da'vetit, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mori pjesë në lëvizjen islame. Kjo bëri që disa herë të persekutohet, si p.sh. në vitin 1949, pastaj në vitin 1965. Për shkak të aftësive dhe prirjeve të lloj-llojshme ai dha kontribut në shumë lëmenj. Është ligjërues efikas i cili e bind logjikën dhe trondit zemrën. Është dijetar i thelluar në shkenca të ndryshme islame, të cilën gjë e dëshmon çdo njëri i cili i lexon apo i dëgjon mendimet e tij. Njëkohësisht është edhe poet. Nga personalitetet më të dalluara të cilët kanë ndikim të veçantë në jetën e tij është shehidi Hasan El-Benna, të cilin e cilësoi me këtë thënie: "Personaliteti me ndikim më të madh në jetën time mendimtare dhe shpirtërore është shehidi i madh Hasan El-Benna, themelues i një ndër lëvizjeve më të mëdha islame bashkëkohore". Shkroi më tepër se pesëdhjetë vepra, të cilat hasën në prani të jashtëzakonshme nga bota islame, disa nga ato janë ribotuar nga dhjetë herë, ndërsa një pjesë e madhe e tyre janë përkthyer në gjuhë të ndryshme. Ata të cilët kanë shkruar për Kardaviun e kanë cilësuar kështu: Ai është nga mendimtarët e rrallë islam i cili i bashkon tekstet e qarta të sheriatit dhe nevojat e kohës, dhe se veprat e tij dallohen me precizitetin e fakhiut, shkëlqesinë letrare, vrojtime të reformatorit dhe ngrohtësitë e thirrësit.

Llogaritet nga dijetarët më të rëndësishëm bashkëkohorë të cilët e përcollën ekonominë islame në sektorin e bankave islame. Dha kontribut në rrjedhat e reja shkencore që nga formimi i tyre me pjesëmarrjen e tij, me udhëheqjen e disa prej tyre dhe me praninë në komisionet mbikëqyrëse.

Është anëtar në disa këshilla dhe institute shkencore dhe thirrëse, siç janë: Këshilli i Fikhut pranë Ligës Botërore Islame në Meke, Këshilli Mbretëror për studime të Civilizimit Islam në Jordani, në Qendrën për studime Islamike në Oksford, në Këshillin e nderit pranë Universitetit islamik në Islamabad, në

Organizatën për thirrje islame në Sudan. Është një ndër thirrësit e moderuar islam i cili arriti të bashkojë selefizmin dhe reformizmin, mes origjinalitetit dhe bashkëkohores, bëri balansim mes konstantës dhe variables, i cili nuk harron të kaluarën dhe nuk distancohet nga aktualja, e as që është indiferent ndaj të ardhmes.

PËRMBAJTJA

DY FJALË NË VEND TË HYRJES.....	4
ISLAMI DHE POLITIKA.....	11
Përgjigja:.....	11
SURETUL ENAM 57.....	23
Ndërsa në mjediset e liberalëve dhe të tjerëve është përhapur mendimi se myslimanët janë armiq të demokracisë dhe përkrahës të diktaturës dhe të autokracisë.....	23
SISTEMI SHUMËPARTIAK NË SHTETIN ISLAM.....	37
SISTEMI SHUMËPARTIAK SI SISTEMI I MEDHHEBEVE.....	41
PLURALIZMI DHE KUNDËRSHTIMET.....	42
PLURALIZMI PARIM NGA JASHTË.....	44
IMAMI E PRANON EKZISTIMIN E PARTISË.....	46
HAVARIXHE.....	46
TOLERANCA ISLAME DHE DREJTËSIA E SAJ ME JOMYSLIMANËT.....	50
FAKTE TE CILAT DUHET PASUR PARASYSH.....	51
QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ JOMYSLIMANËVE.....	52
SHKALLA MË E LARTË E TOLERANCËS VETËM TE MYSLIMANËT	55
SHPIRTI I TOLERANCES TE MYSLIMANËT.....	56
BAZA E IDEVE TE TOLERANCËS SË MYSLIMANËVE.....	59
POROSITË E PEJGAMBERIT POSAQËRISHT PËR KOPT'ËT E EGJPTIT.....	60
XHAMIJA DHE POLITIKA.....	62
POLITIKA E LEJUAR DHE POLITIKA E NDALUAR.....	63
FEJA DHE LIRITË E NJERIUT.....	66
NGA POROSITË E KUR'ANIT.....	71
FORMIMI I KOALICIONIT TË QEVERISË ME PARTINË JOISLAME	73
ESENCIALE PËR TË MOS HYRË NE KOALICION.....	74
PËR NEVOJA TË SHERIATIT LEJOHET TË KALOHEËT NGA ESENCA [NGA PARIMI]	76
NËNSHTRIMI DËMIT MË TË VOGËL NGA TË DY DËMET.....	77
NGA SHEMBULLI MË I MIRË ZBRITJA NË GJENDJEN FAKTIKE MË TË ULTË.....	78
NATYRSHMERIA E EVOLUCIONIT.....	80
KUSHTET TË CILAT PATJETËR DUHET PLOTËSUAR PËR TË HYRË NË KOALICION	81
FETVATË E DIJETARËVE MË EMINENTË.....	82
PËR KËTË ÇËSHTJE.....	82
FETVA E IZUD-DIN ABDUS SELAMIT.....	83
FETVATE E IBNI TEJMIJES.....	83
MENDIMI TJETËR I IBN TEJMIJES:.....	86
PROBLEMATIKA E ÇËSHTJES KUR TË PARAQITEN.....	86
EDHE TE MIRAT EDHE TË KËQIJAT NË TË NJEJTËN KOHË.....	86
KANDIDIMI I JOMYSLIMANËVE PËR PUSHTETIN QENDROR NË SHTETET ISLAME	90

SISTEMI KONSULTATIV, PARLAMENTAR A ËSHTË DOMOSDOSHMERËI APO FAKULTATIV.....	95
VENDIMI I PARLAMENTIT OBLIGATIV.....	96
SISTEMI PARLAMENTIT OBLIGATIV.....	97
ARGUMENTET PËR TË VENDOSUR PËR MENDIMIN E SHUMICËS.....	97
KANDIDIMI I FEMRËS PËR DEPUTETE NË PARLAMENT I LEJUAR APO I NDALUAR.....	99
SHQYRTIM NË ARGUMENTE.....	101
FEMRA DHE UDHEHEQJA E SAJ NDAJ MASHKULLIT.....	103
DYSHIMET DHE PERGJEGJET.....	104
PARLAMENTI VENDOS LIGJET DHE KUSHTETUTËN.....	106
POLEMIKA RRETH ÇËSHTJES SE FEMRA E KA TË	108
NDALUAR TË KETË TË DREJTË POLITIKE.....	108
POZITA E GRAVE TË PEJGAMBERIT DHE DALJA E TYRE PREJ SHTËPIE.....	109
DUKURITË NATYRORE TË FEMRËS.....	111
Biografia e autorit, Dr. Jusuf Kardavit.....	115